
SAMI FRASHËRI

Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë?

Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë



Botim i plotë leximi me ilustrime

Botimi i parë: Bukuresht, 1899 · 2026

Botim digjital: Valon Asani · valonasani.com · 2026

© 2026 Valon Asani, vetëm për kontributet origjinale të mbrojtshme për të cilat zotëron të drejtat; burimet dhe të drejtat në f. 4.

Përmbajtja

I Ç'ka qenë Shqipëria **5**

Pelasgëtë 5

Illyrianëtë e Epirotëtë 9

Shqipëtarëtë nënë Romanëtë 10

Mbretërit' e vogëla të Shqipërisë 13

Shqipëria në kohët të Skënderbeut 15

Shqipëria nënë Tyrqitë 17

Kombëri e gjuh' e Shqipëtarëvet 20

Shqipëtarëtë gjithënjë për botën' e kurrë për vetëhe 24

II Ç'është Shqipëria **28**

Kufit' e Shqipërisë 28

Vënd' i Shqipërisë 30

Njerëzit' e Shqipërisë, Shqipëtarëtë 32

Shqipëtarëtë jashtë Shqipërisë 35

Qysh janë sot Shqipëtarëtë? 37

Kombëri e Shqipëtarëvet 40

Reziket' e Shqipërisë 42

Miqt' e Shqipëtarëvet 47

Të shkruarit' e gjuhësë shqip 50

Varfërí e Shqipëtarëvet e pakryesí e Shqipërisë 54

III Ç'do të bëhetë Shqipëria? **56**

A munt të qëndronjë Shqipëria si është? 56

A janë të zottë Shqipëtarëtë të mbajn' e të ruajnë vetëhenë? 59

Shpëtimi a humpja e Shqipërisë është në dorët të Shqipëtarëvet 62

Besa e lidhja 64

Qëllim' i Shqipëtarëvet 67

Qeveri' e paskëtajme 68

Krej i qeveris' së Shqipërisë 71

Të ndarët’ e Shqipërisë 73
Pleqësija 74
Këshill’ e përgjithçime 77
Ministrëtë 78
Ushtërija 79
Diturija 81
Punërat’ e përgjithçime 83
Punërat’ e besëvet 87
Punët’ e begatisë 89
Katundëritë 93
Përmbledhje 95

Shënime për tekstin dhe burimet **102**

Ilustrimet dhe burimet e tyre **104**

Referenca e paragrafëve **107**

Për këtë botim

Ky është teksti i plotë i transkriptimit të Fletoreve, i ndarë në 3 pjesë e 36 nënkapituj. Ruhet drejtshkrimi historik i autorit. Faqosja është e re, me shkrim më të madh, hapësirë më të gjerë mes rreshtave dhe ilustrime.

Pjesët që mungonin në PDF-në e vitit 2015 janë përfshirë nga transkriptimi i plotë në shqip. Nuk janë përkthyer mbrapsht nga ndonjë gjuhë tjetër. Hollësitë dhe dallimet mes burimeve shënohen në fund të librit.

Ilustrimet e këtij botimi janë shtesa redaktoriale nga burime të dokumentuara në domenin publik ose me licencë CC0. Ato nuk janë figurat e botimit ALBANIANA 2015 dhe nuk paraqiten si ilustrime të botimit të parë të vitit 1899. Burimet dhe të drejtat renditen në fund.

Pohimet historike, gjuhësore, fetare dhe politike në tekst i përkasin autorit dhe kohës së tij. Figurat janë shoqërim pamor dhe nuk shërbejnë si vërtetim i këtyre pohimeve.

Përmbajtja dhe shënuesit e PDF-së hapin drejtpërdrejt nënkapitujt. Referencat e paragrafëve janë mbledhur në fund, që faqet e leximit të mbeten të pastra.

Botuesi, burimi dhe të drejtat

Botim digjital i publikuar nga Valon Asani · valonasani.com · 2026.

© 2026 Valon Asani, vetëm për ato kontribute origjinale në këtë botim që gëzojnë mbrojtje ligjore dhe për të cilat Valon Asani zotëron të drejtat.


Vepra origjinale: Sami Frashëri, Shqipëria – ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë? (1899). Burimi i tekstit: Fletoret, https://fletoret.com/sami-frasheri/shqiperia/.

Ky botim u përgatit me përdorimin e inteligjencës artificiale në vitin 2026 për transkriptimin dhe faqosjen në shqip. Nuk është shqyrtuar nga specialistë dhe mund të përmbajë gabime ose shmangie nga burimi. Për përdorim shkencor, konsultoni tekstin burimor.

Nuk pretendohen të drejta ekskluzive mbi tekstin origjinal të vitit 1899, materialin e gjeneruar tërësisht nga inteligjenca artificiale apo imazhet e palëve të treta. Njoftimet e burimeve, licencat dhe përcaktimet e domenit publik mbeten të pandryshuara. Burimet dhe informacioni për të drejtat e imazheve jepen te shënimet përkatëse.

I Ç’ka qenë Shqipëria

Pelasgëtë



P02 · Mbishkrime të Dodonës, botimi i Carapanos-it, 1878. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Shqipëri i thonë gjithë ati vëndi tek rrinë Shqipëtarëtë. Shqipëtarëtë janë m’i vjetër’ i kombevet t’Evropësë. Duketë që këta erdhë më parë se gjithë prej mezit t’Asisë n’Evropë, edhe këta prunë në këtë vënt ditjen’ e të bërit shtëpi me mur si edhe diturin’ e të lëruarit, të mbjellit e të korrurit; se ata njerës që gjendëshinë mê parë tyre n’Evropë ishinë t’egërë e roninë nëpër pyje e nëpër shpella, duke ushqyerë me pemëra t’egëra e me mish gjahu. P’andaj prindërëtë tanë të vjetërë u quajtënë Arbënë, fjalë të cilënë na Toskëtë, pas zakonit tënë që bëjmë n në r, e këthyemë në Arbërë, si e përdorim edhe sot. Do-me-thënë ky komp kaq’ i vjetërë thuhëshë që m’atëhere Arbënë a Arbân, do-me-thënë ata që punojnë arënë, që korrin’ e mbjellinë. Këtë fjalë Romanëtë e kanë këthyerë më Alban duke thënë edhe vëndit të tyre Albania, si e thonë edhe sot Evropjanëtë. Greqt’ e pastajmë

na thanë Arvanit, duke këthyerë prapë l në në r; edhe nga kjo fjal' e Greqet Tyrqitë kanë bërë fjalënë Arnaut, si na quajn' edhe sot. Po na vetë fjalënë Arbërë e kemi përrethuarë vetëm në një farë të kombit tënë të cilën' e themi edhe Lap; edhe kombi i tërë ka marrë emërinë Shqipëtar e vëndi ynë Shqipëri, fjalë të bëra prej shqipesë, zogut të bekuarë të Hyjit q'i falëshinë prindërit' e vjetërë tanë, edhe të cilit fytyrënë e kishimë edhe në flamurt. Po kjo fjalë duketë të mos jetë shum' e vjetërë a të mos ketë qënë që në kryet e përgjithçime, se vëllezëritë tanë që rojnë jashtë Shqipërisë, n'Itali, në Greqi e gjetkë nuk' e dinë, pô quhenë edhe sot Arbërë.

Mê të vjetërtë prindërt' tanë bota i quajnë Pelasgë, fjal' e mbeturë nga prindret tanë mê të pastajmë, të cilëtë quaninë mê të parët' e tyre Plak a Pleq. Si do të jetë, ky komp kaq' i vjetërë e kaq' i vjejturë për istorit ka qën' i shum' e i fortë e i përhapurë nëpër gjith' Evropet të Lindjesë. E tërë Sinisi e Ballkanit edhe përtej Tunësë, Ungria, Kroatia etj. si edhe Greqia e gjithë anët' e perëndimit t'Asis' së vogëlë, do-me-thënë t'Anatollit ishinë vënd' i Pelasgëvet, Shqipëtarëvet të vjetërë. Ca nga këta Pelasgë u hodhë përtej den' Adriatik, n'Itali; Etrusqitë, Llatinëtë e të tjerë kombe t'Italisë janë prej farës' së Pelasgëvet. Mê pastaj erth një komp i vogëlë q'i thoshinë Helen a Grek, e zu vënt në Greqi nëpër nisit të Pellgut Egje e nëpër anët të detit rotull, duke përzënë Pelasgëtë andej a duke përzjerë me ta. Pô edhe këta Helenë q'erdhë n'ata vënde ishinë prej një fare me Pelasgëtë, si edhe Shqehtë, Gjermanëtë Gjelttë a Galëtë e të tjerë kombe t'ardhurë ng' Asia, të cilëtë thuhenë gjithë bashkë Arianë, fëmij' e madhe që përpushton edhe Persetë. Indianëtë e të

tjerë kombe t'Asisë. Pô Llatinëtë janë mê t'afërë nga gjithë me na Shqipëtarëtë; p'andaj edhe gjuha jonë i ngjan shumë Llatiníshtesë e gjuhëvet që janë ndarë prej asaj, si italishtja, francishtja etj.

Pelasgëtë kishinë një besë të bukur' e vjershëtore. Besoninë gjithë shënjat' e naturësë, e trupet' e qjellit; i falëshinë djellit, hënësë, yjevet të mbëdhenj, qjellit, revet, erësë, detit e të tjerave. Vetëtima, gjëmimi, rrufeja e gjithë shënjat' e naturësë ishinë të shënjtëruara në syt të tyre. Zjarrë e kishinë në shumë nder, e më ca vënde s'e shuaninë kurrë. As në qeverit as në beset nukë doninë një vete që bën ç'do pô u kish ënda këshillën' e kuvendín' e shumëve. Kjo besë, të cilënë Greqt' e Llatinëtë e xgjeruan' e e xbukuruanë mê tepërë, ësht' edhe sot, n'Evropë e në gjithë botët të qytetuarë, bes' e vjershëtarëvet, të cilëtë në këtë gjejnë bukurin' e shienë q'u duhetë. Kjo besë që thuhetë mythologji është bes' e të parëvet prindër tanë Pelasgëvet.

Pelasgëtë, pas vëndevet që rrininë, ndahëshinë mê shumë fara e fise, nga të cilëtë mê të mbëdhenjt' e mê të njohuritë janë: Illyrianëtë a të Lirëtë (të Dlirëtë), Maqedonasitë, Thrakasitë (të Trashëtë). Frygasite etj. Nga këta Illyrianëtë ishinë në Shqipëri edhe në vëndet të veriut që thuhenë sot Bosnjë, Erzegovinë Mal-i-Zi, Kroati, Dalmati etj. gjer në funt t'Adriatikut e gjer përtej Savësë; Maqedonasit' e Thrakasitë rrininë në Maqedoni e në Thrakë; Frygasitë ishinë n'Asi që nga anët e detit gjer ne lumi Alis që thuhetë sot Këzëll-Irmak. Thuhetë që Illyrianëtë ishinë shumë t'afërë me Maqedonasit' e Thrakasitë me Frygasitë; pô të tërë ishinë një komp, edhe kupëtoninë gjuhën' e njëri-jatërit.

Gjer në kohët të Romanëvet gjithë këta kombe Pelasgë ishinë të gjallë e të tërë. Maqedonasitë që për së vjetëri kishinë një mbretëri miaft të fortë, e cila në kohët të Filippit u rit e u shtua shumë; edhe i bir' i këti Aleksandri i Math vuri në dorë mê të shumën' e botësë, që dihësh atëhere, Greqinë, Thrakënë, Asin' e vogëlë, Persinë, Indinë, Egjyptënë etj., pô jo Illyrinë e Epirrë, do-me-thënë Shqipërin' e sotme. Pas vdekjes' s'Aleksandrit Maqedonasitë bënë disa mbretëri n'Asi, n'Egjyptë e n'Evropë; pô duk me mos qënë të bashkuarë, duke ndarë në shumë dega e duke ngrën' e duke vrarë në mest të tyre, s'qëndruanë dot shumë kohë, pas pakë kohe u poshtuanë nënë Romanëtë, të cilëtë duallë me një forcë të madhe, e zunë gjithë vëndet' e Maqedonaset edhe Maqedoninë vete.

Romanëtë u dhanë funt Frygaset e Thrakaset, të cilëtë humpnë e u shuanë duke lëftuarë e duke përzjerë me disa komba q'u futnë në mest të tyre. Në Maqedoni diç mbahëshinë pô fort të përzjerë. Kur në të gjashtët shekull të Krishtit Bullgarëtë komp tatar edhe Serbet' e Kroatëtë kombe shqeh hynë në Sinisit të Ballkanit si mizëri, edhe mbuluan' edhe mê të shumën' e Maqedonisë, duke nxjerë Pelasgëtë andej a duke përzjerë me ta. Kështu humpnë Maqedonasitë, Thrakasitë, Frygasitë e të tjera fara të Pelasgëvet, perveç Illyrianëvet, të cilëtë janë drejt prindëret tanë.

I / Ç’ka qenë Shqipëria

Illyrianëtë e Epirotëtë



P03 · Përkrenare bronzi e tipit ilir. Ilustrim shtesë i këtij botimi.


Illyri e vjetërë nukë pushtonte të tërë Shqipërinë, se nukë unjësh mê poshtë Vijosësë nga juga; pô nga veriu ish shumë me madhe, se, sindëkur thamë, xgjatëshë gjer në Savë e gjer në funt t’Adriatikut duke përpushtuar’ edhe Bosnjën’ e të tjerë vënde. Që nga Vijosa e gjer në mëngët t’Ambraqísë (t’Artësë) cop’ e jugës’ së Toskëris’ së sotme quhësh Epir (Ipërë, Hipërë a Sipërë) fjalë shqip me të cilënë e përmentninë vëndësit’ e anës’ së detit së poshtërmi, edhe të cilënë Greqtë që qasëshinë atje për tregëri e dëgjuanë nga këta. Mbretëri e Illyrisë ish veçan, e Epirit veçan. Pô Illyrianëtë si edhe Epirotëtë nukë ishinë fare t’unjurë e të poshtuarë nënë këto mbretëri; ishinë të përndarë në shumë fara e fise, nga të cilëtë si-cili-do qeverisësh prej kështillës’ së parësísë e të pleqet të tyre. Këto kështilla quhëshinë Plakoni a Pleqësi.

Nga këto dy mbretërí, të cilatë, istorija na thotë, që kishinë miaft qytetëri, duallë disa mbretër të fortë e të ndrituarë, si Pyrrua a Burri mbret' i Epirit, që mundi Romanëtë e morri Greqinë, e si Tevta, mbretëresh' e Illyrisë e Gjençoja i bir' i saj, që qëndruanë kaqë kohë burrërisht kuntrë Romanëvet.

Pas të thënit të shkronjëtorëvet të Greqis' së vjetërë, Illyrianëtë, si edhe Epirotëtë, të cilëtë s'ndryshoninë nga ata me nonjë farë mendyre, roninë e ishinë si Shqipëtarët' e sotmë, pa nonjë ndryshim; edhe flisninë gjuhënë që flasimë na sot.

I / Ç'ka qenë Shqipëria

Shqipëtarëtë nënë Romanëtë


HISTORIA. 297

βασιλέως φιλοτίμους σύνταξις, τὸν σφαγέντα ὑπογραφὰ προαίμιον ἀσχημὸς τῆς αὐτοῦ τελευτῆς. τῆς γὰρ ἐκείνου ὑπηρεσίας ἐτύγχανε, καὶ διὰ τοῦτο ὄφιον λόγος ἐκράτησεν ὡς ἐκ μέσου τοῦτον κεκοῦφκεν ὁ Θεὸς οἷα τὰς βασιλικὰς ἀφορὰς f. 233 v.
καὶ εὐεργεσίας διακαλύπτα.

Ἐν ὅσῳ δὲ ταῦτα ἐπράττετο καὶ γαλήνη τις σταθερὰ ἐκ τῶν τυράννων ὑποσημαίνετο, ἱκετῶν τι σκάλλον ἢ ζιζάνιον διαφθεῖραι τὸν αἴτιον φιλονεικούν ἐκ τῆς Ἐπειδάμνου πόλεως ἀναφὺς καὶ διεσάνυστο. ὁ γὰρ ἀνὴρ ὑπὸ τοῦ προβλήτου Λευκίου ἀποσταλεὶς δοὺξ, ὁ πρωτοπρόεδρος Βασιλάκης, μετὰ τὸ φθάσαι παραλθεῖν τὸν Ἠρνένιον καὶ ἀπελθεῖν εἰς Ἀδριανούπολιν καταλαβὼν τὸ Δυρράχιον, στρατιὰν ἐκ πασῶν τῶν ἐνεστώτων ἐκεῖσε χωρῶν συνάλγετο, καὶ Θρᾴττιος μετανεμφθέντος ἐξ Ἰταλίας φιλετέρους δεξιώσεσι τῆς ἑαυτοῦ μαθείας καὶ συμμορίας ἐκεῖθεν δεξιῶς. ἤθροιζε γὰρ χρυσὸν ἐκ πάσης αἰτίας καὶ τρόπου παρὰ τῶν πειθομένων καὶ καταδυναστευομένων αὐτῷ, καὶ κατάλογον θέμενος πρόφασιν ἐποιεῖτο τῆς ταπείτης ἐπιλόσας τὴν κατὰ τοῦ Ἠρνενσίου ἐξ ἀναστάσου ἐπιθεσιν. ἐπὶ δ' ἔγνω πολύ τι στρατόπεδον συναγηγοχὼς καὶ ἐξάμιχον δύναμιν (εἶχε γὰρ καὶ Ῥωμαίων πολλὰν στρατιωτικὸν, Βουλγάρων τε καὶ Ἀρβανιτῶν, καὶ οἰκείους ὑπακοντὰς τὸν ὀλίγους), ὅρας ἐκεῖθεν πρὸς τὴν Θεσσαλονίκην ἡκείγετο. ἤδη δὲ καὶ αὐτοῦ ταύτην καταλαμβάνου-

beneficiis, postquam occisum scribam proœmium habuit mortis: ex illius enim ministerio erat, atque propterea fama dominabatur, e medio hanc auctoliser deum, ut regia dona et beneficia impolientem.

Dum autem haec aguntur et tranquillitas quaedam firma ex tyrannis significatur, alia spina vel zizanium perdere frumentum studens ex urbe Epidamno apparuit et intendebatur. etenim qui ibi a priore rege missus erat dux, primus praeses Basilaças, postquam praeservavit Bryennium et abiit Adrianopolin, occupavit Dyrrhachium et exercitum sibi ex omnibus ibi adiacentibus locis collegit: et Francos accessens ex Italia benigne donis in suum partem et coniunctionem transchochat desire. cogebat enim pecuniam ex omni causa et ratione ab ila, qui parebant ei et imperabantur, et tabellas faciens praetextum edidit talis armaturae persecutionem Bryennii ut ejusdem: postquam autem cognovit, se multum exercitum condixisse et pugnacem vim (habebat enim Romanorum multorum exercitum, et Bulgarorum atque Albanitarum et proprios propugnatores, non paucos), profectus inde Thessalonicam contendit: quam cum iam occupasset, fama ad eum pervenit, Botaniatem a toto senatu et conventu et popularibus et ab om-

P04 · Faqe nga botimi i Attaleiatit, 1853. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Illyrianët' e Epirotëtë, si qëndruanë shumë kohë kuntrë Romanëvet, më në funt forc' e madhe e këtyre e shumica i mundi, si edhe kaqë kombe të tjerë që kishinë poshtuarë

këta. Epirí atëhere ish i bashkuarë me Maqedonínë e me të qënë q'u mbajtnë shumë kohë e i vranë shumë ushtëri Paul Emilit krejt të ushtëris' së Romanëvet, ky njerí i egërë e zëmrë-gur dolli e prishi tetë-dhetë qytete në Toskëri e shpuri kaqë mijë skllef në Romë!

Kështu humbi dliri e Illyrianëvet e Epirotëvet, edhe këta vënde, do-me-thënë Shqipëria, hyni nënë urdhërit të Romanëvet. Pô Shqipëtarëtë, sado q'u muntn' e u vranë nuk' u poshtuanë e s'u bënë robër. Ishinë prapë e gjithënjë zotërinj në vëndit të tyre, e Romanëtë s'kishinë perveç se emënin' e zotëris' së vëndit. Për të pasurë pakë fuqi në Shqipëri kishinë sjellë disa kolonja Romanësh, e i kishinë vëndosurë nëpër vënde të fortë të Shqipërisë. Far' e këtyre kolonjave janë Vllehtë a Xinxarëtë që gjendenë edhe sot në vëndit tënë. Edhe udhën' e gjatë që kishinë goditurë që nga Durësi gjer në Salonik për të shpënë ushtëritë e për tregëri, e të cilënë e quaninë Ignatius nga fjala shqip e gjatë, mezi e ruaninë. Në vëndit të mbretërivet t'Illyrisë e t'Epirit ish mbretëri e Romanëvet, pô Shqipëtarëtë qeverisëshinë prapë prej parësis' e prej pleqësis' së tyre si gjithë jetënë.

Kështu qe Shqipëria e kështu roninë Shqipëtarëtë nënë Romanëtë. Kur u nda mbretëri e Romanëvet më dy, Shqipëria i ra mbretëris' së lindjesë, që kish qëndrënë në Konstantinopojë. Edhe nënë mbretëret të Konstantinopojësë Shqipëtarëtë ishinë, po thua, të dëlirë e qeverisëshinë në mest të tyre; ishinë zotërinj në vënt të tyre e jo robër. N'ato kohëra hyni edhe Krishtërimi në Shqipëri e më pakë kohë gjithë Shqipëtarëtë u bënë të krishterë, pô pa ndruarë vetiat' e zakonet' e vjetëra të tyre.

Duke dobëtuarë mbretëri e Konstantinopojësë shtohësh fuqi e dliri e Shqipëtarëvet. Pô me të shtatët shekull të Krishtit mizëri Shqehsh e Bulgarësh u sulë prej veriut e prej lindjesë e hynë me hir e me pahir në dhet të Byzantinjet. Nga këta Serbëtë mbushnë vëndet' e veriut t'Illyrisë, do-me-thënë Bosnjënë, Herzegovinënë, Dalmatinë Mal' e Zi e Serbinë, edhe Bulgarëtë përzjerë me Shqeh zunë Maqedoninë. Shqipëtarët' e Maqedonisë u hoqnë n'anët të veriut e të perëndimit në malet të Shqipërisë; ata të Illyris' së siperme nukë para iknë nga vënd' i tyre po u përzjenë me aqë shumë Shqeh, sa humpnë gjuhën' e tyre e zunë të flasinë serbisht. P'andaj mundimë të themi se Bosnjakëtë, Herzegovinasitë, Dalmatëtë e Mal-Zestë janë mê tepre Shqipëtarë se Shqeh; kanë shumë gjak Shqipëtari në rëmbat të tyre; shtati, fytyra, zakonetë, këngët' e vallet' e tyre e ç'do gjê i afron mê shumë ne Shqipëtarëtë se ne Shqeht' e tjerë, të cilëtë s'kan' atë shtat e atë fytyrë. Po me të qënë që sot flasinë serbisht, quhenë Shqeh e jo Shqipëtarë; se gjuha ësht' e para shënj' e të çquarit të kombevet.


Pra me këtë mendyrë u nda gjymës' e Illyrisë edhe gjymës' e Maqedonisë nga Shqipëria, e u bënë Shqehëri; edhe Shqipëria mbet një vënt i vogëlë që pushton gjymësën' e jugës' s'Illyrisë, gjymësënë (anën' e veriut e të perëndimit) e Maqedonisë edhe gjithë Epirë.

Në kohët të Romanëvet e të Byzantinjet u lan' e u haruanë emënatë Illyri, Maqedoni e Epir, edhe Shqipëria që mbet, si thamë, zu të quhësh në botët Albania, prej emënit shqip Arbëni. Q'atë her' e tëhu Shqipëria s'ka ndruarë kufi, ësht' edhe sot ajo, perveç pakë vënde q'i dhanë Serbis' e Malit të zi pas kuvendit të Berlinit, si Vranja, Leskovaci, Kurshunlia,

Ulqiní etj. Nga të shumët’ e këtyre vëndeve Shqipëtarëtë bënë faj të math t’ikinë, e lanë vëndin’ e tyre për jetë Shqehet, perveç Ulqinit që ka qën’ edhe është gjithë jetënë Shqipëri, edhe që pa ndryshim do të këthehetë një ditë e të bashkohetë me Shqipërinë.

I / Ç’ka qenë Shqipëria

Mbretërit’ e vogëla të Shqipërisë


HISTORIA
DE VITA ET GESTIS SCANDERBEGI EPIROTARVM PRINCIPIS.
Petrus Regulus Vicentinus ad Lectorē.
Hic Hostes fidei sanctę/ Victricibus Armis
Sedia Apostolicę/ sucubuisse leges,
Per claros hic Bella Duces mirabere, Belli
Ptlirranni Scanderbeg. Tibi fulmen Erit,
Magnanimi tum Marte Ducis/ Te Nosse iuuabit/
Sæpe feros Turcas, Stragibus esse datos,
Vt Veneto fidus ferret quandóq; leoni/
Dulcis opem/ gratum Manus Amicitię,
Nam sonat Id Nomen/ Turcarum Interpreta lingua/
Magnus Alexander, Lector Amice Vale.
Dñicus de Alzegnano Patauius.
Grandiloqum Si lector opus percureris alto
Ingenio, auctoris Nomen ad altra feres,
Hic Scanderbegum præclaro sanguine natum
Magnanimi eccinit fortia facta ducis,
Non fuit inferior magno non ille Camillo,
Cęsaris inuicti uiribus impar erat,
Gaudeat Epirus magni s tot clara triumphis,
Principis et nullas gesta superba fas.
Cum Priuilegio.

P05 · Faqja e titullit të veprës së Barletit, rreth 1508. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Në kohërat të fundit të Byzantinjet, kur këta ishinë dobëtuarë e s’u kish mbeturë fuqi as për të qeverisurë vëndetë as për të qëndruarë kuntrë armiqet, atëhere, si më ç’do vënt, edhe në Shqipërí ishinë çpikurë disa mbretëri, edhe shumë vënde të Shqipërisë mb’anë detit i kish zënë gjithurdhërim’ i Venetikut. Nga mbretëret’ e vegjëlë q’ishinë çpikurë atëhere në Shqipëri ca ishinë fjesht Shqipëtarë e ca të huaj pô të shqipëtaruarë. Nga të parëtë ish edhe fëmij’ e

Kastriotit, nga e cila dolli ndjesë-madhi Skënderbeu, në Krujë, fëmij' e Topjesë n'Artë etj; nga të dytatë ishinë fëmij' e Dukagjinit në malësi të Shkodrësë, fëmij' e Muzakësë në Myzeqe etj.

Kështu qe ndarë Shqipëria në shumë copa të cilatë s'mundimë t'i nëmërojmë të tëra mbretërirëra; mê të mbëdhatë munt të quhenë kështu, të vogëlatë ishinë kryesi e bojarëri, të cilatë nga dobëti e mbretërisë kishinë mbeturë më vetëhe e pa urdhërim. Në mest të këtyre copëravet edhe ndarjat' e grindat' e luftat' e përbrëndësme s'hiqëshinë kurrë.

Kur duallë Tyrqitë, e u hodhë ng'Asia n'Evropë duke marrë vëndet' e Sinis' së Balkanit, njërënë pas jatrit, Shqipëria qe ndar' e e përçarë në këtë mendyrë. Tyrqitë zun' e po i muntninë një nga një këta zotërinj q'urdhëroninë Shqipërinë; e ca i përzininë fare nga vënd' i tyre, ca i lininë, si i poshtonin' e pastaj. Një nga ata q'u poshtuanë kështu qe edhe Jan Kastrioti i at' i Skënderbeut, i cili u shtrëngua t'i apë Sulltan Muradit penk të katrë djemt' e ti të dashurë, m'i vogël' i të cilëve qe Gjerq Kastrioti që thuhetë Skënderbeg.

I / Ç’ka qenë Shqipëria

Shqipëria në kohët të Skënderbeut



P06 · Portret i Skënderbeut në veprën e Barletit. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Skënderbeu, kujt istoria s’i tregon nonjë shok a shëmbëllë në trimërit, në diturit të luftësë, në forcët si edhe në ditjet, në mendimt të drejtë, në njerëzit, n’ëmbëlsit të zëmrësë e në madhërit të shpirtit, Skënderbeu q’i ka dhënë edhe do t’i apë gjithë jetënë nder Shqipërisë, ky burr’ i pashoktë ish foshnjë kur ra ndër duart të Tyrqet, e u rit në plasët të Sulltanit; që pa mbirë qime në faqet të ti tregonte trimërira e bënte punëra n’ushtërit të Tyrqet që çuditësh gjithë bota; kudo që vinte muntte, e njeri s’i qëndronte dot kundrejt.

Kur u këthye Skënderbeu nga Syria, tek kish vajturë të lëftonte për Tyrqit, dëgjoj nga goj’ e Sulltanit vetë q’i ati kish vdekurë; po duk me qënë që pas kuvëndit e pas besësë që kish lidhurë i ati me Sulltanë, duhësh që një nga të bijtë të vinte në Krujë për të ndënjurë në front të tet, Skënderbeu

bashkë me vdekjen e tet mësoj edhe vdekjen' e të tre vëllezret të ti, të cilëtë s'muntninë të vdisninë nga Perëndia, kështu të tre për një herë. Trimi Shqipëtar nuk' ish aq' i pamënt sa të mos marrë vesh se ç'i gjet të mjerëtë të vëllezrë edhe që ajo do ta gjente edhe atë vetë. Edhe vërtet q'atë ditë zuri i zot' i ti ta nxirte në lufta e në mundje të rrepta e të rezikta që të vritësh, se ta vriste në shesh kish frikë nga ushtarët tyrq të cilëtë e doninë shumë Skënderbenë për trimërit e për zëmrëmirësit të ti.

P'andaj Skënderbeu priste një kohë që të muntte t'ikënj' e të vejë në Shqipëri, për të shpëtuarë edhe vetëhen' e ti edhe mëmëdhenë, për të cilën' i digjësh zëmra. Kohënë që kërkonte e gjeti, pa priturë shumë, edhe vate në Krujë, përzuri Tyrqitë andej, edhe ndenjti në front të tet. Gjithë zotërinjt' e të parët' e Shqipërisë u mbluadhë në Krujë, lidhnë fjal' e kuvënt e dhanë besë që të përpiqenë e të vdesinë për shpëtimt të mëmëdheut, duke njohurë të gjithë për krye e mbret të tyre Skënderbenë.

Kështu për së parë herë, Shqipëria u mbluath në një mbretëri me një mbret trim e të zonë si Skënderbenë. Tyrqitë në çast çuanë ushtërira të mbëdha për të marrë prapë Shqipërinë; pô Skënderbeu me Shqipëtarëtë u qëndronte kundrejt burrërisht, e me pakë shokë hidhësh si petriti mi mijëra Tyrqsh, e copëtonte ushtëri të tëra të Sulltan Muradit e Mehmedit, duke shtënë frikën' e tëmerrë në zëmrat të Tyrqet.

Dyzet e kaqë vjet qëndroj kështu Skënderbeu me Shqipëtarëtë duke vrar' e duke handakosurë armikëtë; e mbajti Shqipërinë të pamundur' e të paposhtuarë. Gjithë

Pushtetat' e Evropësë q'ishinë atëhere kishinë shpresë ne Skënderbeu, e prisninë shpëtimn' e Evropësë nga Shqipëtarëtë. Pô ata nuk' ishinë trima e burra si Skënderbeu as kishinë besën' e Shqipëtarëvet. Shumë herë Ungrëtë (Maxarëtë) e Papa e futninë Skënderbenë në zjart, pastaj hiqëshinë, e e lininë vetëm, duke vështuarë së largu. Me gjithë këtë Skënderbeu qëndroj e duroj; edhe Shqipëria në gjalljet të këti burri e ruajti dlirin' e saj me nder. Por me të vdekurit të Skënderbeut Shqipëria ra ndër duart të Tyrqet.

I / Ç'ka qenë Shqipëria

Shqipëria nënë Tyrqitë

Pas Skënderbeut e pas kohës' së këti burri, e cila, sado që shkoj e tërë me luftëra e me gjak, është m'e bukur' e m'e bekuar' e gjithë kohëravet për vëndinë tënë, se vetëm atëhere u mbloth i tërë me një qeverí të dlirë, e ju dëgjua emëni në gjithë botët me nder të math, nga të qëndruarit kundrejt Tyrqet, të cilëvet atëhere mbretëri të mbëdha s'u qëndroninë dot; pas kohës' së këti burri të ndjerë, themi, Shqipëria u bë një copë e mbretëris' së Tyrqisë.

Shqipëtarëtë, njerës trima e luftëtarë, kanë pasurë gjithë jetënë dëshirë të madhe për luftë, e luftën' e kanë quajturë një pun' e një fitim për vetëhe të tyre. Vininë nëpër gjith' anët t'Evropësë me armë në dorë, e bëninë të fitonj' ay q'i merninë anënë. Pas këti zakoni të vjetërë të tyre ishinë hedhurë edhe n'Asi, e kishinë hyrë në shërbim të tyrqet duke ndihurë këtyre me armë e me trimëri. Bajazid Pasha, burrë trim e me besë të fortë, që nxori Çelepi Sulltan Mehmednë

nga mez' i ushtëris' së Tamerlanit (Timur-Lengjit), e e shpëtoj nga mijëra rezike duke vënë vetëhen' e ti në rezik të math, e duke marr' atë shumë herë më krahë, e duke lypurë; ky Bajazid-Pashë që shpëtoj jetën' e ati Sulltani pa të cilënë mbretëri e Tyrqet e fëmij' e Osmanit ishinë të shuara e të humbura për jetë ky ishte Shqipëtar si edhe shumë të tjerë pashanj e të mbëdhenj njerës që kanë treguarë trimëri të madhe e shërbime të rënda n'ushtërit të Tyrqet shumë kohë mê parë se të merretë Shqipëria prej Tyrqet.

Kështu Shqipëtarëtë kishinë zënë të marrënë besën' e Tyrqet e të bëhenë myslimanë që pa rënë Shqipëria në duart të Tyrqet. Pô si u bënë këta zotërinjt' e Shqipërisë, këthyerj' e besësë u shtua shumë mê tepre, edhe më të gjith' anët të Shqipërisë zunë të marrënë besën' e mundëset, duke thënë tek është kordha është besa. Shqipëtarëtë kanë këtë vetië që rëndonenë çpejt nga një besë, e duanë gjithënjë ta ndërojnë; si pan' edhe që Tyrqitë s'u bëjnë nder atyre që s'janë në beset të tyre, s'përtuanë për të marr' atë besë. Pô edhe ata që mbenë të krishtenë nuk' u poshtuanë e të bëhenë raje si kombet' e tjerë, pô mbajtënë armëtë e nder' e tyre, edhe vininë edhe këta në luftë, e lëftoninë bashkë me vëllezrit' e tyre myslimanë kuntrë armikëvet të Tyrqisë.

Puna që donte mbretëri e Tyrqisë u erth mbarë pas vetiës' së tyre. Luftëra të paprera, lodëra e vrape me kuaj, rrëmbime, vrasje, presje e të tjera të këtilla gjërëra që doninë Tyrqitë këto ishinë punërat' e dashura edhe të Shqipëtarëvet. Tyrqitë gjetnë në Shqipëtarët, një shok të luftësë të fortë e të besësë; edhe Shqipëtarëtë gjetnë në Tyrqit një zot q'u hapte përpara një shesh të gjer' e të çpenguarë për të bërë gjith' ato q'u donte zëmra.

Shqipëria në kohët të Tyrqet u bë m'e pasurë e m'e begatë se kurdo; se Shqipëtarëtë sulëshinë bashkë me Tyrqitë nëpër gjith' anët të botësë, edhe këthehëshinë ngarkuarë me ar e me ergjënt, me armë të vjejtura e me kuaj të bukurë t'Arabisë, t'Egjyptësë, të Qyrdistanit t'Ungrisë etj. Me të qënë mê trima e mê të zottë se Tyrqitë, shkoninë edhe nëpër mê të mbëdhenjt e mê të nderçimit vënde, e kishinë mê tepre nder se ata vetë Tyrqitë. Vetëm sadrazeme, do-me-thënë Vezirë të mbëdhenj, janë bërë afro 25 Shqipëtarë, edhe mê të mirët' e mê të dëgjuarët' e atyre që kanë ndënjturë në këtë vënt janë Shqipëtarë.

Pa le në Shqipëri që s'vinte kurr' i huaj. Gjith' ata që qeverisininë Shqipërinë, të vegjël' e të mbëdhenj, ishinë të gjithë e gjithënjë Shqipëtarë. Mundimë të themi se Shqipëria qeverisësh me vetëhe prej Shqipëtarësh e me zakonet' të saj. S'ish poshtuar as pakë nënë Tyrqet, e s'paguante gjë përveç gjaknë që derthte në luftë edhe i cili i paguhësh e çpërblehësh fort shtrenjt.

Kjo është ngaja që kanë lidhurë Shqipëtarëtë me Tyrqit. Shqipëtarëtë gjeninë ne Tyrqit atë që doninë: gjë, nder, armë, kuaj, rrëmbime sa të doninë edhe dliri sa u duhësh; edhe Tyrqitë gjeninë ne Shqipëtarët atë që doninë: trimëri, besë e gjak të derdhurë pa kurcim.

Kështu qenë punëratë gjer në kohët të tenzimatit; do të shohëmë mê poshtë se qysh u ndruanë q'atëher' e tëhu.

I / Ç’ka qenë Shqipëria

Kombëri e gjuh’ e Shqipëtarëvet



P07 · Faqe e Mesharit të Gjon Buzukut, 1555. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Shqipëtarëtë flasinë një nga mê të vjetërat’ e mê të bukuratë gjuhë të dheut. Gjuhëratë që kanë qënë shoqet’ e motërat’ e Shqipesë kanë mijëra vjet që kanë humburë e s’flitenë në nonjë vënt të dheut; po në vëndit t’atyre përdorenë mbesat’ e stërmbesat’ e tyre. Shqipja është shoqe me greqishten’ së vjetër, me Llatinishtenë, me Sanskrishtenë, gjuhën e Indis’ së vjetërë, me zendishtenë, gjuhën’ e Persis’ së vjetërë, me Qeltishtenë, me Tevtonishtenë etj. Pô këto gjuhëra që nëmëruamë, nga të cilatë ca kanë qënë motra të vogëla të shqipesë e shumë mê të ra se ajo, këto gjuhëra, them, kanë mijë a mijëra vjet që nukë po flitenë mê, e s’rojnë përveç se më faqet të ca livrave të vjetëra. Ato quhenë gjuhëra të vdekura, e shqipja, gjuha jonë, q’është m’e vjetërë nga ato ësht’ e gjallë, e flitetë edhe sot si në kohët të Pelasgëvet.

Pa ndryshim Pelasgëtë janë m'i vjetr' i kombevet arianë t'Evropësë. Kemi shumë shënja e shumë dëftime, të cilatë dëftejnë faqeza që ata Pelasgë, që na dukenë si përallë nga vjetëri e tepër' e tyre, kanë folurë këtë gjuhë që flasimë na sot. Emënat' e perëndivet q'u falëshinë Pelasgëtë e prej të cilëvet i ka marrë mythologji e Grekëret e e Romanëvet edhe shumë fjalë të tjera që na ka ruajturë istoria e emëna vëndeve etj. dukenë që janë fjalë fjeshtë shqip, edhe na tregojënë që Pelasgëtë kanë folurë kaqë mijë vjet më parë këtë gjuhë që flasimë na sot po-thua pa ndryshim a me aqë pakë ndryshim, sa të muntte të delte sot një Pelasg, do të muntnimë të flasimë me tê si flet një Gegë me një Toskë a një Çam me një Gorar.

Shkronjëtor' e gjuhësë shqip, të përkëthyerët' e fjalëvet n'aqë fytyrëra, hollësi e nyjevet, e përemënavet e të tjera bukuri, që s'i ka nonjë nga gjuhët' e sotme e të cilatë edhe gjuhët' e vjetëra s'i kanë kaqë të mbaruara e të tepra, gjithë këto gjërëra e rrëfejnë që shqipja është një gjuhë fort e vjetërë, e mbeturë që nga kohërat' e qëmoçime e të përallta e e ruajturë sindëkur qe pa prishur' e pa ndryshuarë.

Shënj' e kombërisë është gjuha; ç'do komp mbahetë me gjuhët; ata njerës që harojnë a lënë gjuhën' e tyre, e flasinë një tjatrë gjuhë, me kohë bëhenë njerëzit' e ati kombi q'i flasinë gjuhënë, e dalinë nga kombëri e tyre. Kaqë kombe që janë shuarë, mos pandehni se vdiqn' a u vranë të tërë; jo kurrë; pô u përzjenë me të tjerë kombe, muarrë gjuhën' e atyre, edhe u bënë nga ata pa të çquarë.

Kështu janë shuarë Maqedonasitë, Thrakasitë, Frygasitë, Illyrianët' e sípërme e kaqë gjindje të tjerë q'ishinë Pelasgë

do-me-thënë Shqipëtarë si na, e që sot s'janë, se u shuan' e u haruanë duke humburë gjuhën' e tyre. Por Shqipëtarët' e atyre vëndeve që quhenë sot Shqipëri e kanë ruajturë fort mirë gjuhën' e tyre; e kështu flitetë edhe sot n'atë copëzë vënt gjuh' e vjetërë e Pelasgëvet të përallavet.

Qysh e kanë ruajturë dot Shqipëtarëtë gjuhën' e tyre të tër' e të paprishurë nëpër mest të kaqë kohërave t'egëra? Qysh gjuha shqip s'është prishur' e ndryshuarë, duk me mos pasurë shkronja e livra e duk me mos shkruar' e kënduarë nëpër shkolla, kur gjuhëra të shkruara e të ndërtuara me kujdes të math janë prishur' e ndryshuarë aqë sa të quhenë gjuhëra të tjera? Përgjigj' e këtyre pyetjeve është fort e lehtë: Shqipëtarëtë e kanë mbajturë gjuhën' e kombërin' e tyre jo me shkronja as me dituri as me qytetëri, pô vetëm me dliri, me të qënë gjithënjë vetëm e më vetëhe, me të mos përzjerë me të tjerë e me të mos kallurë të huaj në vëndit të tyre. Të qëndruarëtë lark nga gjithë bota, nga dituritë, nga qytetëria, nga tregëria, me një fjalë, të rojturitë si të egërë nëpër malet u ka ruajturë e shpëtuarë Shqipëtarëvet gjuhën' e kombërinë.

Qysh Shqipëtarëtë nukë janë menduarë kurrë të shkruajn' e të këndojnë gjuhën' e tyre? Kjo është një çudi e madhe. Nukë themi për ato fara e fise të vogëla e të përndara të Pelasgëvet e t'Illyrianëvet të vjetërë, se ata duke rojturë si t'egërë nëpër malet nukë shihninë nonjë nevojë për këtë, e s'u vinte ndër mënt kurrë një gjë e këtillë. Pô Maqedonasitë që kishinë një mbretëri të goditurë, si edhe mbretëri e Pyrrosë n'Epir e Tevtësë n'Illyri, qysh nukë panë nevojë të shkruajnë në gjuhët të tyre? Filippi që përpiqësh të ritte Makedonin' e të pushtonte Greqinë qysh nukë desh të bënte edhe gjuhën' e ti

të shkruarë si greqishtenë? Alexandri, të themi, s'pat kohë, e pô Ptolemenjtë, që xgjuanë diturit' e gjuhën' e Greqet n'Aleksandrië, qysh nuk' u menduanë edhe një herë për gjuhën' e tyre, t'i bëninë një palë shkronja, duk me qënë që shihninë gjithë kombet' e Asis' e t'Egjyptësë që shkruaninë si-cili-do gjuhën' e ti? Romanëtë mësonin' edhe ata gjuhënë greqisht edhe filosofin' e gjithë dituritë i këndoninë në këtë gjuhë, pô kishinë bërë edhe shkronja në gjuhët të tyre, Llatinishtet, edhe shumë gjërëra i shkruanin' e i këndoninë në këtë gjuhë.

Doktor Hani i madhi filolog Alëman, që ka shkruarë shumë të vërteta për Shqipërinë, ka gjeturë më nj'anët të Shqipërisë një gur të shkruarë shqip me ca shkronja të cilatë u ngjajnë shumë shkronjavet finiqishte, edhe dukenë të mara prej atyre, pa qën' ato vetë. Pô këto shkronja s'janë parë gjetkë, as dihetë të kenë qënë të përdorura në Shqipëri. Ca varre e të tjerë gurë të shkruarë me shkronja greqishte n'Asi të Vogëlë afr' Angorësë edhe ca të tjerë shkruara me shkronja Llatinishte n'Etrurië t'Italisë, e të cilavet gjuha s'është as greqisht as llatinisht, duketë të jenë shkruarë më gjuhë shqip prej Frygaset e Etruskëvet të vjetërë të cilëtë ishinë Pelasgë do-me-thënë Shqipëtarë. Pô edhe këto janë gjë të paka e të vetëme. Merretë vesh në Shqipëtarëtë që motit kanë shkruarë herë herë në gjuhët të tyre me ato shkronja që dininë, sindëkur edhe tani pastaj që shkruaninë ca me shkronja arabishte, ca me greqishte e ca me Llatinishte. Këto janë gjërëra të paka, e Shqipëtarëtë s'janë menduarë kurrë të goditinë një palë shkronja për të shkruarë gjuhën' e tyre; edhe shqipja kish mbeturë gjer në kohët tënë gjuhë e pa shkruarë.

I / Ç'ka qenë Shqipëria

Shqipëtarëtë gjithënjë për botën' e kurrë për vetëhe

Sindëkur thamë mê siprë, Shqipëtarëtë gjithëmonë janë vrar' e përpjekurë e kanë çpërkaturë të tërë faqen' e dheut me gjakt të tyre; pô nga gjaku i Shqipëtarëvet të tjerë kanë fituarë, Shqipëria s'ka parë nonjë të mirë. Shumë Shqipëtarë janë çquarë e kanë treguarë vetëhenë në dituri e në të tjera gjërëra; pô me këta të tjerë mburenë e jo Shqipëtarët' e Shqipëria.

Me Pyrron' e me Aleksandrinë mburenë Grekëritë e i quajnë Grekër. Maqedonasitë që, me trimërit të tyre muarrë gjithë botënë në pakë kohë, nuk' i suallë nonjë të mirë Shqipërisë, pô Grekëritë, q'ishinë armikët' e tyre, u ranë pas e i rrethuanë, edhe këta fituanë nga gjaku që derdhë ata. Se Maqedonasitë përndanë nëpër gjithë vëndet që muarrë gjuhën' e qytetërin' e Greket, e jo të tyrenë, q'ish shqipja. E shum' e botësë edhe sot Maqedonasitë i zënë për Grekër. Vërtet, të mos ishinë Maqedonasitë gjuh' e Greqet e qytetëri e tyre do të mos kish marrë dot kurrë këtë bujë që ka sot, edhe mbase do të kish humbur' e t'ish haruarë fare; se shkoll' e Aleksandrisë edhe të dituritë q'arrinë n'Egjyptë në kohët të Ptolemenjet e bënë gjuhën' e qytetërin' e Greqet të përndahetë e të dëgjohetë mi gjith' anët të dheut. Ptolomenjtë q'ishinë fjeshtë Shqipëtarë nga Çamëria e gjithë Maqedonasitë lanë gjuhën' e tyre shqipenë më nj'anë të haruarë e të paditurë, e vunë përpara greqishtenë, gjuhën' e Dhimosthenit që ka folurë aqë kuntrë Maqedonaset.

Pas Grekëvet erdhë Romanëtë; edhe këta fituanë shumë nga Shqipëtarëtë: trimëri e Shqipëtarëvet e mendj' e tyre shërbente mburjen' e Romanëvet e jo të tyrenë. Shumë njerës trima e të diturë kan' arriturë edhe në kohët të këtyre në mest të Shqipëtarëvet, pô bota i ka njohurë si Romanë e jo si Shqipëtarë.

Pas Romanëvet u erth radha Tyrqet. Shqipëtarëtë duke përzjerë me Tyrqitë kanë marrë anë në gjithë luftërat që bëninë e që fitoninë këta kuntrë gjithë botësë; edhe mê të madhenë trimëri e mê të miratë punëra i bëninë Shqipëtarëtë, pô emëninë e kishinë Tyrqitë, edhe gjithë bota i dinte Tyrq, e njeri s'i njihte si Shqipëtarë. Mê të mbëdhenjt' e mê të mírët' e Vezirëvet të Tyrqisë ishinë Shqipëtarë, si Sinan-Pasha që ka marrë Jemenë e ka shpënë Fjamurin' e Tyrqisë gjer në detet t'Indisë, si Qyprilinjtë q'e kanë shpëtuarë mbretërin' e tyrqisë nga një rezik të math e e forcuan' aqë këtë mbretëri sa van' e rrethuanë Vjenënë. Edhe shumë të tjerë njerës të mbëdhenj e burra trima kan' ardhurë prej të cilëve Tyrqia ka fituarë shumë, pô Shqipëria as pakë.

Në kohërat të pastajme Shqipëtarëtë myslimanë kanë punuarë e janë vrarë për Tyrqitë, e Shqipëtarët' e krishtenë për Grektë, për këta dy kombe, të cilëtë, as njëri as jatri, s'ua dinë të mirënë, e ja u çpërblejnë me të keqe duke përpjekurë për humbjen' e kombit shqipëtar. Boçari, Xjavella, Miauli e të tjerë mê të shumët' e trimavet që janë përpjekurë për ngjalljen' e për dlirin' e Greqisë kanë qënë fjeshtë Shqipëtarë e jo fare Grek; pô nga trimëri e tyre ka fituarë shumë Greqia e jo fare Shqipëria. Në syt të botësë lëftoninë Greqtë me Tyrqitë, pô në të vërtetë lëftoninë Shqipëtarët' e krishtenë me Shqipëtarëtë myslimanë. Kur muntnin' ata, fitonte

Greqia; kur muntninë këta, fitonte Tyrqia; pô gjaku që derdhësh nga të dy anëtë ish gjak Shqipëtari. Shqipëtarëtë vritenë vëlla me vëlla, të tjerë fitojnë. Shqipëtari e ka derdhurë gjithënjë gjaknë pa kurcim, pô e ka derdhurë kot; kurrë Shqipëria s'ka fituarë nga gjaku i Shqipëtarëvet: gjithënjë të huaj edhe armikë të Shqipërisë kanë fituarë nga ay gjak i vjejturë e i derdhurë pa mendim!

Jo vetëm me kordhë e me gjak, pô edhe me pëndë e me mënt Shqipëtarëtë kanë shërbëtuarë gjithënjë të huajtë. Me të mos shkruarë gjuhën' e tyre janë shtrënguar të shkruajnë greqisht, llatinisht, shqahisht, tyrqisht a arabisht; edhe me emënit të tyre mburenë të zott' e këtyre gjuhëve, e Shqipëtarëtë pandehenë t'egër' e të paditurë, gjith' i qeshinë duke thënë se ja u ka ngrënë buallica livrën' e tyre. Pô Aristoteli m'i madhi' i filosofëvet të Greqis' së vjetërë ishte maqedonas, do-me-thënë Shqipëtar e jo grek. Vërtet në Stagjyrë, tek ka lindurë, ishinë edhe ca Greq t'ardhurë, pô fytyr' e Aristotelit që shohímë n'agalmet të ti edhe gjuha greqísht q'e ka shkruarë të përtuarë e jo aqë të drejtë si edhe miqësia që kish me Filipnë, anëmikn' e Greqet, e të tjera shënja tregojnë që ky filosof i math nukë ish lindurë prej nonjëj nga Greqtë që kishin' ardhurë në Stagjyrë, pô prej një stagjyraku vëndës, e ish maqedonas, do-me-thënë shqipëtar i fjeshtë.

Në kohët të Tyrqet kan' ardhurë shumë Shqipëtarë të diturë që kanë shkruarë livra e vjersha tyrqisht a arabisht. Vetëm vjershëtarëtë shqipëtarë që kanë shkruarë vjersha tyrqísht janë aqë të shumë, sa emënat' e tyre munt të mbushinë një livrë të tërë. Jahja-Beu, q'është një nga mê të mbëdhenjt' e nga mê të dëgjuarët' e vjershëtarëvet tyrq, është shqipëtar.

Shqipëtarët' e kanë treguarë gjithë jetënë që janë të zottë edhe me kordhë edhe me pëndë, edhe me trimëri edhe me mënt e me dituri, e Shqipëria ka nxjerrë shumë njerës të çquar' e me nam të math, pô nonjë nga ta s'ka punuarë për Shqipërit, e cila ka mbeturë gjithënjë e varfërë e e padëgjuarë, e me djemt' e saj mburenë të tjerë vënde e të tjerë kombe.

Është ndodhurë një shqipëtar i zoti të ngjallnjë Egjyptënë, e të bënjë prej këti vëndi të humbur' e të prishurë, si ish atëhere, një vënt të pasur' e të ndrituarë, si është sot. Një Mehmet-Ali, shqipëtar i pamësuarë, u ndoth i zoti të shpëtonjë kështu një vënt të huaj e të largë; pô kurrë një shqipëtar s'është ndodhurë t'i bënjë Shqipërisë një të mirë të këtillë.

P'andaj duke mbaruarë këtë fjalë, themi prapë me hidhërim zëmre që: Shqipëtarëtë kanë punuarë gjithëmonë për botënë, e jo kurrë për vetëhe. Vetëm një Skënder-be ka punuarë, në kohërat të shkuara, për Shqipërinë e vetëm ay është me të vërtetë mburje për Shqipërinë.

II Ç'është Shqipëria

Kufit' e Shqipërisë

Pamë mê siprë se sa i gjerë ka qënë një herë që moti vëndi që rrininë Shqipëtarëtë, edhe sa ishinë të përhapurë prindëretë tanë, e qysh ishinë të ndarë në Illyrjanë, Epirotë, Maqedhonas, Thrakas, Frygas etj. Pam' edhe qysh në kohët të Romanëvet Maqedonasitë, Thrakasitë e Frygasitë, duke përzjerë me kombe të tjerë, zunë të humbisninë gjuhën' e kombërin' e tyre, e qysh mê pastaj, në kohët të Byzantínjet, erdhë mizëri Shqehsh në Sinisit të Balkanit, e zunë Thraqn' e Maqedhoninë edhe Illyrin' e Siperme.

Që m'atëher' e tëhu Shqipëria është vogëluarë shumë; nga gjith' ata vënde, që kishinë prindërit' tanë Pelasgëtë, vetëm Illyri e Poshtërme a e Jugësë, Epiri edhe Maqedoní e Siperme a e Veriut e e Perëndimit kanë mbeturë Shqipërí. Por sot emënatë Illyrí, Epír, Maqedhoní etj. janë të lën' e të haruarë, janë emëna të dheshkronjës' së vjetërë; sot për sot vëndi që rrinë Shqipëtarëtë thuhetë Shqipërí në gjuhët tënë edhe Albania në gjuhërat të huaja.

Shqipëria është një cop' e Sinisis' së Balkanit në jugë-lindjet t'Evropësë. Ka zënë mez' e anës' së perëndimit t'asaj sinisije, duke xjaturë mb'anë detit Adriatik e detit Jonës që nga shkalla 42° gjer në Mënget t'Artësë mê poshtë shkallësë 39°. Kufit' e veriut të Shqipërisë, me të ndarë nga an' e detit ngjitenë drejt veriut duke rreshturë në kufit të Malit-të-Zi e Novi-Bazarit gjer në kufit të Serbisë mê siprë shkallësë 43°. Kufit' e jugësë kthehenë prapë drejt veriut me lumët t'Artësë e me kufit' të Greqisë gjer në Zhigo. Sa për kufit' e lindjesë

një vijë e hequrë që nga kufit' e Serbisë afrë Vranjësë gjer në kufit të Greqisë në Mali Zhigo, vijë e cila do të hiqetë nëpër krehëret të malevet tek ndahenë ujëratë e nëpër lumënjt, duke vështuarë sa mundetë kombëri e njerëzet do-me-thënë duke marrë brënda vëndet' e ndënjturë prej të tjerë kombeve, një vijë e këtillë do të ndanjë Shqipërinë nga të tjeretë vënde të sinisisë. Kështu Shqipëria ndahetë gjatazi në mest të 39° e të 43° shkallës' së veriut edhe gjerazi në mest të 17° e të 19° 25' shkallës' së lindjesë. Është pra afro 450 qilometra e gjatë e 200 qilometra e gjerë; edhe përcipj' e saj ësht' afro 80,000 qilometra të katërçipta.

Shqipëria nga veriu ka kufi e fqinjë Mal'-e-Zi, Novi Bazar, a Bosnjënë q'e urdhëron Austria edhe Serbinë, nga lindja ka Maqedoninë, nga jugë-lindja Greqínë, nga jugë-perëndimi e nga perëndimi ka detnë i cili e ndan nga Italia e nga Evrop' e qytetuarë.

II / Ç'është Shqipëria

Vënd' i Shqipërisë

Ky vënt q'ësht' i rrethuarë me këto kufi që treguamë është Shqipëria, mëmëdheu yn' i dashurë. Është një nga mê të bukurat' e vëndevet t'Evropësë. Mbase s'ësht' aq' i pasurë e aqë pellor, pô është shum' i bukurë. Është malësi, ka male të lartë me shkëmbënj të rreptë e të çkrepëtuarë, pô edhe me pllaja të mveshura, me pylle të dëndurë, me ujëra të ftohëtë, me trape që mbajënë dëborënë në verë, me lule të bukura, me barëra q'ushqejnë bagëtinë, e shrojnë njerëzinë, me metale që flenë nënë dhet që kur është kryerë bota e tëhu. Ka fusha të gjera nëpër të cilat rjedhinë lumënj që mundinë t'i ujitinë e t'i bëjnë kopshta, pô sot për sot, nga të qënëtë pa zot, i mbytinë e i bëjnë moçale. Vetëm fush' e Myzeqesë është miaft t'ushqenjë gjithë Shqipërinë, po të hapenë lumënjtë. Fush' e Kosovësë, fush' e Manastirit, vëndet' e Tetovës' e t'Ysqypit janë nga mê të bukuritë vënde të dheut që bëjnë drithë shumë e pemë më të bukurat' e dheut. Bregoret' e Çamerisë të mveshura me ullinj e kopshtat' e portokallevet e të limonjet janë pa shok. Gjith' an' e detit ësht' e mbuluarë me ullinj e me pyje të bukurë, edhe portokalletë bëhenë gjer në mest të Shqipërisë, n'Elbasan. Lumënjt' e perenjt' i ka të shumë. Këta me pakë të ndërtuarë munt t'ujitinë shumë dherëra, edhe shumë syresh munt të hapenë, e të punojnë ania nëpër ta që nga gryk' e tyre gjer shumë siprë. Shqipëria ka mê të mbëdhat' e mê të bukuratë këneta të Sinísis' së Balkanit, si kënet' e Shkodrësë, e Ohrisë, e Prespësë, e Kosturit, e Janinësë etj. Të gjitha këto këneta janë plot peshq e munt të lëvrijnë nëpër to disa vapore.

Shqipëria ushqen edhe sot shumë bagëti e gjërëra të gjalla të vjejtura: dhën, dhi, lopë, kuaj etj. Dhëntë këverxike e ruda të Shqipërisë mbushinë Stambollë e gjithë vëndet' e Tyrqisë me mish të mirë edhe Shqipërinë me lesh. Myzeqeja munt të nxjerrë shumë kuaj, të cilëtë, sado që janë pakë të vegjëlë, janë të fortë e ecinë shumë mirë. Shqipëtarëtë kanë shumë dëshirë e dinë të mbajnë bagëtí e ç'do farë gjë të gjalla. Sikur t'ishte një qeveri që t'u tregonte lehtësi e t'u hapte udhënë, e të dinin' edhe mësimn' e bagëtivet qysh shtohenë, qysh ngjallenë e qysh rritet' e xbukurohetë far' e tyre, do të muntninë të roninë edhe vetëm me bagëti.

Me një fjalë, Shqipëria, sado q'ësht' e vogëlë, ka ç'do farë klime e ç'do farë dheu edhe shumë begati e shumë të mira. Të vështohetë mirë, munt të vejë shumë mbarë, e t'ushqenjë katrë herë mê teprë njerës se sa ushqen sot.

II / Ç'është Shqipëria

Njerëzit' e Shqipërisë, Shqipëtarëtë

Brënda në kufit që treguamë siprë, Shqipëria ka afro 2,000,000 njerës a edhe mê teprë. Nga këta no 100,000 janë Vlleh a Xinxarë në malet të Pindosë edhe nëpër të tjerë vënde të përhapurë; edhe aqë të tjerë munt të jenë Grekër, rrotull Janinësë, e Shqeh në fushët të Manastirit e nga anët' e Kosôvësë. Pô edhe këta munt të jenë Shqipëtarë që kanë haruarë gjuhën' e tyre e kanë nxënë greqishten' a shqahishtenë në shkollë e në kishë. Edhe shumë nga këta s'kan' as dhe as shtëpi të tyre, pô janë bujqër në dhe të të tjerëve, të cilëtë i kanë sjellë së largu për të punuarë dhen' e tyre në kohëra që Shqipëtarëtë s'muntninë të lininë pushkënë për të marrë kazmënë në dorë.

Gjithë të tjerëtë vëndës të Shqipërisë janë fjeshtë Shqipëtarë, të ndarë më Gegë e Toskë. Shkumbija ndan Gegërinë nga Toskëria, pô edhe në jugët të këti lumi ka pakë Gegë e flitetë në ca vënde gegërisht. Në mest të Gegëvet e të Toskëvet nukë ka nonjë ndarje me rënjë. Të gjithë janë një komp, flasinë një gjuhë me fort pakë të ndruarë, të cilëtë do të ngrihetë fare për s'afri duke ndërtuarë gjuha. Edhe nga besa Shqipëtarëtë ndahenë më myslimanë, që janë dy të treta, e më të krishtenë, që janë një e treta. Të krishtenëtë ndahenë afro për gjymësë më katolikë a Llatinë, si i themi, edhe më orthodhoksë. Në Gegëri të krishtenëtë janë katolikë, në Tosqëri, orthodhoksë. Edhe myslimanëtë janë të ndarë më synninj e Bektashinj.

Pô këto ndarje të besësë nukë sjellënë nonjë ç'qim e çarje në mes të Shqipëtarëvet. Grindat' e besësë, të cilatë, jo vetëm në vëndet të Lindjesë pô edhe n'Evropë e në vënde të ndrituara me qytetërí, shumë herë kanë nxjerrë vrasje të mbëdha e të tëmeruara, në Shqipëri këto grinda nukë dihenë, edhe kurrë në këtë vënt s'ka ngjarë gjë në mest të myslimanëvet e të të krishtenëvet, në mest të katolikëvet e t'orthodhoksëvet a në mest të synninjet e të bektashinjet. Shqipëtari është shqipëtar përpara se të jetë mysliman a i krishtenë. Ç'ka qënë kur kish besën' e ti, besën' e Pelasgëvet, ay qe edhe si u bë i krishtenë, ay është edhe si mori besën' e Muhamedit. Besa s'e ka ndruarë fare edhe kurrë, se vë gjithënjë kombërinë përpara besësë.

Me fuqit të kësaj lidhjeje e të kësaj dëshire që kanë mbajturë gjithëmonë brez pas brezi me kombërit të tyre, Shqipëtarëtë kanë mundurë të ruajnë kombërin' e gjuhën' e tyre nëpër mest të kaqë rezikeve q'i kanë mbyturë kohë më kohë. Me gjithë ndryshimet' e besësë, me gjithë ndryshimet' e kohëravet, Shqipëtarëtë janë edhe sot ç'ishinë këtu e kaqë mijë vjet më parë; janë Pelasgët' e kohëravet të përallave, Illyrinjt' e Maqedonasit' e kohëravet të vjetëra, Epirotët' e kohës' së Skënderbeut. Janë një komp shum' i vjetërë që ka mbeturë gjer më sot si ka qënë që në kryet.

Shqipëtarëtë kanë gjithë ç'i duhetë një kombi: Janë aqë trima e të fortë, sa duk me qënë më pakë se 2 miliunë njerës burra e gra, po të shtrëngohenë, mundinë të nxjerrinë 300,000 a edhe më teprë ushtarë, të cilëtë janë mbaras me një miliun të një kombi tjatërë. Trimërin' e Shqipëtarit edhe fuqin' e forcën' e ti në luftë nuk' e themi vetëm na Shqipëtarëtë; pô edhe anëmikëtë tanë s'e pshehinë dot, e e thonë përherë. Pô

q'është kështu, s'ka ndryshim që Shqipëtarëtë janë të zottë të ruajnë vëndin' e tyre kuntrë ç'do anëmiku e ç'do reziku. Duhetë pra që Shqipëria të mos shkeletë kurrë prej të huajsh, e të mbanjë gjithënjë dlirin' e saj. Shqipëtari trim e i fortë, pse të mos jetë zot' i Shqipërisë, pse të mos urdhëronjë në vëndit të ti?


Shqipëtari s'është vetëm i fortë e trim, pô edhe i xgjuarë mé teprë se ç'do komp. Në ç'do shkollë, në ç'do mësim që të hynjë Shqipëtari, çquan nga të tjerëtë, edhe del siprë të gjithëve. Në punërat e në mjeshtërit Shqipëtari s'është mê pak' i zoti se në luftët e në diturit: Punon dhenë pa lodhje, hap vija të thella, munt të bënjë punëra të mbëdha e të vyera. Është hekurpunonjës i çquarë; bën thika, gërshërë, armë etj.; një herë t'a shohë një pushkë të dalë nga fabrikat' e Evropësë e të bërë me maqina të mbaruara, ësht' i zoti atë çast t'a bënjë pa të çquarë me dorë e me vegëlla të meta. Shqipëtari punon edhe mëndafshinë, leshnë, pambuknë, linë; bën pëlhurë, shajak, napë etj. Punon lëkurënë, bën meshin, gëzof etj. Djathi, gjalpëtë, vaji, vera e të tjera gjërëra që bëhenë prej bulmetit të bagëtivet a prej pemëvet të dheut janë nga mê të përdoruratë punëra me të cilatë merrenë Shqipëtarë.

Shqipëtarkatë, aqë të hjeshime sa edhe të nderçime, mê teprë se burrat' e tyre edhe, po thua, aqë trime sa edhe ata, vështojnë vetëm për vetëm punët' e shtëpisë, pa përzjerë burratë. Me gjithë këtë edhe avlëmëndin' e gjergjefnë s'e çkrehinë; bëjnë pëlhura të holla e byrynxyke të mëndafshta fort të bukura, e qëndisinë me ar e me mëndafsh. Përveç të prerët' e të qepurit' e rrobavet, të pleksurit' e çorapevet e të tjera punëra të përdorme të shtëpisë.

Me një fjalë: Shqipëtarëtë janë trima, të mënçime, punëtorë, të zottë për ç'do punë. Me gjithë ndryshimt të besëvet nukë janë të ndar' e të çarë pô të bashkuarë; kanë dashurinë në mest të tyre. Kanë, do-me-thënë, gjith' ato që duhetë të ketë një komp për të vajturë mbarë.

II / Ç'është Shqipëria

Shqipëtarëtë jashtë Shqipërisë


EMBSVAME
E CHRÆSTERÆ
Bæara per tæ Vrtænæ Atæ Ladesímæ
sciochiæriet Iesusit.
E prierræ Letiveiet mbæ gluehæ ts
arberesciæ per Lecæ Matrangiæ
Imiunum i Collegit Greec tæ.
Romæs.
DOTTRINA
CHRISTIANA
Composta dal Reuerendo P. Dottor Ledesma
della Compagnia di Giesù.
Tradotta di lingua Italiana nell'Albanese
per Luca Matranga alunno del Collegio
Greco, in Roma.
In Roma, Presso Guglielmo Facciotto. 1592.
CON LICENZA DE' SVPERIORI.

P08 · Faqja e titullit të katekizmit të Matrëngës, 1592. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Përveç afro dy miliunë Shqipëtarësh që janë në Shqipëri kemi edhe mê teprë se gjymësë miliuni Shqipëtarë jashtë Shqipërisë, n'Itali, në Greqi, në ca anë të Tyrqisë në Malt-të Zi etj. Nga këta, Shqipëtarët' e Greqis' e t'Italisë janë të shumë. Ata që janë në Greqi kan' ikurë nga Shqipëria përpara Tyrqet, në kohët të Byzantinjet; iknë nga Hynërit e nga të tjerë kombe t'egërë, q'u sulë nga anët' e veriut, e mbuluanë edhe Shqipërinë bashkë me vëndet' e tjerë. Mijëra

Shqipëtarësh atëhere lanë mëmëdhen' e tyre nga tëmer' i këtyre, e vanë nëpër nisit të Greqisë, në More, n'Attikë e në të tjerë vënde të Grekërisë. Shumë nga këta vënde i gjetnë të xbrazurë e pa njerës; pô edhe tek kish njerës, me të qënë që këta vanë e ndënjtnë tok, muntnë të ruaninë gjuhën' e tyre, shqipenë, të cilënë flasënë edhe gjer më sot. Idhra, Speca, Porua, Kulluri (Salamina), Egjina e të tjera nisi janë edhe sot të ndënjura fjeshtë prej Shqipëtarësh, edhe ndër tô s'flitetë përveç shqipesë. Mê të shumët' e vëndëset t'Attikësë janë Shqipëtarë: Athina, pa bërë kryeqytet i Greqisë, ish një qytetth fjeshtë shqipëtar, e s'dëgjohesh në të tjatrë gjuhë përveç shqipesë. Thonë që sot për sot një e tret' e vëndëset të Greqisë (veç Thesalisë) janë Shqipëtarë; pô në mos janë një e tretë, për një të katrëtë s'ka dyshim. N'ato kohëra edhe shumë Shqipëtarë u përhapnë nëpër të tjera anë; e kështu nisija Marmara afrë Konstantinopojësë edhe disa pshatëra ng'an' e Adrinupojës' e të Filipopojësë që thuhenë Arnaut-Qoj janë të ndënjturë fjeshtë prej Shqipëtarësh.

Shqipëtarët' e Italisë ndodhenë në Kalabrë e në Siqeli, tek kanë bërë fshatra e katunde edhe kantone (nahijerëra) të tëra më vetëhe, e rojnë veçan Italianëvet, duke ruajturë gjuhën' e besënë (se janë orthodhoksë) e tyre. Këta janë afro 300,000 njerës, fjeshtë Shqipëtarë që flasinë shqip. Këta kanë ikurë nga Shqipëria pas vdekjes' së Skënderbeut, kur ra Shqipëria në duart të Tyrqet. Atëhere iknë shumë Shqipëtarë, pô mê të tepërtitë u përhapnë nëpër Evropë e humpnë duke haruarë gjuhënë e duke përzjerë me vëndëset. Me gjithë këtë, ca fëmijë të mbëdha, sado që humpnë, e ruajtinë emëninë shqipëtar si fëmij' e Albanëvet n'Itali, e cila ka nxjerrë shumë njerës të mbëdhenj që kanë shërbëtuarë

Italinë me diturit të tyre e me mirëbërsirëra të mbëdha. Nga kjo fëmijë ka dal' edhe një papë: Kleman' i Dymbëdhettë.

Nga ky remet Shqipëtarësh q'ikn' atëhere n'Evropë, vetëm ata që vanë në mbretërit të Napolit, së cilësë Skënderbeu i kish ndihurë, vetëm ata muntnë të rrinë tok e të ruajnë gjuhën' e kombërin' e tyre gjer më sot. Gjuha që flasinë është shqip fjeshtë toskërisht pak' e prishurë e e përzjerë me italishte, pô e cila ruan e mban edhe sot shumë fjalë shqipe të vjetëra që na i kemi lën' e haruarë. Në mest të Shqipëtarëvet t'Italisë janë shumë njerës të ditur' e të vyerë, që kanë dëshirë të madhe për kombërin' e për gjuhën' e tyre. Kanë mbledhurë shumë vjersha e këngë të vjetëra, e kanë përhapurë disa livra shqip. Këta kanë shërbëtuarë shumë edhe Italinë, e kanë treguarë shumë trimërí me Garibaldinë.

Kështu Shqipëtarëtë që janë mi dhet, në Shqipëri e jashtë Shqipërisë, bëhenë mê tepërë se dy miliun' e gjymësë.

II / Ç'është Shqipëria

Qysh janë sot Shqipëtarëtë?

Thamë mê siprë që Shqipëtarëtë, duke rënë në duart të Tyrqet, nukë hynë në kurt, si e pandehninë, e nuk' u bënë ropt' e Tyrqet, pô shokët' e tyre, me të cilët bashkë hidheshinë mi kombet' e tjerë, rripnin' e rrëmbeninë, edhe ktheheshinë në vënt të tyre ngarkuarë me gjë. Edhe Shqipëria ish e dlirë e po-thua më vetëhe.

Kaqë qint vjet Shqipëtarëtë rojtnë kështu. Pô kështu rojn' edhe sot? Jo kurrë! Sot Shqipëtarëtë janë robër, të poshtuar' e

t'unjurë, të shkelur' e të çpërnderë shumë mê teprë se të tjerëtë kombe të Tyrqisë! janë mê të poshtërë nga Greqtë, nga Shqehtë, nga Armenëtë edhe nga Judhenjtë!

Tyrqia e ka ngriturë besënë nga Shqipëtarëtë, nuk'i beson e i vështon si anëmikë e si trathtorë, jo si shokë e si vëllezrë, si i vështonte qëmoti. Sot Shqipëtarë e mer ushtar, e mundon e e reh që të mësonjë gjuhën' e ti, kërkon t'i mësonjë diturin' e luftësë, të cilënë ay vetë s'e di, e të cilënë Shqipëtari e ka mësuarë duke thëthiturë qumështit' e s'ëmësë. Nuk' e mëson të gjorinë, pô e mahit e e çpërmënt; e mer për tre vjet, e mban dhetë vjet nën' armë lark shtëpis' e lark mëmëdheut të ti, edhe qysh? lakuriq, t'urëtë, të sëmurë, të varfërë! Në luftë e vë të vritetë kot; urdhëronjës' i ti, q'është Tyrk, i paditur' e i frikçimë, e fut në një trap nga s'deletë. I gjori Shqipëtar, me gjithë këto, lëfton lakuriq e i urëtë e me armë të meta, lëfton si dragua, e tregon trimërin' e ti e nderon Tyrqit' e Tyrqinë! Pô a i dihetë, a çpërblehetë për gjakt që derth? Jo kurrë! Ushtari Shqipëtar, në mos vdektë në luftë, vdes nga smundjeja, nga të pangrënët e nga të pamveshurit. Nga ata që venë n'ushtëri fort të pakë kthehenë në shtëpit të tyre. E urdhëronjës kush bëhetë? gjithënjë Tyrqitë; gjymës' e ushtëris' së Tyrqisë janë Shqipëtarë, pô as një i njëqinttë i urdhëronjëset në Tyrqí s'është Shqipëtar.

Shqipëtarëtë, q'ishinë mësuarë të mos paguajnë gjë, tani janë futurë nën' aqë të rënda pagesa sa s'mundinë të ngrenë krye. Tyrqitë, që janë zotërinjt' e tyre që pesë-qint vjet e tëhu, s'u kanë mësuarë Shqipëtarëvet as punë, as mjeshtëri as dituri, po i kanë mësuarë të lëftojn' e të rrëmbejnë; tani për-një-herë duanë t'u marrënë armëtë, e u thonë paguani! E ku të gjejnë të gjorëtë që të paguajnë? s'kanë të hanë vetë.

Ata Shqipëtarë që pakë kohë mê parë ishin të mveshurë me rroba t'arta e të farkuarë me armë t'ergjënta e të lara, ata a të bit' e tyre janë sot lakuriq me një këmishë që s'ka ku ta zërë qeni! Vete edhe zaptijeja a tahsildari, e ngre shkopn' e i rreh duke thirurë pagoni! e ku të gjenj' i ziu që të paguanjë? Atëhere i shesinë kanë, dhinë, ç'të ketë edhe gjer më qiramidhet të shtëpisë! Shqipëtari të hajë drû për të paguarë!! ô ç'turp i math! ô ç'e madhe e keqe! mos e durofsh ô Perëndi!

Kështu është sot gjithë Toskëria edhe shumë vënde të Gegërisë. Ca vënde të Gegërisë, që kanë mbajturë armëtë e kanë qëndruarë në malet të tyre të rreptë, nukë janë shkelurë kaqë; nuk' apënë ushtarë e s'paguajnë pagesa; pô edhe këta rojnë si t'egërë pa nonjë qeveri, duke vrarë për-ditë në mest të tyre. Edhe këta pô i ha varfërija, se s'kanë nonjë fitim, edhe vëndet' e tyre janë të rjepur' e të varfërë. Me gjithë këto edhe qeveri e Tyrkut ditë me ditë po i rrethon mê s'afëri; rahënë t'u marrinë armëtë, që t'i bëjn' edhe ata robër të poshtërë e të dobëtë, e t'u nxjerrënë edhe lëkurënë!

Shqipëria që gjer dje qeverisësh e urdhërohësh prej Shqipëtarësh, si e thamë mê siprë, sot urdhërohet' e qeverisetë prej Tyrqish të huaj e prej njerës të poshtër' e të panderçim, të cilëtë i blenë vëndetë në Konstantinopojë me të holla, e vinë të rjepinë Shqipërin' e Shqipëtarëtë, për të nxjerë ato të holla që kanë dhënë edhe aqë të tjera që do të vjedhinë për vetëhe të tyre!

Shqipëria, sado q'ësht' e varfër' e e paditurë, ka njerës të zottë për të qeverisurë vëndin' e tyre, si e kanë qeverísurë kaqë kohë me nder e me të drejtë. Pô këtyre Shqipëtarëve le

që s'u epetë punë në Shqipëri, pô as i lenë të shkelinë në mëmëdhet të tyre të dashurë! U apënë nga një copë bukë për të zënë gojënë, e i mbajnë si sklef nëpër mê të largët çipa t'Anadollit e t'Arabistanit! Veç nonjë trathëtor ku të gjendetë ay është për nder!

II / Ç'është Shqipëria

Kombëri e Shqipëtarëvet

Për njerinë në këtë jetë s'ka gjë m'e vjejtur' e m'e dashurë se kombërija. Ç'do njeri, sikuntrë do t'an' e t'ëmënë edhe vëndinë tek ka lindur' e është riturë, ashtu do edhe kombin' e ti. Ay që s'do kombin' e mëmëdhen' e ti është trathëtor e i lik; i tilli s'munt të quhetë njeri. Shqipëtarëtë, mê teprë se ç'do komp, e duanë e e nderojnë kombin' e mëmëdhen' e tyre. Shqipëtar' i vërtetë vritetë për kombërit të ti, edhe s'munt kurrë të duronjë e të dëgjonjë njeri t'i shanjë shqipëtarërinë. N'anërat tona të lindjesë njerëzitë vënë kurdo besënë përpara kombërisë; një Grek, për pasqyrë, me të ndruarë besënë le edhe kombërinë, edhe në u bëftë katholik thotë jam Frënk, në u bëftë mysliman thotë jam Tyrk. Vetëm Shqipëtari e le besënë në radhë të dytë, edhe vë kombërin' e ti përpara. Shqipëtari mysliman qoftë, orthodhoks qoftë, katholik qoftë, është gjithënjë Shqipëtar. Besa nukë sjell kurrë ndarje e çarje në mest të tyre. P'andaj edhe grindatë që ngjajnë në mest të besëvet përherë edhe në atë Evropet të ndrituarë, ato grinda s'dihenë në Shqipëri, e s'kanë ngjarë kurrë në mest të Shqipëtarëvet.

Pô me gjithë këtë dashuri që kanë Shqipëtarëtë për kombërit të tyre e me gjithë këtë nder q'i bëjnë, s'kanë bërë gjësendi për të mbajtur' e për të ruajtur' atë. Me se mbahetë kombëri e një kombi? Mê parë me gjuhët të ti. Sikuntrë thamë edhe mê siprë, gjuha është m'e par' e m'e madhe shënj' e një kombërije. Gjuha me se mbahetë? Me shkronja. Një gjuh' e pashkruarë s'munt të qëndronjë shumë kohë e paprishurë; duke përzjerë me gjuhëra të tjera prishetë. Do të thoni qysh gjuha jonë, pa qën' e shkruarë, ka qëndruarë kaqë mijë vjet edhe pse të mos duronjë edhe paskëtaj ashtu? Pô, ka qëndruarë kaqë mijë vjet, se atëhere Shqipëtarëtë roninë në malet të tyre më vetëhe, pa përzjerë me të tjerë kombe, edhe se kombetë q'i rrethoninë ishinë edhe ata të paditurë. Atëhere ish puna me kordhë, edhe Shqipëtari në kordhët ish m'i fortë nga të tërë. Me gjithë këtë shohëmë që Maqedonasitë, sado q'ishinë aqë të fortë sa muarrë gjithë botënë, me të mos pasurë gjuhën' e tyre të shkruarë, posa q'u përzjenë me kombe të tjerë mê të ndrituarë se ata, e humpnë kombërin' e tyre, e u shuanë fare, aqë sa shumë botë i kanë marrë për Grekër.

Vetëm Shqipëtarët' e Shqipërísë e kanë ruajturë kombërin' e tyre, duke mos përzjerë me të huaj e duke rojturë të ndarë nga gjithë bota e si t'egërë. Pô në e kanë ruajturë gjer më sot kombërin' e gjuhën' e tyre me paditje e pa të shkruarë, a do të mundinë, me këtë mëndyrë t'a ruajn' edhe paskëtaj, ndo në Shqipëri ndo n'Itali e në Greqi? Jo jo kurrë! Bota u ndryshua, njerëzit' u xgjuanë, kombet' u ndrituanë, sicilido përpiqetë të vejë mê parë se të tjerëtë, sicilido vështon qysh të shtohet' e të madhohetë, edhe kujdesetë të përpijë ata që janë mê të vegjël' e mê të dobëtë.

Sot ç'do komp, për të ruajturë kombërin' e gjuhën' e ti, ka nevojë të hapnjë sytë, të ketë mëndjenë të mbledhurë, të shpjerë gjuhën' e ti përpara, e të kujdesetë shumë që të mos t'a han' e t'a copëtojnë kombetë fqinjë. Në kombërit s'ka miqësi, si s'ka në lodrët; cilido vështon të fitonjë vetë, e të hajë shoqnë. Kombetë janë si pishqitë që hanë njëri tjatrinë. Mjerë kush ësht' i dobëtë!

II / Ç'është Shqipëria

Reziket' e Shqipërisë

Shqipëria gjer pakë kohë mê parë ka qën' e rethuarë me vënde të Tyrqisë, edhe kufit' e kësaj mbretërije ishinë fort lark Shqipërisë. Shqipëtarëtë vininë bashkë me Tyrqitë për të ruajturë kufit' e larga të mbretërisë; pô mëmëdhen' e tyre e shihninë jashtë ç'do reziku, e e dininë që nonjë anëmik s'muntte t'i qasësh Shqipërisë. Por sot nuk' ësht' ashtu; sot Shqipëria ka mbeturë në një çip të largë e të veçantë të Tyrqisë, e është e rethuara me kufi anëmiqsh. Mal'-i-Zi, Serbía, Greqia e Bulgaria e kanë pshjell' e përqarkuarë Shqipërinë, edhe Austria i ka ardhurë mi krye. Me Tyrqinë e lith një rrip dheu i hollë në mest të Bulgaris' e të detit Egje, që këtë rrip Bulgarëtë mundinë me të parët ta marrin' e t'unjënë mb'anë detit, edhe ta presin' e ta çkëpujnë Shqipërinë nga Tyrqia, e cila s'ka as nonjë fuqi në dett, që t'i ndihnj' andej Shqipërisë. Prandaj në një luftë, në të cilët të marrin' anë edhe Bullgarëtë, Shqipëtarëtë duhetë të jenë të zottë të ruajnë vete me vetëhe vëndin' e tyre, e të mos varenë me Tyrqinë, e cila s'ësht' e zonja për vetëhe të saj.

Pô veç këtyre rezikeve që do të dukenë në kohët të luftësë, Shqipëria ka rezike mê të mbëdhenj e mê të thellë, të cilëtë po i nxjerinë rënjëtë në kohët të paqit, pa gjak e pa armë. Kjo është luft' e pëndës' e e shkollësë, luft' e kombërisë. Kombetë q'e kanë rethuarë Shqipërinë duanë ta copëtojn' e ta ndajnë në mest të tyre. Greqtë, Shqehtë e të tjerë kombe fqinjë s'duanë të njohinë qënien' e kombërisë Shqipëtare. Si-cili-do përdor besën' e ti, e do të heqë m'anët të ti ata Shqipëtarë që kanë një besë me të. M'i pari Tyrku do të heqë Shqipëtarëtë myslimanë, e t'i ndanjë nga vëllezërit' e tyre Shqipëtarët' e krishtenë, duke futurë në mest të tyre fanatismen' e grindenë. Për të ndarë të krishtenëtë për jetë nga myslimanëtë, e për të hapurë në mest të tyre një trap të thellë, qeveri e Tyrkut Shqipëtarët' e krishtenë s'i njeh për Shqipëtarë, pô i quan Rum do-me-thënë Greq, Bulgarë, Sërbër, Llatinë etj. edhe myslimanëtë i quan islam; edhe emëninë Shqipëtar s'e njeh, e s'do ta dëgjonjë. Të verbëritë Tyrq! nukë e kupëtojnë dot, e s'ja u pret mëndja që me këtë udhë shërbejnë qëllimet' e armikëvet të tyre e nxjerinë themelet' e rënjët' e tyre!

Greqtë, të cilëtë dlirin' e tyre edhe mbretërinë që kanë sot e kanë fituarë me gjakt të Shqipëtarëvet, të Boçarit, të Xavellësë, të Mjaulit e të tjerëve trimave Shqipëtarë, ata Grekër që edhe sot ruajnë rrobatë, fustanetë, kallcetë, opingatë, valletë e këngët' e Shqipëtarëvet, ata janë mê të keqt' e armikëvet të Shqipërisë. Gjithë bota e dinë idhen' i madhe të Greqet. Duk me qënë që në kohët të Perikliut, ahere q'ishinë mê të mbëdhenj e mê të ndrituarë se kur-do, kishinë më pakë vënt se ç'kanë sot, edhe që s'kanë nonjë të drejtë të duanë mê teprë, këta kërkojnë t'u epenë sa vënde kish marrë

Aleksandr' i Math, a të ngjallinë mbretërin' e Byzantinjet, pa menduarë q'Aleksandri ish maqedonas edhe Byzantinjtë romanes, kombe që të dy armiq të Grekëvet e të cilëtë e kanë humburë Greqinë. Pas kësaj idhes' së madhe Grekëretë kanë dashurë të pushtojnë e të futinë nënë Greqit gjithë sinisin' e Balkanit, edhe Rumaninë edhe Bulgarinë. Pô si i humpnë për jetë këta vënde me gjithë të thirrurat' e të çjerat e tyre, tani e kanë ngushtuarë shpresën' e tyre në Shqipëri e në Maqedhoni. Pas zakonit të përgjithëshmë, duke pshteturë në besët duanë të heqinë m'anë të tyre Shqipëtarëtë orthodhoksë, e t'i ndajnë nga vëllezrit e tyre mysliman' e katolikë; përpiqenë t'i bëjnë këta të harojnë gjuhën' e tyre të bukurënë, e të mësohenë të flasin' e të shkruajn' e të ligjërojnë greqisht, e me këtë udhë të bëhenë Grekër. Mendohenë se pô të bëhenë të krishterëtë Grekër, myslimanëtë Evropa s'i ka për të vënë në vatrë, edhe pô të vinjë koha ay vënt, do-me-thënë gjithë Shqipëri e jugësë e gjithë Toskëria, do t'i epetë Greqisë.

P'andaj Grekëritë, më nj'anë nga Athina me shkolla, me mësonjës, me livra, me shëronjës e me shumë gjërëra të tjera edhe me të holla të tepra të paguara prapë prej Shqipëtarësh të çmëndurë e trathëtorë grekomanë, edhe më nj'anë tjatërë nga Konstantinopoja me anët të patrikërisë, të dhespotëvet, të priftëret e të kishësë, duke përdorurë aforismonë e të dëbuarët nga kisha, sikur t'ish edhe Krishti Grek, edhe sikur për të qënë i krishten' e orthodhoks, duhetë pa ndryshim të jetë gjithë-kush Grek a grekoman; nga të dy këto anë, themi, Grekëritë pô përpiqenë që të kthejnë ditë me ditë Shqipëtarëtë orthodhoksë, e t'i bëjnë Grekër.

E Shqipëtarëtë orthodhoksë, nga padija e nga erëcira në të cilët gjendenë, gënjehenë çprejt, u duketë sikur vërtet s'munt të jenë të krishtenë pa qënë Grekër, pandehinë se vetëm greqishtja është gjuh' e orthodhoksisë, edhe që me të lënë këtë gjuhë, të cilënë e dinë fort pakë, edhe s'e mësojnë dot me gjithë që çajnë kokënë me qënë q'është aq' e rëndë e aq' e humbur' e e haruarë, sa edhe nga ata Grekëret vetë fort të pakë njerës mundinë ta mësojnë. Këta Shqipëtarë trathëtorë pa diturë, quhenë grekomanë.

Lëvdatë i qoftë Perëndisë! që kur ka zënë të shkruhetë shqipja grekomanëtë kanë zënë të pakësohenë ditë me ditë, të marrënë vesh dhelpërit' e Grekërvet e të hiqenë nga ata duke zënë me të dy duart kombërin' e gjuhën' e tyre. Këta s'kanë frikë as nga mësonjës i Grekut, as nga dhespot' i Fanarit; pô Grekëretë kanë një shok të fortë, me të cilënë janë zënë shëndoshë dorë-për-dorë për të humburë kombërin' e gjuhën' e Shqipëtarëvet; ay shok është Tyrku, i cili i ndih Greqisë e patrikëris' së Fenerit në këtë punë me sa i vjen nga dora. Për të bërë punën' e Grekut qeveri e Tyrqisë nukë le të hapetë nonjë shkollë, të shkeletë nonjë livrë a të bëhetë nonjë mësim e nonjë mbrodhëri në gjuhët shqip, duke ndihurë shkollavet greqisht me ç'do farë mëndyre, e duke mbajturë Shqipëtarët' e krishtenë nënë xgjedhë të priftëris' së Fenerit.

Pas Tyrqet e Grekërvet Shqipëria ka armikër Bulgarët' e Sërbëtë, të cilëtë duanë të bëjnë nëpër anët të lindjes' e të veriut të Shqipërisë ato që bëjnë Grekëritë n'anët të jugësë. Edhe nëpër ato anë shumë Shqipëtarë orthodhoksë, aqë të paditur' e të pakupëtuarë sa të tjerëtë tregojnë një dëshira për gjuhet' e Shqehet, e duanë të harojnë gjuhën' e bukurë që

kanë folurë prindëret' e tyre që kaqë mijë vjet e tëhu. Ç'i math turp! e ç'e madhe poshtëri e unjtëri e fëlliqurë! Pô edhe këtyre Shqehe u ndihinë Tyrqitë, të cilëtë atyre u lenë duartë çpenguarë të bëjnë ç'të duanë e neve na i lidhinë skrupullë; atyre u apënë fermanë të hapinë shkolla e mitropolitirëra ndër vëndet tanë, e neve s'na lenë të kemi as një shkollë të vogëlë! Pa menduarë një herë se Grekëretë e Shqehtë janë miqt' e Tyrqisë a po Shqipëtarëtë, edhe cilëtë kanë derdhurë edhe derdhinë edhe sot gjak për të?

Kështu Tyrqitë edhe me ndihmit të këtyre Grekretë e Shqehtë janë armikët' e Shqipëris' e të Shqipëtarëvet; edhe përpiqenë me sa u vjen nga dora ta humbasinë kombërin' e gjuhën' e këti kombi, të cilit edhe emëninë duanë t'ja ngrenë farë. Greqia, Bulgaria e Sërbia përpiqenë ta humbasin' e ta ngrenë kombërinë shqipëtare e gjuhënë shqip cilado nga ajo cop' e Shqipërisë q'i ka rënë më pjesët të saj edhe q'e vështon që tani të sajnë, duke kthyerë të krishtenëtë në kombërit të tyre; edhe Tyrqia më nj'anë u ndih këtyre në këtë punë, e më nj'anë tjatrë kërkon të heqë Shqipëtarëtë myslimanë e t'i ndanjë nga vëllezërit' e tyre, jo për të mirët të saj, pô për të hequr' edhe ata e për të vithisurë bashkë në trap të thellë të humbjesë tek po bjenë, për të mos dalë kurrë.

Këta janë reziket' e Shqipëris' e të Shqipëtarëvet. Shqipëtarëtë duhetë të ruhenë shumë nga djallëzit' e Tyrqet, të Grekëret e të Shqehet, e t'u rinë kundreq këtyre me të drejtet të tyre.

II / Çʼështë Shqipëria

Miqtʼ e Shqipëtarëvet

Sado që Shqipëtarëtë janë rethuarë me armikë, edhe Tyrqitʼ e Greqtë që kanë nevojë të madhe të jenë miq e të bashkuarë me Shqipëtarëtë, këta të dy kombe të çmëndurë punojnë mê shumë nga të gjithë për të humburë kombinë Shqipëtar, me gjithë këto sʼmunt edhe sʼduhetë të themi se gjithë bota janʼ armikëtʼ e Shqipëtarëvet. Jo, kemi edhe miq, janʼ edhe shumë që na duanë edhe munt të na ndihinë po të duamë vetë. Gjithë kombetʼ e Evropësë, Francezëtë, Italjanëtë, Alemanëtë, Ingjilizëtë e të tjerë, gjithë e duanë e e nderojnë kombinë tënë; gjithë çudítenë me trimërit të Shqipëtarëvet, me besët të tyre e me të tjera kaqë të mira qʼi njohinë kombit tënë. Gjithë shkronjësitʼ e Evropësë kanë shkruarë kur-do mirë për na; na dinë trima e burra të besësë, na njohinë si mê të vjetërinë komp tʼEvropësë e mê të fisçiminë. Gjuhënë tënë zunë ta mësojnë duke dhënʼ asaj një rëndësi të madhe në letrërit të përgjithçime. Franca që së vjetëri do të tregonjë një dashuri të çquarë për Shqipëtarëtë edhe mê teprë për katolikëtʼ e për Mirëditasitë. Italia ka treqint mijë Shqipëtarë në vëndit të saj, të cilëtë janë përpjekurë mê shumë se Italjanëtë vetë për bashkimt tʼItalisë, edhe për të bërë zëmrënë këtyre do të mirënʼ e Shqipërisë, të cilënʼ e ka edhe fqinjë, e sʼdo ta shohë që ta copëtojnë Greqtʼ e Shqehtë. Austria nukë munt të dojë që Shqehtʼ e Sërbisʼ e të Bulgarisë të futenë gjer në mest të Shqipërisë e të hapenʼ e të ritenë aqë teprë; një komp trim si Shqipëtarëtë do ta ketë mik e ndihmës në Sinisit të Balkanit kuntrë Shqehet që janë të shumë, si kuntrë që mban edhe Rumanëtë. Ingjiltera që do të

mirën' e dlirin' e gjithë kombevet s'munt të mos dojë Shqipëtarëtë. Edhe Rusia, q'është vetë Shqah edhe mburonjëse e gjithë Shqehet, edhe ajo nuk' e kurcen fjalën' e mirë e ndihmënë për Shqipëtarëtë, sikuntrë s'e ka kurcyerë kurrë edhe për Grekëret, me gjithë që këta s'e duanë edhe janë armikët' e Shqahërisë.

Kështu gjithë mbretëritʼ e mbëdha na duanʼ e na nderojnë, edhe miqtʼ i kemi të shumë; pô nonjë nga këta nukë na ështʼ aqë mík, sa ta marrë punënë tënë në dorë, e të përvishetë për këtë punë vetíu. Veç kësaj duk me na parë të ndarë me tri besë e mê të shumëtë myslimanë, nukë jʼa u pret mëndja që të mujmë na të bëjmë një komp të njëjtetë e të bashkuarë, i cili të jetʼ i zoti të qeverísetë me vetëhe. Pô kur të na shohënë në punë e ta kupëtojnë që qënkemí të zottë për këtë punë, atëhere, s'ka dyshim, që do të na ndihinë të gjíthë në të drejtet tënë.

Nga kombet fqinjë vetëm një kemi mik, i cíli kupëton të mirën' e ti, e e di që pa na s'munt të mbahetë. Ky komp është komb' i Vllehet që rojnë në Shqipëri e afrë Shqipërisë. Nga këta ca janë Vlleh-Shqipëtarë, që flasinë vllahisht edhe shqip, edhe ca Vlleh-Greq, që flasinë vllahisht edhe greqisht. Grekëritë kanë bërë edhe po bëjnë gjithë për këta Vlleh ato që kanë bërë e që po bëjnë për na Shqipëtarëtë; do-me-thënë përpiqenë tʼi bëjnë Greq me shkollat e me kishët të tyre. Vllehtë gjer tani afrë ishinë gënjyer' edhe ata si Shqipëtarëtë orthodhoksë, e doninë të quhenë Greq, e të harojnë gjuhën' e tyre duke mësuarë greqisht; pô më në funt e muarre vesh edhe këta se sa e vjejturë është gjuha e kombëria për ç'do njeri, edhe zunë të mësojnë gjuhën' e tyre, e të hapinë shkolla me vetëhe.

Në këtë punë Vllehtë s'munt të kenë tjatrë ndihmës e mik në vëndit përveç Shqipëtarëve. Duke prishurë me Greqt, të cilëtë s'nginjenë t'i pjekin' e t'i hanë ata Vlleh që duanë gjuhën' e tyre, si edhe Shqipëtarëtë, kishinë nevojë të bashkohenë me Shqipëtarëtë, me ata që janë Shqipëtarë të vërtetë e duanë gjuhën' e kombërin' e tyre. Edhe Rumania, q'është mëm' e këtyre Vllehe a der' e t'et të tyre, ta themi për shëmbëllë, e di mirë që Vlleht' e Shqipëris' e të Maqedhonisë s'mundinë të rojnë e të ruajnë gjuhën' e kombërin' e tyre kuntrë djallëzive të Grekëret përveç duke pshteturë në miqësit të Shqipëtarëvet e duke bashkuarë me ta. P'andaj Rumania është treguarë më teprë se gjithë mike për Shqipërinë, e ka dashurë edhe do të ndarët' e Shqipëtarëvet nga Grekëretë; edhe në Rumani është bërë e para shoqëri, e atje është hapurë e para shtypëtore e janë shkelurë të paratë livra shqip. Këtë të mirë Shqipëria nukë do t'ja haronjë Rumanisë, edhe do t'ja çpërblenjë duke dashurë e duke mbajturë mirë Vlleht' e Shqipërisë.

Pô njeriu po të jet' i lik e i dobëtë, gjith' i hipinë siprë, jo vetëm anëmiqtë pô edhe miqtë; për të mbajturë nder' e ti, duhetë të tregohet' i zoti kuntrë armiqet edhe kuntrë miqet. Kështu edhe na, sado që Vllehtë na duanë, edhe kanë nevojë për miqësit tënë, me gjithë këtë, duanë të jenë mê të lartë e mê të ndjerë se na duk me qënë aqë mê të pakë edhe t'ardhur' e të huaj në Shqipëri. Janë ca Vlleh që duanë të tregojnë n'Evropë që Vllehtë janë mëndja e Shqipëtarëtë trupi, që Shqipëtarëtë duhetë të lëftojn' e të vritenë e Vllehtë të qeverisinë e të gjykojnë. Këta nukë ndruhenë të thonë, që Shqipëtarëtë s'kanë nevojë për shkronja e për shkolla, se kanë shkronjat' edhe shkollat' e Vllehet. Këtë dorë-hapuri na

i bëjn' edhe Grekëret' e Tyrqitë, të gjithë, na duanë aqë sa të n'apënë gjuhën' e shkronjat' e tyre, edhe të gjithë na presinë në shkollat të tyre me krahë hapurë!

P'andaj edhe Vllehet nukë duhetë t'u besojmë aqë teprë, me gjithë që duamë ta besojmë që ky mendim s'ësht' i të gjithë Vllehet as i mê të urtëvet. Si do që të jetë puna, na, duhetë të mendojmë mirë punënë tënë e të përpiqemi vetë për punët të vet, se në këtë jetë si-cili-do përpiqetë për vetëhe. Armiku do të të marrë lëkurënë, edhe miku robënë.

II / Ç'është Shqipëria

Të shkruarit' e gjuhësë shqip

Thamë edhe mê siprë që m'e par' e shënjavet të një kombi edhe ajo q'e bën të nëmërohetë një komp mê vetëhe është gjuha. Një gjuhë që s'shkruhet' e s'këndohetë nukë ziretë gjuhë, si Provansalëtë në Francë, Katalonasitë në Spanjë, Galëtë n'Ingjilterë e të tjerë kaqë kombe që flasinë nga një gjuhë më vetëhe, pô nukë shkruajnë gjuhën' e tyre, edhe bota i njeh për Francezë, Spanjolë, Ingjiliz' e të tjerë pas gjuhësë që shkruajn' e këndojnë.

P'andaj e par' e punëvet që duhetë të ketë kujdes një komp, që do të ruanjë kombërin' e ti, është të shkruarët' e gjuhës' së ti, edhe p'andaj ata që duanë ta humbasin' e ta rofitin' atë komp, vënë këmbë t'i ndalojnë nga të shkruarët gjuhën' e tyre.

Kemi thënë qysh Shqipëtarëtë s'janë kujdesurë që krejt për të shkruarë gjuhën' e tyre, qysh gjuha shqip ka mbeturë e

pashkruarë gjer në kohët tënë, edhe qysh është ruajturë gjuha jonë nga të rojturit' e prindëvet t'anë veçan e pa përzjerë me të tjerë kombe. Pô s'është vetëm kombi ynë që s'ka pasurë shkruarë gjuhën' e ti; edhe shumë kombe të tjerë t'Evropës' e t'Asisë kanë zënë të shkruajnë gjuhën' e tyre në këtë shekull të pastajmë. Në është ruajturë shqipja kaqë mijë vjet pa shkronja, pas këtaj s'munt të ruhet' edhe shumë kohë, me të qënë që kohëtë undruanë, nonjë komp s'munt të ronjë i ndarë e veçan, fqinjëtë u xgjuanë, e po venë mbarë, edhe përpiqenë të na rofitinë. E para pun' e këtyre është të na bëjnë të harojmë gjuhënë tënë, e të mësojmë të tyrenë. Jo vetëm Shqipëtarët' e Greqis' e t'Italisë pô edhe shumë nga të Shqipërisë zunë të mos flasinë e të mos dinë shqip, tek prindërit' e tyre s'dininë tjatrë gjuhë. Pô të lihesh kështu e pashkruarë, shqipja q'është ruajturë që kaqë mijë vjet e tëhu do të humbiste e të harohesh në pakë kohë.

Duke parë këtë rezik të math, të keq e të tëmeruarë, ca Shqipëtarë me zëmrë plot dashurije për kombërit të tyre, nxuarë në shesht dëshirënë që ka pasurë të pshehurë në zëmrë ç'do Shqipëtar i ndrituarë për të shkruarët të gjuhës' së bukurë sanë. Janë një-zet vjet, në kohët të lidhjes' së Pizrenit, u bënë shkronjatë shqip të plota e të mbaruara, me të pasurë ç'do shkronjë vetëm një zë edhe për ç'do zë një shkronjë më vetëhe. Me të parë Shqipëtarëtë gjuhën' e bukurë të tyre të shkruar' aqë mirë, i zunë shkronjatë me të dy duartë; edhe shoqërirëra u ngrehnë në Rumani e n'Egjyptë pas asaj së Konstantinopojësë, e cila s'mundi të qëndronte shumë kohë nënë xgjedhët të Tyrqet. Një shkollë u hap në Korçë, e për së pare here zuri të mësohesh gjuha jonë. Shkollatë nuk' u shtuanë e të vininë mbarë si duheshe, pô

shkronjatë shqip u përhapnë nëpër gjith' anët të Shqipërisë, edhe burra e gra, djem e vasha, gjithë mësuanë, në pakë kohë, të shkruajn' e të këndojnë gjuhënë shqip. Më një zet vjet shkronjatë shqip lëshuan' aqë rënjë të shëndosha, e zun' aqë themele të fortë, sa s'munt të çkulet' e të rëzonetë kurrë. Ky drû, q'u vu një-zet vjét mê parë, u lulëzua, edhe dha pemë fort t'ëmbla e të bukura.

Mbrodhëri e shkronjavet shqip është vdekje për armikët' e kombërisë sanë. Mê parë gjithë thoshinë që kjo punë s'bëhetë, shqipja s'është një gjuhë që të muntnjë të shkruhetë, është një gjuh' e lig' e e prishurë, s'munt të ketë shkronjëtore, nonjë dituri s'munt të shkruhet' e të mësohetë në këtë gjuhë, e kaqë të tjera fjalë të kota, për të bërë na ta presimë shpresënë, e të mos përpiqemi për të shkruarë gjuhënë tënë. Pô kur panë që shqipja u shkruaka fort mirë, u kënduaka shumë bukurë, u bëka shkronjëtor' e saj, edhe qënka m'e mir' e m'e mbaruarë se gjithë gjuhët' e dheut, u mësuakanë me të gjithë dituritë; kur e kupëtuanë, që sa të mësonjë Greku gjuhën' e Omirit, t'Evripidhit, të Platonit e të tjera gjuhëra të humbura, sa të këndonjë Tyrku gjuhën' e gjer' e të gjatë t'Arabëvet e të Persanëvet, pa mundurë t'i mësonjë, sa të merrenë këta me këto gjuhë, Shqipëtari e ka mësuarë gjuhën' e ti ta shkruanj' e ta këndonjë drejt në ca dit, edhe ka mësuar' edhe shumë mësime të nevojçime.

Kur panë këto të mira në gjuhët shqip e mbródhësin' e madhe të shkronjavet tona, e kupëtuanë që Shqipëria do t'u dalë nga thonjtë, edhe u bashkuanë gjithë për të ndaluarë të shkruarët' e gjuhësë shqipe. Tyrq, Grekër, Shqeh e të tjerë, sado q'armikë në mest të tyre, dhanë dorënë njëri jatërit kuntrë neve. Port' e Lartë e plas' e Yllit, patrikëri e Fenerit,

qeveri e Athinësë etj. u bashkuanë në këtë punë; Tyrku ndaloj të hapuritë shkolla shqip, zuri livratë në tellonë, nukë la të shkelesh as një copë kartë në gjuhët tënë, edhe i vështoj me sy armiku duke quajturë komítë, pas zakonit të ti, gjith' ata që doninë të shkruajn' e të këndojnë në këtë gjuhë: Grequ thiri, e çori lëveretë që nga Athina kuntrë të shkruarit të gjuhësë sanë, ngrehu një-mij' intrikëra kuntrë Shqipëtarëve që duanë gjuhën' e tyre, i vrau të shumëtë me dorët të Tyrkut; patriku e dhespôtëtë hodhë aforismatë si Hyji rrufenë qëmoti.

Gjithë këta ndalime bënë të mos shtohen' e të mos përhapenë shkollatë shqip në Shqipëri e të mos dalënë livra e ditare etj. në gjuhët tënë; pô nukë ndaluanë dot Shqipëtarëtë nga të mësuarëtë shkronjatë shqip. Shqipëtari është mësuarë të nxërë shkronja edhe pa shkollë, në shesht' edhe pa livra e të shkruara me dorë.

Shqipja sot nuk' është një gjuhë e pashkruarë si qe një-zet vjet mê parë; sot është një gjuhë që shkruhet' e këndohetë, edhe nga mê të bukuratë. Nonjë gjuhë s'këndohetë aqë lehtë e aqë mirë sa shqipja. Kjo i hidhëroj e i helmoj fare armikëtë tanë, se duk me parë që ka lëshuarë aqë rënjë të gjata e të forta të shkruarit e gjuhësë Shqipe nuk mundinë mê sot të thonë që Shqipja nuk munt të shkruhetë; se ja tek u shkrua.

II / Ç'është Shqipëria

Varfëríá e Shqipëtarëvet e pakryesí e Shqipërisë

Shqipëria gjer ca kohë mê parë ka qënë mjaft e pasur' e e begatë. Shqipëtarëtë roninë me rogat' e ushtërisë e me rrembimet të luftësë, si edhe me disa mjeshtëri që kishinë. Mvishnin' e mbathninë robën' e plaçkën' e tyre që bëhesh në vënt. Pagesat' e qeverisë ishinë fort të paka e të lehta. Nga të hollatë që sillninë së jashtësmi në Shqipëri fort të paka delninë jashtë, të shumatë mbeteshinë në vëndit. Kjo sillte një begati të përgjithçme.

Sot s'është puna kështu; Shqipëtarëtë mê nukë venë ushtarë me rogë, pô futenë nënë një xgjedhë ushtërije; nukë kthehenë nga lufta të mveshurë n'ar e të farkuarë me armë të lara, pô lakuriq, të smurrë e të këputurë. Nonjë gjë s'bëhetë dot në vëndit, se punëtorëtë vëndës s'ja dalinë dot kuntrë fabrikavet t'Evropësë. Edhe ato dy pare q'u bjenë në dorë Shqipëtarëvet rjedhinë nga duart e tyre e rungullisenë n'Evropë. Pagesat' e qeverisë janë të shuma e të rënda, sa me-zi i paguajnë. Fitimet' e vjetërë u ngrinë, të tjerë të rinj s'erdhë në vëndit t'atyre. Për udhëra paguajnë veçan, udhë s'ka; lumënjtë mbytinë fushatë, ethetë që çpikenë nga këto baltëra bëjnë botënë të jenë gjithënjë të sëmur' e të dobëtë, të mos punojnë dot e të vdesinë nga sëmundja e nga urija. Kështu një varfëri e madhe e e keqe e ka mbuluarë gjithë Shqipërinë.

Qeveri e Tyrqet në Shqipëri është vetëm për të mbledhurë pagesat' e ushtarëtë: eja ti djalë Shqipëtar që shkele më të

një-zettënë vit, të veç n'anët të dheut të mbyllesh në një keshlla lakuriq e urëtë! eja ti Shqipëtar i varfërë, të paguanç pesë grosh për një dhi, nga e cila s'nxjer dot as gjymësën' e këtyre pareve në mot! Kjo është pun' e qeverindarit tyrk; pô qeveri s'ka; pa dalë mirë zaptijeja nga kolumb' e pshatarit të cilit i mori djalin' a gjënë, i hyn kusari ta vjedhë a armiku ta vrasë, edhe ay qeverindar, që qe i zoti ta rjepë, s'ësht' i zoti ta ruanjë nga kusari a ta mburonjë nga armiku! I gjori Shqipëtar ësht' i shtrënguarë të rrijë dit' e natë me armë në dorë që të munjë të ruanjë gjën' e shpirtin' e ti; pô në i lënçin' edhe armë, se shumë herë armëtë ja mer, e le duar-lidhurë përpara hajdutëvet e armikëvet, nga të cilëtë nuk' ësht' i zoti ta ruanjë. Pa le që shumë herë qeverindari bashkohetë me hajdutnë për të rjepurë Shqipëtar' e nderçure.

A munt të quhetë qeveri një qeveri e këtillë? Nuk kurrë. Shqipëria gjendetë nënë një paqeveri të keqe. S'ka nonjë qeveri. Shqipëtarëtë hajen' e vritenë në mest të tyre për ditë; gjaku i Shqipëtarit derdhetë kot e pa punë, ay gjak i vjejturë që do të mos derdhesh as një pikë përveç për ruajtjet e për shpëtimt të Shqipërisë!

Varfërija, paqeveririja, paditurija sjellinë grindenë, ndarjenë mos-dashurinë. Shqipëtarëtë, të varfërë, të paditurë, të ndarë, armikë njëri me jatrinë, po vritenë në mest të tyre, po derdhinë gjakn' e tyre kot e sa venë po humbasinë! Kanë rënë më një gjumë të thellë e të rëndë. Fqinjët' e tyre ditë me ditë po xgjuhenë, po ndritohenë, po shtohenë e po hedhinë gjurma të mbëdha brënda në Shqipëri, të cilënë janë gati ta copëtojnë fare!

Kështu është sot Shqipërija!

III Ç'do të bëhetë Shqipëria?

A munt të qëndronjë Shqipëria si është?

Shqipëria është një cop' e Tyrqis' s'Evropësë; qëndrim' i saj si është sot është lidhurë me rojtjet të Tyrqisë n'Evropë; Tyrqia a do të ronjë edhe shumë kohë n'Evropë? Kësaj pyetjeje njeri s'i përgjigjetë dot e, përgjegj' e kësaj është jo. Tyrqia rojti shumë n'Evropë; pas kuvëndit të Berlinit dhjetë vjet besohesh të ronte; shkuanë njëzet, do-me-thënë rojti shumë. Kjo, mbretëri s'ka bërë edhe s'bën gjë fare që të xgjatnjë rojtjen' e saj. Si një i smurrë që s'bën ç'i thonë shronjësitë e i vë krusmënë trupit të ti, ashtu edhe kjo mbretëri po bën gjithë ç'duhetë për të shkurtuarë ditët' e saj. Nuk' e dimë edhe sa kohë munt të ronjë n'Asi, edhe është jashtë qëllimit tënë të flasimë për atë; pô n'Evropë jetën' e ka fort të shkurtërë. Shqipëria s'ka bërë themel as ka lëshuarë rënjë më vetëhe; ron mi themelt të gremizurë të Tyrqisë e me rënjët të kalbura t'asaj. Me të rënët të kësaj stihije së madhe, do të bjer' edhe Shqipëria e do të shtypetë nënë gërmadhat të rënda t'asaj.

Kombet' e tjerë të Tyrqis' s'Evropësë kanë zën' e po bëhenë gati që kurthi, që të mundinë të qëndrojnë më vetëhe të tyre, e të mos shtypenë nënë gërmadhat të Tyrqisë. Këta kombe ngjajnë m'ato barëra q'ushqehenë e shëndoshenë nënë dëborët të dimërit, edhe kur hiqetë kjo bar' e ftoht' e e rëndë nga faq' e dheut, ato zën' e luluzojnë e xbukurohenë në çast. Pô Shqipëtarëtë që kaqë qint vjet e tëhu janë varurë mê Tyrqit, sado q'e shohënë që kjo stihi e madhe q'e thonë Tyrqi,

ësht' e shëmburë, e ditë me ditë po i bjenë strehëtë, prapë s'heqinë dorë nga të psheturit nënë të. Kjo dëbor' e kaqë qintsh vjet, që ka ushqyerë nënë të kombet e tjerë, Shqipërisë i ka djegurë rënjëtë me të ftohëtit të saj; Shqipëria ka ngrir' e është tharë në këtë dimërë të gjatë të tiranis' së zezë, me gjithë që s'është shkelurë aqë sa vëndet' e tjerë.

Pun' e Maqedonisë u vu përmi cohët të gjelbërë të diplomatisë, a kështu a ashtu do të marrë një funt; Rumelia nukë do të mbesë si është; Tyrket do t'u pritenë pakë thonjtë, e do të mos rjepinë mê kombet' e këtyre vëndeve: thirjet' e kombevet do të dëgjohenë, e të drejtat e tyre do t'u epenë. Atëhere Shqipëtarëtë a do ta nxjerinë zënë, a do të kërkojn' edhe ata të drejtat' e tyre? Apo do të përpiqenë gjer n'orët të fundit për të mbajturë tiranin' e Tyrqet mi kryet të tyre e të tjerëvet kombe? Këtu është puna.

Sa âfrohetë koh' e të ngriturit të tiranis' së zezë të Tyrqet, aqë çeletë çpres' e shpëtimit të kombevet që rënkojnë nënë të. Pamë mê siprë që Shqipëtarëtë me kohë kanë qënë shokët' e Tyrqet e jo robërit' e tyre; pô sot ata heqinë mê të madhenë tirani, ata janë shkelurë e shtypurë mê keq se gjithë. Kur është kështu pse gjithë kombetë përpiqenë ta hedhinë së sipërmi këtë hije të rëndë, e Shqipëtarëtë duanë ta mbajnë? Apo nukë shohënë që po i vënë krahëtë një muri që po gremizetë e do t'i shtypnjë duke rënë mi ta? Shqipëtarëtë janë si një njeri që ka rënë në dett e di të bënjë not mirë, pô duanë duke shpëtuarë të shpëtojnë edhe Tyrqitë, të cilëtë kanë rën' edhe ata në dett edhe s'dinë not; pô këta të mallëkuarë nukë len' atë që di not t'i zër nga duhetë e t'i nxjerë jashtë ujit, pô i zën' ati të dy këmbëtë a një këmb' e një dor' edhe s'e lenë të bënjë not. Kështu edhe vetë komb' i tyre

po mbytetë edhe kombinë shqipëtar po e heq me vetëhe mu në funt të detit e po e mbyt. Shqipëtari që po e sheh këtë rezik me sy pse e le vetëhenë në duart të këti të ligu e të pamëndi që s'munt të shpëtonjë vetëhenë edhe as le ta shpëtojnë, po kërkon të mbytnjë me tradhëti edhe ata që duanë ta shpëtojnë. Ç'duhetë të bënjë një njeri që bije në një rezik të këtillë? - T'i apë një shkelmë të shëndoshë këti tradhëtori që kërkon ta mbytnjë, ta dërgonjë në funt të detit edhe të shpëtonjë vetëhen' e ti. Kjo ësht udh' e shpëtimit, e jo tjatërë.

Tyrqia as munt të ronjë paskëtaj, as di, as do të ronjë, edhe as duhetë të ronjë. Shqipëtarëtë po që të duanë të mos ndahenë nga Tyrqia, duhetë të humbasinë bashkë me të. Ky është një njeri i vdekurë, sado ta duamë të vdekurinë, duhetë ta vëmë në dhet: të duamë të mos ndahemi soje është si të duamë të hyjmë në varrt me të bashkë. Ay qelbetë, u qelp, s'e mbajmë dot mê, se kundërmon botënë.

P'andaj themi prapë që Shqipëria, si ka rojturë gjer më sot, paskëtaj s'ron dot as pakë. Le që Tyrqia ësht' e vdekurë, edhe s'munt të ronjë me të; pô edhe sikur të ngjallesh kjo mbretëri, e të ronte edhe ca kohë, Shqipëria prapë do të mos muntte të ronte, se ngjallj' e Tyrqisë është vdekj' e Shqipërisë. Pamë mê siprë qysh Tyrqitë u lidhinë duart' e këmbëtë Shqipëtarëvet, edhe i mbajnë t'i hanë e t'i përçajnë të tjerëtë, Greqtë, Shqehtë etj. Shqipëria gjer më sot e ka mbajturë kombërin' e gjuhën' e saj, pô paskëtaj s'e mban dot, po s'bëri edhe ajo shkolla e të vejë mbarë në diturit; po qeveri e Tyrkut Shqipëtarë s'e le të hapnjë shkolla e të shpjerë përpara gjuhën' e ti, kur të tjerëtë, armiqët' e saj edhe të Shqipërisë i le të dlir' e të çpenguarë të bëjnë ç'të duanë.

Kështu të jetë që të ronjë Tyrqia edhe ca vjet, do të mos mbetetë mê Shqipëri, pô ky vënt do të jetë copëtuarë për jetë në mest të Greqet e të Shqehet.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

A janë të zottë Shqipëtarëtë të mbajn' e të ruajnë vetëhenë?

Dy gjërëra duhenë në këtë jetë: e drejta edhe fuqija. E drejta pa fuqi, si edhe fuqija pa të drejtë, është si një krah i vetëm; nonjë zok s'fluturon dot me një krah. Më të rallë bën punë fuqija pa të drejtë; edhe e drejta pa fuqi fort rallë dëgjohetë. Peshku i math e ha gjithënjë të vogëlinë.

Tani Shqipëtarëtë q'e kanë të drejtënë me vetëhe, aty s'ka dyshim. Qysh të mos ketë Shqipëtari të drejtë të shkruanj' e të këndonjë gjuhën' e ti, kur gjithë kombetë, edhe mê të liqt' e mê të dobëtitë e kanë këtë të drejtë edhe njeri s'i ndalon? Përse Shqipëtarëtë të jenë të mërguarë nga një e drejtë q'e kanë gjithë kombet' e dheut? Të mos mundinë të shkruajn' e të mësojnë gjuhën' e tyre, pô të tjerë kombe të huaj të vin' e t'u hapinë shkolla në gjuhërat të tyre, e t'u kthejnë kombërin' e gjuhën' e tyre? Janë kaqë të dobëtë Shqipëtarëtë? - Jo! një mijë herë jo!

Shqipëtarëtë janë mê të fortë se gjithë kombet' e Sinisis' së Ballkanit. Pas shumicës' së tyre mbase janë mê të fortë e mê të shëndoshë se gjithë kombet' e dheut. Sot në këtë ditë e kështu si është Shqipëria munt të nxjerë një ushtëri prej 500,000 njerësh! Pa 200,000 e 300,000 dalinë me një herë. Ata

q'e njohinë Shqipërinë s'çuditenë me këto nëmura, se kaq' ushtëri Shqipëria ka nxjerr' edhe nxjerr për herë. Edhe kjo është pun' e diturë që një ushtëri prej 200,000 Shqipëtarësh është mbaras me një ushtëri të 500,000 ushtarësh të huaj. Trimërin' e Shqipëtarëvet edhe armikët' e tyre s'e ndryshojnë dot.

Pamë mê siprë se sa trimërirëra kanë bërë Shqipëtarëtë edhe qysh u kanë xbardhurë faqenë të huajet q'i kanë pasurë zotërinj a shokë. Këta që kanë treguarë kaqë trimëri për të huajt të cilëtë edhe s'para ua kanë diturë, s'qënkanë të zottë sot të mbajn' e të ruajnë vëndinë, gjuhënë e kombërin' e tyre? Qysh të mos jenë të zottë për këtë të drejtë, kur kan' edhe vëndinë të fortë q'u ndih? Gjer më sot kanë lëftuarë gjithënjë vetëm me fuqi, pô jo kurrë me të drejtë; sot është dita të lëftojnë me të drejtë e për të drejtë. Nukë ka mê të shënjtëruarë të drejtë se kombërija, gjuha e mëmëdheu për një komp. Një trim që lëfton për plaçk' e për rrëmbim është kurdoher' i turpëruarë; ay që lëfton për një të drejtë të këtillë është dy herë trim; e drejta i ep një forcë e një fuqi që s'e le kurrë të mundetë, pô e bën njërënë të muntnjë dhetë!

E pô kur janë Shqipëtarëtë kaqë të fort' e trima, pse rrinë me duar lidhurë, e të huajtë të dobët' e pa nonjë fuqi si edhe pa nonjë të drejtë po i copëtojnë e po i humbasinë për jetë? Rrinë me duar lidhurë, se duartë ua ka lidhurë e ua mban Tyrku, edhe të huajtë po i copëtojnë me fuqit e me ndihmet të këti! E po Tyrku ay vetë është kaq' i fortë, sa me një dorë t'u mbanjë duartë Shqipëtarëvet e me tjatërnë t'u ndihnjë armikëvet të këtyre? Jo, këtë e dimë që s'ësht' i fortë, pô është dhelpërë; Shqipëtarëtë i mban me dhelpëri e me tradhëri. Ta

themi edhe kështu, Shqipëtarëtë i lidhinë vetë duart' e tyre, se janë të paditur' e të verbërë!

Shqipëria sot është si një dragua i fortë, i rethuarë prej ca çakajsh e dhelpërash, të cilëtë i kanë lidhurë këmbëtë, e bëhenë gati ta çajn' e ta përlajnë. S'ka përveç se të tundet' e të lëkundetë pakë, të luanjë një herë dorën' e këmbënë, edhe gjith' ata çakaj e ato dhelpëra do të përhapenë, e do të mos kuxojn' as të kthejnë syt' e ta vështojnë një herë. Më parë Tyrqisë t'i tregonjë një herë dhëmbëtë, e t'i thotë: hiqu ti, e mos u përzje, se po të shoh bukurë se qysh po m'i çpërblen të miratë që të kam bërë; unë kam pesë qint vjet që po të ruanj, e ti po më mban duartë lidhurë që të më çajnë të tjerë; e do të më heqç edhe mua në funt të trapit, tek ke dëshirë të biesh vetë. Ç'janë Tyrqitë? - Një komp i egërë t'ardhurë nga shkretëtirërat' e Asis' së Veriut me nga një hosten në dorë. Këta me egërsi të tyre zunë mê të bukurit' e vëndevet të botësë e mê të qytetuarëtë; edhe si i ropnë, i gremizë e i doqnë, po i mbajnë edhe gjer më sot nënë një egërsi, nënë një varfërí, nënë një tiraní që tëmeron gjithë botënë. Nga gjithë këta vënde që po rënkojnë që nga kaqë qint vjet e tëhu edhe njeri është Shqipëri' e gjorë, që heq këtë tiraní, a heq mê shumë se gjithë vëndet' e tjerë nga pakujdesj' e Shqipëtarëvet. Tyrqitë janë nga ata kombe që kanë shkuarë mi dhet si një breshërimë e si një borë. Ku janë Hynëritë, Vandalëtë, Mongolëtë, Avarëtë, Gotërtë e kaqë kombe t'egërë që zunë gjymësën' e faqes' së dheut duke djegurë, duke gremizurë e duke derdhurë gjak? Tyrqitë s'kishinë të drejtë të rojnë mê teprë se ata shokët' e tyre; rojtjen' e qëndrimnë gjer më taní e patnë qelepír, taní s'kanë nonjë të drejtë të rojn' e të qëndrojnë mê, edhe as din' e as duanë të rojnë mê,

se gjer më sot s'kanë bërë një kombërí e një qeverí si gjithë bota, pô duanë të rojnë për jetë me egërsí. Këta do të humbasinë edhe duhetë të humbasinë, që të shpëtonjë njerëzia syresh, pô ç'kanë me na që duke rënë duanë të na marrinë edhe na me vetëhe? Na ç'kemi me ta? A mos erdhmë me ta? Jo kurrë! Na s'jemi as Tyrq as të ardhurë nga shkretëtirërat' e Asisë. Na jemi m'i vjetri komp i Evropësë; kemi të drejtë në dhet' t'Evropësë mê teprë se ç'do komp.

Këtë të drejtë të shënjtuarë Shqipëtarëtë janë të zottë ta ruajnë e ta kërkojnë edhe me armë në dorë. Kur përzjehetë e drejta me fuqit merr një forcë të cilësë gjë s'i rri dot kuntreq. Shqipëtarëtë janë pra të zottë të mbajn' e të ruajnë të drejtën' e tyre, do-me-thënë kombërinë, gjuhënë e mëmëdhen' e tyre kuntrë ç'do armiku; arrin vetëm të duanë.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Shpëtimi a humpja e Shqipërisë është në dorët të Shqipëtarëvet

Shqipëria sot ndodhetë në majet të një rripe fort të thellë e të tëmeruarë. Të qëndruarëtë n'atë majë s'është punë që munt të bëhetë; pô që desh të qëndronjë, do të rungullizetë nga rripa e të bëhetë një qint copë. Në dashtë të shpëtonjë, duhetë të prapsetë nga ajo majë, e të zërë një vënt të sheshmë e të pafrikçimë.

Shqipëria, pô që të shpëtonjë nga reziketë q'e kanë rethuarë, e të hynjë n'udhët të mbrodhësisë e të mbarësisë, bëhetë një nga mê të mirëtë e nga mê të bukuritë vënde t'Evropësë.

Sado që vënt jo shum' i math, s'është edhe shumë m'e vogëlë se Greqia, se Sërbia, se Bullgaria, se Rumania, se Danimarka, se Belxika, se Holanda, se Svicera etj., nga të cilatë sicilado është një mbretërí më vetëhe. Ndodhetë kundreq Evropësë, është fqinjë me Italinë e me Austrinë. Munt shumë çpejt të hynjë në qytetëri, e të përzjehetë me Evropënë. Ka gjithë ç'i duhetë, si e pamë mê siprë. Shqipëtarëtë janë fort të xgjuar' e të mëntçimë; kanë nxënje të madhe për qytetërí e për ç'do farë diturije; janë trima e ushtarë të çquarë.

Mëmëdheu yn' i dashuri nukë ron dot edhe shumë kohë kështu si është sot; a do të humbasë për jetë, e nukë do të mbesë as Shqipëtar as Shqipërí, a do të shpëtonjë, e të ndërtohetë me një mëndyrë, që të mos ketë shëmbëllë në jetet, e t'i bëjnë zili gjithë kombet' e dheut. Të shpëtuarët' a të humburit' e Shqipërisë është në dorët të Shqipëtarëvet; në daçinë, do të shpëtojnë, në daçinë do të humbasinë.

Shqipëtarëtë s'kanë nevojë të zírenë nga armëtë, të hiqenë nëpër malet e nëpër shpellat, të vriten' e të prishenë, si bëjnë kombet' e tjerë për të fituarë dlirin' e tyre. Shqipëtarëtë s'jan' aqë të shkelur' e të poshtuarë sa të shtrëngohenë në të këtillë mundime. S'kanë nevojë të bëjnë gjë përveç se të lidhinë fjalë në mest të tyre, të bashkohenë gjithë sa janë, t'apën' e të marrënë besë burrërisht, të qëndrojnë në fjalët të patundurë, edhe të kërkojnë të drejtën' e tyre nga Tyrqia e nga Evropa. Tyrqia do t'i dëgjonjë e do t'u apë ato që kërkojnë me hir a me pahir, edhe Evropa do t'u ndihnjë, si u ka ndihurë edhe kombevet të tjerë; edhe do ta shtrëngonjë Tyrqinë t'u ap' edhe këtyre të drejtën' e tyre.

III / Ç’do të bëhetë Shqipëria?

Besa e lidhja



P09 · Fotografi grupi e lidhur me Lidhjen e Prizrenit. Ilustrim shtesë i këtij botimi.

Bes’ e Shqipëtarit është edhe ka qënë gjithëmonë e ditur’ e e dëgjuarë ndër gjithë botët. Besënë, q’ep Shqipëtari, s’e mer prapë, s’e prish e e mban, gjer sa të ketë një reketim shpirti në kufomët të ti. Besa, q’e ka nderuarë gjer më sot Shqipëtarë, ajo besë do ta shpëtonjë sot nga gjithë reziket. Më parë se çdo gjë Shqipëtarëtë duhetë të lidhinë një besë të madhe e të përgjithçime në mest të tyre e të bëjnë një lidhje e një bashkim, që të pushtonjë të tërë Shqipërinë. Çdo Shqipëtar do të futetë në këtë lidhje e në këtë besë. Të lenë gjaqetë e armikëritë në mest të tyre; ç’është bërë gjer më sot, ta harojnë; kush ka për të marrë gjak, ta dhuronjë. Gjaku i Shqipëtarit është shum’ i vjejturë; pse të derdhetë kot? Pse të vritemi njëri me jatrinë, tek kemi nevojë të bashkohemi e ta derdhimë atë gjak kuntr’ armikëvet të mëmëdheut? Shqipëtarëtë, kështu të lidhurë me një besë të fortë e të

bashkuarë me një lidhje, do të jenë si një njeri vetëm, trim e i fortë, i cili ka një dëshirë, një fjalë e një qëllim të vetëm. Kush i del kundreq atëhere Shqipërisë e Shqipëtarit e kush kuxon t'i rrëmbenjë a t'i shkelnjë të drejtën' e ti, si ja bëjnë sot q'e gjejnë të ndar' e të dobëtë?

O burra-ni, o Shqipëtarë! Zihuni me të dy duartë në besët, në lidhjet e në bashkimt, se kjo do t'ju shpëtonjë! Jo po në mos, ini të humburë. Mos vështoni bes' e fe; myslimanë, katolikë, orthodhoksë, gjithë Shqipëtarëtë, sa jan' e tek janë, janë vëllezrë. Gjithë duhetë të bashkohenë nënë flamurit të shenjtuarë të Shqipërisë!! Ay Shqipëtar, që le vëllezërit' e ti e ndahetë nga Shqipëtarëtë, për të bashkuarë me armikët' e Shqipërisë, duke hequrë pre bese, ay është tradhëtor, ësht' armiku i kombit e i mëmëdheut. Të këtillë Shqipëtarë më mirë të mos jenë se të jenë. Këta duhetë të vështohenë si armikë e jo si Shqipëtarë.

Lëvdatë i qoftë Zotit! Lidhjeja po bëhetë në Shqipëri, besa po forcohetë, bashkimi po xgjerohetë. Nga një çip' i Shqipërisë u zu lidhjeja edhe ditë me ditë po përhapetë nëpër të tërë Shqipërit. Në kryet kjo lidhje u duk si e ndryshme, si e huajë nga qëllim' i Shqipëtarëvet; po sa vete, po del në shesht që s'ësht' ashtu; qe nevojë të duketë ashtu në kryet, se ashtu deshn' ata që e ngrehnë, pa treguar' ashtu s'ngrihesh dot kurrë, se s'e kishinë për të lënë. Po një her' e ngrehurë e e forcuarë do të muntnjë ta nxjerrë qëllimn' e saj në shesht, e të bënjë atë që duhetë. Mbledhj' e dytë e e tretë do të vërtetonjë këto fjalëtë tona.

Duamë të besojmë e të shpresimë që kjo lidhje, kjo mbledhje e kjo besë që po bëhenë sot në Shqipëri do të jenë krej i

shpëtimit të Shqipërisë; se gjithë Shqipëtarëtë e muarrë vesh rezikn' e madh të Shqipërisë, edhe e kupëtuanë ku 'shtë shpëtim' i tyre. Bes' e sotme s'ngjan me beserat të shkuara; është një besë për rrojtje a për vdekje.

Lidhj' e Shqipëtarëvet nukë bën të jetë për pakë kohë, po të jetë gjithënjë e kurdo gjer sa që t'u epenë Shqipëtarëvet ato që duanë, e të shpëtonjë Shqipëria nga reziku. Gjer atë ditë lidhja të qëndronjë, e të mbanjë vënt qeverije në Shqipëri, se qeveri e Tyrqet s'është një qeveri për ndërtim, po për prishje; qeveri e Tyrqet nuk' e shpëton Shqipërinë, po e humbet. P'andaj lidhj' e Shqipëtarëvet të zërë vëndin' e asaj në gjith' ato punëra që vështojnë kombërinë tënë e të drejtatë tona; këto punë t'i bënjë vetë a të shtrëngonjë qeverin' e Tyrqet t'i bënjë me pa hir; e kështu të ruanjë gjuhën' e kombërinë tënë e gjithë të drejtat' e kombit Shqipëtar.

Lidhja do të ket' aqë të ndara sa sanxhake ka Shqipëria edhe një mes. Në cilët-do nga këto do të jetë një këshill' e përherçime që të mblidhetë një herë në javët, edhe një këshill' e përgjithçime e e madhe që të mblidhetë një herë në mott edhe kur të ketë nevojë. Miset' e këshillës' së përgjithçime do të xgjedhinë miset' e këshillës' së përherçime, të cilëtë do të jenë: një krye, një shkronjës, një arketar edhe katr' a pesë mise. Këta, kur të shohinë nevojë, do të mbledhinë këshillën' e përgjithçime a do të kupëtohenë me të shkruarë me këshillet' të madhe të mesit.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Qëllim' i Shqipëtarëvet

Qëllim' i vetëm i Shqipëtarëvet është të ruajnë Shqipërinë të mos copëtohetë prej të huajve, të mbajnë gjuhën' e kombërin' e tyre, t'u rrinë kundreq entrigavet t'armikëvet të tyre, e të ndalojnë të përhapurit' e gjuhëvet e të mendimevet të Greqet e të Shqehet, të cilatë po i rëmojnë themeletë e po i nxjerrinë rënjëtë Shqipërisë e shqipëtarërisë.

Çdo gjë që munt t'i sjellë dëm këti qëllimi do të leftohetë keq prej çdo Shqipëtari të vërtetë edhe prej lidhjes' së Shqipëtarëvet. Ato gjërëra që do t'i ndihinë këti qëllimi do të zihenë me të dy duartë prej atyre e do të bëhenë me hir a me pa-hir. M'e par' e këtyre është gjuha; s'munt të ketë Shqipëri pa Shqipëtar, s'munt të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s'munt të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe e pa shkolla në të cilat të mësohetë shqipja. P'andaj më parë nga të gjitha do të mbahetë gjuha, të shtrëngohetë qeveri e Tyrkut ta ngrerë ndalimnë q'i ka vënë gjuhësë shqip, e të lerë shkollatë shqip të hapenë e livrat' e fletoretë shqipe të hyjnë e të shkelenë çpenguarë në Shqipëri. Çdo Shqipëtar të mësonjë më parë të shkruanj' e të këndonjë shqip, pa pastaj gjuhëra të tjera.

E dyta është kisha; të shpëtohenë Shqipëtarëtë nga xgjedh' e priftërís' së Greqet, të Bullgarëvet e të Serbëvet, e të kenë kishën' e tyre me priftër shqipëtarë e me ungjill shqip; se Krishti s'ish as Grek as Shqeh.

Po për të bërë këto, duhetë të qëndronjë qeveri e sotme, e të vihetë një qeveri mëmëdhetare, një qeveri që të punonjë pas nevojes' e pas të drejtavet të Shqipëtarëvet. Një qeveri

shqipëtare me sy hapurë, e jo qeveri e huaj e e verbërë, si kjo q'është sot. Të jetë një qeveri si duhetë, pa le të ketë ç'emënë të dojë.

Ky është qëllim' i Shqipëtarëvet.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Qeveri' e paskëtajme

Kjo qeveri që thamë është e nevojçime për Shqipëtarëtë si buka që hanë e si ujëtë që pinë. Pa një qeveri të këtillë Shqipëtarëtë s'mundinë të ngjallin' e të përhapinë gjuhën' e tyre e të mbajnë kombërinë.

Duhetë një orë më parë të ndahetë Shqipëria, e të dihetë që ku e gjer ku është. Të njihetë vëndi ynë për Shqipëri, ta njohë edhe Evropa Shqipëri. Shqipëtarëtë të ndritojn' e të xbukurojnë gjuhën' e tyre me shkronja e me dituri; të bashkohenë gjithë bashkë, e të tregohenë si një komb, i cili do të ketë të drejtatë që ka çdo komb mi faqet të dheut.

Atëherë edhe të bëhetë një trazim në Sinisit të Ballkanit, edhe të bjer' e të humbasë Tyrqia, Shqipëria qëndron me vetëhe të saj; edhe nonjë njeri nukë do të mendohetë ç'do të bëhetë Shqipëria, as njeri do të kuxonjë të vërë ndër mënt rrëmbimn' e një copë të Shqipërisë.

Kjo qeveri do të jetë sot për sot nënë Tyrqinë. Shqipëtarëtë që kanë pesë-qint vjet që po derdhinë gjak për këtë mbretëri, nukë do të duanë kurrë humbjen' e saj, me gjithë që e shohënë se ajo po përpiqetë t'i humbasë e t'i përndanjë në

mest t'armikëvet të saj edhe t'asaj. Shqipëtarëtë gjer më së-fundi do të derdhinë gjak për këtë mbretëri e do t'ja mbajnë besënë, si ja kanë mbajturë. Kur të kenë një qeveri kështu të mirë e të forcohenë si duhetë, edhe asaj Tyrqisë do të mundinë t'i ndihinë më tepr' e më mirë. Po në qëndroftë Tyrqia e të ngulnjë këmbëtë në këtë udhë që ka zënë duke rrungullizurë në trapt të humbjesë, e të mos dojë shpëtimn' e saj sindekur e ka zakon, atëherë Shqipëtarëtë shpëtojnë vetë vetëhenë, e nukë humbasin' edhe ata bashkë me këtë të marrë, që po vret vetëhenë, duke pasurë në dorë të shpëtonjë, si e di gjithë bota.

Kështu, kjo qeveri do të jetë nënë Tyrqinë, po me një mendyrë që, në rëntë Tyrqia, të mos ta heqnj' edhe atë pas, po të munjë Shqipëria, sikundrë q'është, të qëndronjë me vetëhe. Tyrqia, sa të jetë gjall, të mos munjë ta prishnj' e ta gremisnjë Shqipërinë, si e ka bërë gjer më sot, edhe kur të shuhetë, të mos ta heqë me vetëhe në varrt.

Po qysh do ta marrë këtë farë qeverije Shqipëria; se e dimë që Tyrqia me dashuri e me mirësi s'ep gjë kurrë. Tyrqia nuk' është një bari që do t'ushqenj' e të ngjallnjë dhëntë që ka, që t'u marrë qumështit e leshtë; por është një ujk q'atë të mjerë dele q'e zë prej xvercu, s'e lëshon pa çarë, pa i ngrënë mishtë e pa i dërmuarë eshtënatë. Do më mirë Tyrqia ta humbasë Shqipërinë e ta ndanjë në mest t'armiqevet të saj, se sa t'i apë një qeveri të urtë e të mirë, e cila ta ndreqnj' e ta xbukuronjë e ta bënjë një vënt të ndrituarë si gjithë bota. Kështu kanë bërë kudo, kështu kanë dhënë e kanë humburë kaqë vëndë, të cilëtë muntninë t'i shpëtoninë e t'i kishinë për jetë me një qeveri njerëzisht; se Tyrqitë thonë: kur të mos mundimë të vrasim' e të presimë, të rahimë, të rjepimë, të vjedhimë, të

djegim' e të gremizimë si duamë, atëherë ç'i duam ata vëndë? më mirë t'i lemë fare edhe le t'i marrë kush të dojë. Me këtë mendim mbretëri e Tyrqisë nukë do edhe gjer më sot të bënjë ndrejtimet' e Rumelis' e t'Anadollit, për të cilat është zotuarë në kuvent të Berlinit një-zet e kaqë vjet më parë, edhe sado q'e shtrëngon Evropa, ajo s'bën as më të pakënë ndrejtim, po bëhetë gati për luftë, e cila do ta humbasë fare.

Pr'andaj edhe Shqipëtarëvet me hir Tyrqia s'u ka për të dhënë gjë. Shqipëtarëtë duhetë t'i marrënë ato që duanë me pa-hir; t'i kërkojnë me fjalë, po të ken' edhe pushkënë plot. Nukë besojmë prapë të jet' aq' e çmendurë sa të zihetë në luftë me Shqipëtarëtë; shkuan' ato kohë që shpintë Gegëtë kuntrë Toskëvet e Toskëtë kuntrë Gegëvet; sot jo vetëm Shqipëtarëtë po mbase edhe shumë Tyrq, edhe më teprë Tyrqit' e Rumelisë, s'u bjenë Shqipëtarëvet. Nga Anadollakëtë Shqipëtarëtë s'trembenë fort. Po veç kësaj kur të mbërthehenë Shqipëtarëtë me Tyrqitë, të tjerëtë kombe të Sinisis' së Balkanit mos do të vështojnë së-largu, e të mos ngrihen' edhe ata të marrinë pjeset' e tyre?

Nga këto mendime Tyrqitë do të mos u bjenë dot Shqipëtarëvet; edhe ca nga mbretërit' e mbëdha, që s'duanë trazime në Sinisit të Balkanit, do të hyjnë në mest për të mos ndezurë zjari, e do ta shtrëngojnë Tyrqinë t'u apë Shqipëtarëvet, ato që duanë. Jo po në mos dasht' as Tyrqia as Evropa t'u vënë vesh Shqipëtarëvet, atëherë këta munt t'i trembinë që jemi gati ta bëjmë fjalënë një me fqinjet' e vegjëlë që kemi rrotull, e ta ndajmë Tyrqin' e Evropesë në mest tënë, duke mbajturë na Shqipërinë, e duke len' atyre vëndet' e tjera. Si do që të jetë fjal' e Shqipëtarëvet do të dëgjohetë, edhe të drejtat' e tyre do t'u epenë.

Shqipëria anë mb'anë do të njihetë Shqipëri e do të ketë një qeveri të sajnë e me vetëhe. Kjo qeveri, sa të jetë Tyrqia n'Evropë, duamë të jetë nën' atë; edhe po s'na goditi e të na dëbonjë vetë, kurrë nukë do të duamë të ndahemi fare soje. Po puna tregon që Tyrqia, me këtë udhë që ka zënë nukë rron dot edhe shumë kohë; pa le n'Evropë q'e ka jetënë fort të shkurtërë. Atëherë ç'do të bëhetë Shqipëria? Do të mbesë me vetëhe; mirë po qysh? ç'farë qeverije do të bënjë?

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Krej i qeveris' së Shqipërisë

Të huajtë nga një herë edhe Shqipëtarëtë përherë mendohenë që, kur të mbesë Shqipëria me vetëhe të saj, kush do të bëhetë princ a mbret a ç'është për të quajturë krej i qeverisë. Në qoftë shqipëtar, thonë nonjë fëmijë në Shqipëri s'ësht' aq' e madhe e aq' e njohurë prej gjithë Shqipëtarëve; pastaj, në qoftë Gegë, s'e duanë Toskëtë, në qoftë Toskë s'e duanë Gegëtë; në qoftë mysliman, s'e vështojnë me sy të mirë të krishtenëtë, në qoftë i krishtenë, s'u vjen mirë myslimanëvet. N'ardhtë një i huaj nga Evropa, do të vinjë me gjithë ballot' e theatrot' e të tjera zakone t'Evropesë, të cilatë jo vetëm myslimanëtë, po as të krishtenëtë në Shqipëri s'i duanë. N'ardhtë një princ a mbret mysliman i huaj, ay do të vinjë me një karvan hademe; gra, arrapë, qepe etj, të cilëtë Shqipëria s'ja ka kohënë t'i ushqenj' e t'i mbanjë.

Po ç'i duhetë Shqipërisë një njeri në kryet të qeverisë? Një mbret a princ do të prishnjë shumë sa s'ja ka fuqinë vëndi

ynë; do të na prishnjë edhe vetietë tona duke marrë ca nga na nënë sqetullë e duke ftohurë të tjerëtë.

Straboni dheshkronjës' i madh, duke shkruarë për vëndit tënë, afro dy mijë vjet më parë thotë që: Maqedhonasitë, Illyrianëtë, e Epirotëtë (do-me-thënë gjithë Shqipëtarëtë), sado që çe ku kanë ca mbretërirëra, po qeveri e tyre e vërtetë është një farë këshillësh prej të parëvet, që këto këshilla i quajnë plakoni (do-me-thënë pleqesi), edhe këto qeverisin' e gjykojnë n'ata vënde. Përse pra ta lemë na këtë zakon të bukurë të kaqë mijë vjeç sot, e të kërkojmë një njeri të huaj, që të na hajë gjymësen' e të dhënavet të Shqipërisë, edhe të na prishnjë gjithë vetiat' e bukura të kombit? Ç'na duhetë një i këtillë njeri. Na të mos heqimë dorë kurrë nga plakoni e Strabonit, nga pleqesia, të cilënë e kemi ruajturë edhe gjer më sot, se kurdo pleqesia urdhëron në Shqipëri. Pleqesija t'urdhëronjë e të mbretëronjë gjithënjë.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Të ndarët' e Shqipërisë

Nuk' e dimë mirë sot se për ku do të xgjatetë Shqipëria që ta themi të prerë edhe më sa gastra do të ndahetë; se m'anët të lindjesë kemi ca vënde të përzjerë, nga të cilëtë nuk' e dimë se cilëtë do të na i lenë neve e cilëtë do të mos na i lenë. Po duke folurë pas dëshirësë sanë, munt të themi që Shqipëria munt të ndahetë më 15 gastra, të cilatë pas kryeqytetevet të tyre janë: Shkodra, Peçi (Ipeku), Prizreni, Prishtina, Ysqypi, Manastiri, Dibra, Elbasani, Tirana, Berati, Korça, Kosturi, Janina, Gjinokastra e Preveza. Cilado nga këto gastra do të ndahetë më 3-4 nënëgastra [kaza], nga të cilatë e mezit do të qeverisetë prej qeverindarit vetë, edhe të tjeratë prej nënëqeverindarësh. Kështu në gjithë Shqipërit do të ketë 15 qeverindarë edhe nonja 50 nënëqeverindarë.

Mez' i Shqipërisë do-me-thënë kryeqytet' i përgjithçim do të jetë një nga qytetet që ndodhenë në mest të Shqipërisë e në të cilët të flitetë gjuha Shqip. Po më mirë do të që të bëhesh një qytet i ri në mest të Shqipërisë me një vënt të shëndeçim e të bukurë. Ky qytet të cilënë mundimë ta quajmë Skenderbegas do të goditetë më një mendyrë fort të bukurë, me udhë të gjera e të drejta, me shtëpi të mira, me sheshe e me gjithë ç'duhetë; edhe në pakë kohë munt të ritet' e të madhohetë shumë, se gjithë parësi e Shqipërisë e Shqipëtarët' e xgjuarë do të kenë nevojë të mblidhenë e të bëjnë shtëpi atje. Kështu ky qytet i ri do të jet' i çprenguarë nga gjithë zakonet' e keq që kanë qytetet e vjetërë; edhe me të qënë që ndënjësit' e ti do të jenë të mbledhurë nga gjithë anët' e Shqipërisë, edhe gjuha që të flitetë atje do të jet' e

përzjerë, që të muntnjë të quhetë gjuh' e përgjithçime e gjuhë letrarishte e gjithë Shqipërisë. Ky qytet me pakë vënde rrotull do të qeverisetë si një nënëgastr' e veçant.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Pleqësija

Çdo gastrë do të xgjedhë një nga parësi e saj për këshillët të Pleqësisë. Këta të pesë-mbë-dhetë pleq do të mblidhenë në kryeqytett të Shqipërisë, e do të xgjedhinë në mest të tyre njërënë krye edhe njërënë nënë-krye. Krej i Pleqësisë ay do të jetë në vëndit të princit e të mbretit në Shqipëri, ay do të pres' e të përcjellë, ay do të nënëshkruanjë gjithë të vendosurat' e kabinetosë, ay do të thërresë kë të shohë t'udhësë e ta vërë të bënjë kabineto të re, kur të ndronetë ajo, ay do të hapnjë këshillën' e përgjithçime e të bënjë fjalën' e hapjesë. Me një fjalë do të bënjë gjithë ç'bëjnë mbretërët' e princitë në vëndet të tjerë; po gjithë këto do t'i bënjë si t'i bëjnë një herë kuvent në këshillët të Pleqësisë, e duke marrë edhe mëndjen' e të tjerëvet pleq; e nukë do të bënjë gjë me kokët të ti, se një njeri munt të gënjehet' e të lathitnjë, po pesë-mbë-dhetë njerës të pjekur' e të vuarë s'munt të lathitinë të tërë. Sado që krej i Pleqësisë do të ketë nder' e krejt të qeverisë, po në punët s'ësht' ay vetëm, po e tërë Pleqësija që do të urdhëronjë. Kur të jetë i smurë a të ndodhetë jashtë krej' i Pleqësisë, nënë-krej do të shohë punën' e të zërë vëndin' e ati.

Pleqtë do të xgjidhenë për katrë vjet si edhe krej i tyre; po nukë do të ndrohenë të tërë për një herë; gjymësëtë do të

xgjidhenë një herë e gjymësëtë pas dy vjeç. Kështu më çdo dy vjet do të ndrohenë gjymëset' e pleqet. Kreji do të ndrohetë me njërënë gjymësë e nënëkreji me tjatrënë, që të mos mbesë këshilla kurrë pa krye e pa nënë-krye për një herë. Po në qoftë që nënkrej të xgjidhetë për krye në xgjedhjet të dytë, atëhere do të xgjidhetë një nënëkrye vetëm për të dy vjettë q'i kishinë mbeturë ati.

Cilido nga pleqtë do të ketë një shkronjës, edhe shkronjës' i krejt të këshillësë do të jetë kryeshkronjës. Shkronjësitë nukë do të ndrohenë me pleqtë bashkë. Cilado nga gastrat' e Shqipërisë do të ketë gjithënjë përshkruarje me plaknë që ka xgjedhurë vetë, e këti do t'i shkruajnë për çdo qarje që të kenë a nga njerëzit' e qeverisë a nga të tjerë e për çdo të mete që të kenë në vëndit. Shkronjësitë do t'i mbajnë e t'i ruajnë me radh' e me udhë, edhe, si t'i këndonjë cilido plak me shkronjësin' e ti, do t'i vënë në këshillët të pleqësisë, për të menduarë ç'duhetë të bëhetë, e për të shkruarë krejt të ministrevet a ati ministri q'është pun' e ti. Kështu Pleqësija do të jetë edhe një mesësh në mjet të vëndëset e të qeverisë, për të vënë çdo punë n'udhë e që të mos ketë njeri të qarë.

Pleqësija do të jetë gjithënjë e të mblidhetë për ditë. Veç dy muaj në verë, në muajt të parë gjymësëtë në të dytët gjymëset e tjerë, do të kenë pandalje të venë në vëndet të tyre që të defrejnë edhe të shohënë nevojat' e vëndit.

Ata që do të xgjidhenë për këshillët të Pleqësisë do të jenë nga parësija e nga njerës q'u shkon fjala, do të jenë 30 vjeç e siprë, qënkanë të kënduar' e të mësuarë a jo.

Pleqësija do të vështonjë edhe të vendosurat' e këshillës' së përgjithçime, e të mbanjë gjithënjë udhën' e mesme duke

ruajturë urtësinë, zakonet' e vëndit e vetiat' e Shqipëtarëvet, e duke xbuturë pakëzë ato që të shohë shumë të rrefketa e të zjarta.

Duke ndruarë pleqtë gjithë parësis' së Shqipërisë do t'u vinjë radha të hyjnë në këtë këshillë, edhe shumë do të mundinë të bëhenë krye e Pleqësisë; e njeriu do të mos i mbesë ngaje për të qarë; edhe ata që s'janë aqë të mësuarë sa të shkojnë në kryet të punëvet, do të mundinë të hyjnë në Pleqësit, e të mos mbesinë pa pjesë.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Këshill' e përgjithçime

Nga çdo nëngastrë do të xgjidhenë dy, do-me-thënë afro më çdo 20,000 vëndës një i dërguarë. Këta, që do të bëhenë 100 a pakë më tepr' a më pakë veta, do të mblidhenë në kryeqytett të Shqipërisë, e të bëjnë këshillën' e përgjithçime, e cila do të mblidhetë një herë në mott e të qëndronjë një muaj, për të vështuarë buxhenë e gjithë punët' e përgjithçime të vëndit e shumë punëra që do t'i dërgonjë kabinetoja a Pleqësija. Të xgjedhuritë, do-me-thënë miset' e këshillës' së përgjithçime, do të xgjidhenë për 4 vjet, po më çdo 2 vjet do të ndrohenë gjymëset' e tyre. Ata që të xgjedhinë do të kenë mbushurë të 20 vjettë, do të kenë shtëpi, arë a çdo farë gjëje që të paguanjë të pakënë 5 copë (franga) në mott qeverisë, a të ketë dalë nga një shkoll' e të dijë të shkruanj' e të këndonjë. Ata që do të xgjidhenë duhetë të kenë mbushurë të 25 vjettë, të kenë shtëpi e dhe a tjatrë gjë që të paguanjë në mott qeverisë të pakënë 10 copë a të kenë mbaruarë një shkollë të dytë a të lartë.

Çdo farë nomi që të vihetë e çdo dhënje që do të hidhetë e gjithë punërat' e mbëdha, si udhët' e hekurta etj., si të mendohen' e të vendosenë mirë prej këshillës' së ministrevet, do të vihenë në këshillët të përgjithçime, e si t'i pëlqenjë kjo këshillë, do të vihenë edhe në pleqësit, edhe në u pëlqefshim' edhe prej pleqësisë, do të kthehenë në këshillët të ministrevet me nënë-shkruarjet të krejt të Pleqësisë.

Të xgjedhuritë me të mbledhurë do të xgjedhinë në mest të tyre një krye edhe një nënëkrye.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Ministrëtë

Ministrëtë që do të qeverisinë Shqipërinë pas nomevet, do të jenë shtatë vetë: i punëravet të brëndësme, i punëravet të jashtesme, i ushtërisë e i detit, i begatisë, i gjyqërisë, i diturisë, i punëvet të përgjithçime, i besëvet. Njëri nga këta do të jetë krej i gjithëve e i këshillësë që do të bëjnë këta, kur të jetë Shqipërija me vetëhe; kur të jetë nënë Tyrqinë krye do të jetë qeverindar' i përgjithçim, i cili do të dërgohetë nga Konstantinopoja për pesë vjet. Port' e Lartë do t'i shkruanj' emënin' e këti Pleqësisë, edhe Pleqësia do të mbledhë këshillën' e përgjithçime, edhe në e pëlqefshinë këto dy këshilla atë njeri, do të dërgohetë; në mos, krej i Pleqësisë do t'i përgjigjetë Portesë, e t'i thotë të xgjedhë një tjatrë, kështu gjer sa të pëlqehetë.

Cilido nga ministrëtë ësht' i pyeturë për punëratë që do të bënjë përpara këshillës' së përgjithçime e të Pleqësisë, edhe krej i ministrevet a qeverindar' i përgjithçim do të përgjigjetë për të tërë.

Këshill' i ministrevet do të mblidhetë një a dy herë në javet për të kuvenduarë për punërat të qeverisë; e çdo ministre do të vërë në kuvent ato punëra që s'ka kuxuarë dot t'i bënjë me kokët të ti. Kjo këshillë për ca punëra të rënda do të hynjë në shkruarje-përgjigje me pleqësinë, edhe, kur të shohë nevojë, do të bashkohetë me pleqësinë për të kuvenduarë bashkë.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Ushtërija

Çdo Shqipëtar do të jetë ushtar që më 20 e gjer më 40 vjeç. Me të shkelurë më të një-zetat, do të hynjë n'ushtërit të mësimit [nizamije] për një mot vetëm. Në këtë mot do të rrijë n'ushtarët [kishllat] me t'afrë nga vënd' i ti, e të mësonjë diturin' e luftësë e gjithë mësimetë q'i duhenë një ushtari. Në i mësoftë më pakë kohë se motemot, do të kërkonjë me të shkruarë lëshimn' e ti, edhe po që ta vërtetonjë urdhëtar' i ti, lëshohetë. Ata që dalinë nga ushtëri e mësimit hyjnë n'ushtërit të gatijtë [redif], e cila ndahetë më tri radhë, e para 7 e të dy të tjeratë nga 6 vjet. Radh' e parë mblidhenë një muaj në mott për të përsërituré mësimnë [talimnë], radh' e dytë dy javë në mott edhe radh' e tretë vetëm një javë. Këta mblidhenë në kryet të nënëgastres' së tyre, tek kanë urdhëtar' e tyre edhe armët' e rrobatë, si cilido me nëmurë të ti. Kurdo që të jetë nevojë e t'epetë urdhërë, në çast ushtëri e gatijtë do të merretë nën' armë, në nevojet të pakë radh' e parë, në nevojera më të mbëdha edhe e dyta e më së fundi e treta radhë; e të shpihenë tek duhetë.

Pas të dy-zetavet çdo Shqipëtar është ushtar vënt-ruanjës (mystahfiz) gjer më 60 vjet. Këta vetëm në kohët të luftësë do të merrenë nën' armë që të ruajnë vëndinë.

Ushtëri e Shqipërisë, e cila me këtë mendyrë në kohët të paqesë nukë do të jetë m'e tepërë se 20,000 shpirt, po në kohët të luftësë munt të dalë gjer më 500,000 burra, do të jet' e ndarë më katrë krahë: një në kufit të Greqisë, një në kufit të lindjesë, një në kufit të veri-lindjesë a të Serbisë, edhe një në

kufit të veri-perëndimit a të Malit-të-zi. Janina, Manastiri, Prishtina e Shkodra do të jenë mezet' e këtyre krahëve. Në mest të çdo gastrë do të jetë një urdhëtar [gjeneral], në mest të çdo nënëgastrë një mijës (bimbash), edhe nëpër katundërit urdhëtarë më të vegjëlë pas nevojësë.

Këta urdhëtarë nukë do të përzjehenë me ushtërin' e mësimit, të cilët do të kenë urdhëtarët' e tyre, edhe do të ndodhenë në pakë vënde; po do të kenë ushtërin' e gatijtë, të cilënë do ta mbledhinë në kohët të mësimit, edhe në kohërat të tjera do t'u mbajnë defteretë n'udhë, do të urdhërojnë edhe ushtërin' e ruajtjesë [xhandarëtë]; edhe kur të ngjanjë një trazim që të mos arrijnë këta, në çast do të thërresinë ushtërin' e gatijtë të një radhe e të një a disa katundërije, e me këta do ta shuajnë trazimnë e të sjellinë pushimnë.

Ushtëri e detit do të jetë pak' e ndryshme e të mbesë ca kohë më teprë nën' armë për mësim, si edhe ka[l]orësitë e kanonasitë. Të detit do të jenë në disa anie të luftësë që do të kenë meze në Ujët-të-Ftohtë (Pasha-Liman) afrë Vlorësë, e do të ruajn' anët e detit që n'Ulqyn e gjer në Sallahorë.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Diturija

Në ka një gjë për të cilënë Shqipëtarëtë duhetë të kujdesenë me të teprë, ajo pa ndryshim është Diturija. Gjithë katundetë e gjithë pshatratë a dy tre pshatra t'afërta bashkë duhetë të kenë shkolla të para edhe qytetetë të kenë nga më shumë se një, pas madhëris' së tyre. Gjithë djemt' e vashatë që më 7 vjeç e gjer më 13 do të jenë të shtrënguarë të venë do-mos-do në shkollë, edhe ata prindërë që të mos dërgojnë fëmijënë në shkollë do të qërtohen' e të shtrëngohenë t'i dërgojnë. Mësimi do të jetë pa nonjë pagesë, edhe të varferet do t'u epenë edhe fletoretë e karta etj. pa pagesë. Në mest të çdo nënëgastrë do të jetë një shkoll' e dytë për djemt edhe një për vajzat. Në mest të çdo gastrë do të jenë veç shkollavet të dyta (ryshdije, σχολεῖον), edhe të treta (i'dadije, γυμνάσιον) për djem e për vajza veçan edhe shkolla për mjeshtëri pas vëndit a për bujqësi etj.

Në kryeqytett të Shqipërisë, përveç shkollavet të dyta e të treta do të jetë një gjithëmësime (dar-yl-fynun, πανεπιστήμειον), një shkollë ushtërije, një për metaletë, e për pyjetë, një për bujqësinë edhe shumë të tjera për dituri e për mjeshtëri të veçanta. Më pastaj edhe dy gjithëmësime duhetë të hapenë: një në Shqipëri të Sipërme e një në të Poshtërmet. Shkoll' e anierisë duhetë të jetë mb'anë detit, tek të jen' edhe aniat' e luftësë, në Durrësë a në Ujët-të-Ftohtë (afrë Vlorësë).

Një këshillë diturije (akademie) duhetë të jetë në kryeqytett, e cila të kujdesetë për gjuhët' e për livratë që duhenë etj. Një shtypëtore e qeverisë do të merretë me të shtypurë livratë që

duhenë për shkollatë, edhe të nxjerrë fletore diturije të përkohëshme e çdo gjë që duhetë për të xgjuarë Shqipëtarëtë. Disa shoqërirëra do të bëhenë me ndihmit të ministris' së diturisë për të shpënë përpara dheshkronjënë, istorinë, dhekërkonjënë (γεωλογία), metaletë e të tjera punëra të Shqipëris; edhe cilado nga këto do të nxjerrë një herë në muajt a më pakë një fletore të përkohçime; në të cilët të rrëfehetë gjithë ç'ka gjetur' a çpikurë shoqërija.

Në kryeqytett të Shqipërisë do të jenë dy shkolla të mbëdha për gjuhërat; në njërët nga këto do të mësohenë gjuhërat' e ra t'Evropësë: francishtja, gjermanishtja, italishtja, inglishtja, slavishtja, greqisht' e re etj.; në tjatëret gjuhërat' e vjetëra: Greqisht' e vjetërë, latinishtja, arabishtja, persishtja, sanskrishtja etj. Cilado nga këto shkolla do të ketë një këshillë, e cila do të jetë e mbledhurë prej njerësh që dinë këto gjuhëra, edhe do të përpiqenë të shkruajn' e të shtypinë livra mësimi etj. në këto gjuhë, edhe shtypëtore e qeverisë do të ketë shkronjat' e gjithëve këtyre gjuhe për të shtypurë ato.

Një musie e përgjithçime do të jetë në kryeqytett për gjithë sa gjërëra të vjetëra, shtaturëra, fytyrëra, gurë të shkruarë etj. që do të gjendenë në Shqipëri e gjetkë, edhe qeveri e kësaj musie do të mihnj' e të rrëmojë gjithë vëndet' e qytetevet të vjetërë për të kërkuarë antikëra. Një tjatrë musie do të jetë për istori të naturtë, edhe këshill' e kësaj do të bënjë kërkime nëpër të tërë Shqipërit për barëratë, drurëtë, metaletë, gjërërat' e gjalla etj. të Shqipërisë, si edhe gjërërat' e vjetëra të dhet[r]egonjësë e të njeritregonjësë. Cilado nga këto të dy këshilla të musievet do të nxjerrë një fletore një herë në muajt, në të cilat të shkrujnë kërkimet' e gjendjet' e tyre edhe shumë diturirëra prej ç'bëhenë n'Evropë e gjetkë për këto

punëra. Një bibliothek' e madhe do të bëhetë e të ketë brënda livra etj. të shkruara të nevojta e të vyera në gjithë gjuhët që munt të merrenë vesh në Shqipëri.

N'ata vënde të Shqipërisë që flitenë edhe të tjera gjuhë përveç Shqipesë, si bulgarisht, greqisht, vllahisht, ata që flasinë këto gjuhë do të mësojnë në shkollat të para gjuhën' e tyre edhe shqipenë bashkë; shkollat' e dyta e të lartëta do të jenë Shqip; po në dashçinë, munt të bëjnë edhe shkolla të mbëdha në gjuhet të tyre për vehte; po, pos ditnë të shkruajn' e të këndojnë shqip, në nonjë punë të qeverisë s'hyjnë dot, as në këshillat mundinë të xgjidhenë si mise.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Punërat' e përgjithçime

Pas diturisë kujdes' e Shqipëtarëvet e m'e madhe nevoj' e tyre do të jetë për punërat' të përgjithçime, të cilatë do të sjellinë begati e pasje të madhe në Shqipëri. Udhëtë, udhët' e hekurta, limanetë, të hapurit' e lumenjet e të kënetavet, metaletë, pyjetë etj. janë më të nevojshimet' e më të vyerat' e punëravet që do të bënjë Shqipëria, me të pasurë duart' e këmbëtë xgjidhurë. Udhëtë për të cilat tani Shqipëtarëtë paguajn' aqë sa muntte me to të farkohëshinë gjithë udhët' e Shqipërisë me e[r]gjent, munt të goditenë më fort më pakë ergjent prej një qeverije së drejtë e me nder, e të punojnë njerëzit' e kafshëtë pa rezik me të gjith' anëtë.

Një udh' e hekurtë të nisetë prej Manastiri, e si të shkonjë nga Korça, të ndahetë më dy dega, nga të cilatë njëra të

sosetë në Prevezë duke shkuarë nëpër Janinë, e tjatera të shkonjë në Berat e në Skenderbegas, edhe s'andejmi të ndahetë prapë më dy për të sosurë njëra në Vlorë, tjatra në Durrësë, duke xgjaturë edhe një degë gjer n'Elbasan. Një tjatrë udhë nga Manastiri të shkonjë n'Ohri e s'andejmi, duke marrë anën' e Drinit, një degë t'unjetë në Shkodrë e në Lesh; tjatra të shkonjë nga Prizreni e të bashkohetë në Ferizovik me udhët të madhe që vete në Selanik e n'Avstri.

Këto udhëra të hekurta edhe me ca dega të dyta mundinë të mbarohenë në pakë kohë ndo prej shoqërije të huaja ndo prej Shqipërisë vetë me të marrë pakë hua, e të sjellinë në vëndit një pasje e një qytetëri të madhe.

Pas udhëvet m'e para punë për të bërë është Myzeqeja. Kjo fush' e gjerë është një magj' e madhe që munt t'ushqenjë gjithë Shqipërinë, e të nxjerr' edhe shumë drithë e të tjera gjërëra, po që të ndërtohetë si duhetë. Për të ndërtuarë kjo fushë duhetë të hapenë lumenjtë, Semani, Lum' i Beratit, Devolli etj. si edhe Vjosa e Shkumbini që rrjedhinë nëpër anët të saj. Këta lumenj duhetë, të thellohenë, e t'u bëhenë mure tek duhetë që të mos përndahetë ujët e tyre nëpër fushet. Atëhere munt t'u bëhenë edhe ca dyere e vija që të hapen' e të mbyllenë, e me të cilatë të ujitetë gjithë fusha. Atëhere do të mundinë të përthahenë edhe kaqë këneta e moçale në të cilat qëndron ujët' e teprë në verë, e prish edhe erën' e gjithë vëndit duke qelburë; edhe në dimërë do të shpëtonjë gjith' ajo fushë nga të qënetë një kënet' e pa-prerë e mbyturë n'ujë. Myzeqeja do të bëhetë një ar' e gjer' e e gjatë e cila me qënë nën' ujë e me të pasurë një dhe fort pëllor, do të bëhetë një Egjypt' e dytë. Bregoret' e Myzeqesë munt të mbulohenë me vreshta e me ullinj; edhe luadhet' e saj munt

t'ushqejnë kuaj e bagëti sa të mbushinë jo vetëm Shqipërinë po edhe Evropënë.

Të hapurit' e limanit të Durrësit, liman i gjer' e i bukurë n'anët të veriut të këti qyteti, të cilënë Sulltan Mehmeti e ka mbyllurë me pa diturit të ti për të mos hyrë aniet' e Veneçanëvet. Të hapurit' e grykës' së këti limani edhe të thelluarët' e të brëndësmit do ta bënjë këtë qytet të përsëritetë si ka qënë një herë qëmoti, e të bëhetë një Trijest' e dytë a një tjatrë Selanik. Edhe shumë të tjerë limane munt të hapen' e të qërohenë nëpër anët t'Adriatikut, si Butrintoja etj. e shumë skela me tregëri të madhe të çpikenë, e të venë mbarë.

Një shoqëri vaporësh munt të ngrihetë, e të punonjë vapore nëpër skelat të Shqipërisë edhe gjer në Trijeste, në skelat t'Italisë e të Greqisë. Vaporë e anie munt të punojnë edhe nëpër kënetat, të Shkodrësë, t'Ohrisë, të Prespësë etj. si edhe në ca nga lumenjtë që do të hapenë.

Gjithë këto punëra si edhe pyjet' e metaletë do të vështohenë prej ministres' së punëravet të përgjithçime. Çdo pyll do të ndahetë më disa gastra, edhe gjer sa të vinjë radha të pritetë gastr' e fundit, gastra q'u pre të parënë herë do të jet' arriturë për së-rish; e kështu gjithënjë do të pritetë lëndë nga pyjet, edhe kurrë pyjetë do të mos mbarohenë, po do të përsëriten' e të jenë kurdo të lulëzuarë. Metaletë do të kërkohenë nëpër të gjith' anët të Shqipërisë, e të nxirenë kudo të gjendenë.

Edhe mjeshtëritë e tregërija si edhe bujqësija e bagëtija do të kenë kujdesën' e kësaj ministre, e cila do të përkujdesetë të vejë mbarë në çdo vënt ajo mjeshtëri, në të cilët janë mësuarë vëndësitë: leshi, liri, pambuku, mëndafshi, hekuri,

druri t'arrihet' e të punohetë sa të mundetë më teprë, që të mos ketë Shqipëria aqë shumë nevojë të sjellë nga këto së jashtesmi.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Punërat' e besëvet

Një nga ministret, i diturisë a i gjyqit, do të ket' edhe punërat' e besëvet. Një Myfti i math për myslimanëtë, një Eksark për të krishterët' orthodhoksë edhe një kryepiskop për katolikëtë, këta do të vështojnë gjithë punt' e të tri besëvet në Shqipëri; Xamitë, kishatë, teqetë, manastirëtë, myftinjtë, imamëtë, myezzinëtë, priftëritë e gjithë njerëzit' e vëndet' e besësë, si edhe të pasurat' e këtyre e vakëfetë do të vështohenë e të vihenë mb'udhë prej këtyre të tre zotërinj të mbëdhenj, të cilëtë do të ken' edhe nga dy këshilla për të menduarë këto punëra. Ministri që do të ket' edhe të qyrurit' e këtyre punërave do t'u ndihnjë, edhe do t'u vështonj' edhe hesapetë, pa përzjerë në punërat që janë fjeshtë të besësë e të cilatë vetëm këshillat e besësë do të mundinë të përzjehenë. Nga të dy këshillatë, që thamë që do të ketë cilido nga të parët' e besëvet, njëra do të jetë e mbledhurë fjeshtë prej njerëssh të besësë: myftinj, ylema, myderrizë, dervishë a piskopë, priftrë, theollogë etj. tjatra do të jet' e përzjerë prej të këtillë njerëssh edhe prej botë. E para do të përzjehetë vetëm në punërat të besësë, do të vështonj' edhe livrat' e besësë; e dyta do të vështonjë qeverin' e xamivet e të kishavet, do të vështonjë hisapetë e të tjera të këtilla gjërra. Ca nga misët' e këtyre këshillave do të vihenë prej të parëvet të besëvet e të vërtetohenë prej kreit të qeverisë duke shkruarë ati nga an' e ministrit të besëvet, edhe ca do të xgjidhenë prej vëndeset.

Të parët' e besëvet, do-me-thënë Myftiu i math, Eksarku e Kryepiskopi do të jenë në nder të math, pô nukë do të

përzjehenë përveç se në punërat të besësë, si edhe myftinjt' e tjerë, piskopëtë e gjithë njerëzit' e besësë. Ulemaja, dervishëtë e priftërija do të mos përzjehenë as në mësimt e në shkollat përveç mësimit të besësë që do ta bëjnë nëpër xamit, medreset kishat etj.

Bektashinjtë, të cilëtë janë miaft të përhapurë e të shumë në Shqipëri, do të kenë një Krye-baba në një vënt të Shqipërisë, i cili do të bënjë babanjt' e tjerë, e bashkë me një këshillë të mbledhurë prej babanjsh e prej dervishësh të vështonjë e të vërë mb'udhë punët e teqevet e të Tarikatit.

Gjithë besët' e tjera do të jenë të çpenguara e të dlira në Shqipëri; Judhenjtë, Protestanëtë etj. do të kenë nga një krye më vethe nënë qyrërit të ministrit të besëvet.

Ç'do njeri besën' e ka për vethe të ti, edhe kurrëkush s'ka të drejtë të shtrëngonjë tjatrinë për të besuarë një gjë a për të bërë një punë të besësë me pahir. Të parët' e besëvet, ylemaja e priftërija vetëm me fjalë e me të mirë do të mundinë të sjellinë botënë n'udhët të besësë, edhe këtë nëpër xamit, medreset, teqet, kishat etj. e jo jashtë. Nonjë njeri nukë do të shtrëngohetë të paguanjë gjë për punërat e për vëndet të besëvet; veç kush të dojë vetë t'apë ç'i do zëmra.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Punët' e begatisë

Shqipëria sot, pas pagesavet që merr qeverí e Tyrqisë në të katrë vilajetet, me gjithë kumerqe e krip' etj., nxjerr afro 3,000,000 lira tyrku në mott, përveç ç'vidhen' e ç'hajen' e ç'humbasinë kot.

Ësht' e vërtetë që të shumat' e pagesavet janë të tepra, si pages' e bagëtivet etj., edhe duanë unjurë, që të lehcohenë bota. Pô kundrejt këtyre janë kaqë gjërëra që sot humbasinë, e venë kot, si pyjetë, metaletë e kaqë gjërëra të tjera që, pô të vështohenë si i duhetë, mundinë të sjellënë një begatí të madhe.

Me gjithë këto, e pô të vështohetë si duhetë, Shqipëria munt të ketë në mott shumë mê teprë t'ardhurë; pô le të na arrijnë 3,000,000 lira francishte, në të cilat s'ka ndryshim, do-me-thënë 60,000,000 franga.

Shqipëria, kur të jetë më vethe, duhetë me të parët të godínjë monella të çquara e të çkoqura. Një lirë e artë që të vinjë 20 copë (franga) edhe ç'do copë të ndahetë më 100 cinga (santime). Do të ket' edhe gjymësë e një të katrëtë të lirësë prej ari, si edhe dy e gjymësë e pesë lira, do-me-thënë 50 e 100 copë bashkë. Copëtë do të jenë prej ergjëndi. Do të ketë edhe dy e gjymësë e pesë copë bashkë, si edhe gjymësë e të katërtë të copësë, do-me-thënë 50 e 25 cinga të ergjëntta. Prej niqeli do të ketë monella 2½ edhe 5 edhe 10 edhe 20 cingash. Këto do të jenë gjithë monellat' e Shqipërisë; pô rëz' e themel' i tyre do të jetë lir' e artë; monellat' e ergjëntta e të niqelta do të jenë vetëm për të mbushurë sumat' e vogëla e aqë të paka

sa të mos mundinë të ndrojnë të vyerët' e lirësë pas pjacës' s'ergjëndit e të niqelit, si bëhetë sot në Tyrqí nga të qënëtë megjidet' e bardha me barë.

Një bankë kombërishte do ngrehurë që krejt në Shqipëri. Gjith' ata njerës që kanë të holla, e s'dinë ku e qysh t'i ruajnë, e humbasinë jo vetëm uzurënë pô shumë herë edhe krerëtë, do të lenë të hollat' e tyre pa frikë në këtë bankë të vërtetuarë e të zotuarë prej qeverisë. Edhe pagesatë që do të mbledhë qeverija nukë do t'i mbanjë nëpër arka, pô do t'ia apë në çast bankësë. Banka do të ketë në ç'do gastrë e në ca nënëgastra të trekta dega të sajtë. Kështu kjo bankë do të jetë gati nëpër të tërë Shqipërit, edhe njeri do të mos ketë nevojë të mbanjë të holla në gjit e në kuletet; banka do të jetë arkëtor i gjithë botësë. Kjo gjithë të hollatë që do të marrë nga bota e nga qeveria do t'i punonjë, e të sjellë begati e bukuri në mëmëdhet, edhe në vëndit t'atyre do të nxjerrë monellë të kartet (banknot), edhe këto do të përdorenë mê teprë në botet për të mos mbeturë ari e ergjëndi pa punuarë e pa uzurë.

Dy gjërëra i prishinë shumë herë njerëzit' e një qeverije: rog' e teprë q'u hap udhën' e prishjes' e së madhërisë, edhe rog' e pakë q'i bën të vjedhin' e të mos vështojnë punë. P'andaj në Shqipëri duhetë të mos ketë as rogë shumë të madhe as shumë të vogëlë.

Për shëmbëllë mundimë të shënojmë rogat' e nënëpunëset, e të shohëmë sa munt të bëhenë gjithë në muajt:

		nga	copë
	Krej i Pleqësisë	3000	3000
	Nënëkrej	2500	2500
13	Misetë	2000	26000
15	Shkronjës	300	4500
7	Ministrë	2000	14000
	Krye-ministri	2500	2500
8	Krye-shkronjës	1000	8000
8	Kamarë-shkronjës	2000	16000
3	Të parë të besëvet	2000	6000
3	Këshilla e shkronjësit' e tyre	2000	6000
15	Qeverindarë	1500	22500
15	Kryeshkronjës	750	11250
15	Qyrës begatije	750	11250
15	„ mësimi	750	11250
15	„ pun. të përgjithçime	750	11250
15	„ të gjyqit	750	11250
15	Suma-shkronjës	2000	30000
50	Nënëqeverindarë	750	37500
50	Shkronjës	300	15000
50	Nënëqyrës begatije	300	15000
50	Të tjerë shkronjës etj.	300	15000
50	Gjyqetore të para	1000	50000
15	„ të dyta	2000	30000
1	„ e lartë	5000	5000

		nga	copë
50	Shkolla të dyta	2500	125000
2000	„ të para	200	400000
20	„ të larta	5000	100000
		fr.	989750
	Të prura	-	989750
10	Akademia, shtypëtorja, yjvështonja, muzeja, bibliotheka etj.	5000	50000
20000	Ushtarë njerí mi tjatrinë	40	800000
	Kadr' e ushtëris' së luftësë e zhandarmetë		500000
	Udhëtë e të tjera punëra të përgjithçime		500000
	Aniat' e luftësë		500000
	Të dërguarë në vënde të huaj		25000
	Njera e tjatera		75000
	Në muajt		3439750
	Të cilat bëjnë në mot		41277000
100	Mise të këshillës' së përgjithçime nga 1000 c. (2 m.)		200000
	Krye, nënëkrye e shkronjës		10000
	Në mott	-	41487000

Kështu gjithë të prishuratë nukë bëhenë shumë mê teprë se 2 miliunë lira, edhe tepërojnë afro një miliun lira, të cilatë do të prishenë për të bërë udhëra të hekurta, udhëra qerreje, limane e të tjera punëra të përgjithçime, si edhe anie e vapore për luft' e për tregërí. Këto gjërëra duke shpënë gjithënjë sa mbar' e mê mbarë, do të shtojnë mot me mot mê teprë t'ardhurat' e Shqipërisë, aqë sa munt të vinjë një ditë

që të qeverisetë vëndi vetëm me pagesat' e kumerqevet e të tregërivet; edhe të shpëtojnë fshatarët' e varfërë nga pagesatë q'apënë për vetëhe, për bagëtit, për dhet e për shtëpit të tyre, pagesa që po u thyejnë mezë e s'i lenë të marrënë frymë. Atëhere Shqipëtarëtë, si Amerikanëtë sot, do të rojnë si në parajsë.

Monell' e Shqipërisë më njërët faqe do të ketë një Shqipe të qëndruarë më këmbë me krahë gjymësë-hapurë e me një yll (Hyjnë) mi ballët, shënjën' e Shqipërisë, do-me-thënë, edhe rotullë emënin' e Shqipërisë e nënë këmbët të shqipesë mone q'është shtypurë. Në faqet tjatrë do të ketë në mest të një redhi prej degash numurinë edhe nënë të emënin e copevet a të cingavet.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Katundëritë

M'i lumtur' i vëndevet në botet ësht' ay, tek ndjehetë fort pakë dor' e qeverisë. Sa të mundetë qeverija të mos ketë të bënjë drejt për drejt me vëndeset. Për këtë punë duhetë të jenë katundëritë të goditura bukurë, e vëndesitë të mos njohenë përveç këtyre, edhe këto të njohenë qeverinë, e të kenë të bëjnë me të. Pagesatë do t'i mbledhë katundërija, e t'ia apë qeverisë; gjyqet' e vegjëlë në mest të botësë do t'i vështonjë katundërija; udhët' e vogëla nëpër mest të pshatëravet, rugat' e qytetevet do t'i ndërtonjë katundërija; shkollat' e para, tregjetë e të tjera punëra të qytetevet e të pshatravet, si edhe pyjet' e kopshtat' e përgjithçim e arat' e vreshtatë do të jenë nënë qyrërit të katundërisë.

Ç'do qytet i vogëlë do të quhetë një katundëri (beledije), të mbëdhenjtë do të ndahenë më dy a më teprë katundëri. Nga katundet e pshatërat disa që janë afrë njëri jatrit e bëjnë gjithë bashkë një pellk a rreth do të zihenë një katundëri. Kështu ç'do nënëgastrë do të jet' e ndarë më disa katundëri.

Ç'do katundëri do të ketë mbledhjen' e përgjithçime të saj, në të cilët do të pshillenë gjithë burratë që kanë shkuarë të 20 vjettë e që kanë të pakënë një shtëpi e një arë a vreshtë a kopshtë a tjatrë gjë që paguan, të pakënë 5 copë (franga) në mott qeverisë a që di të shkruanj' e të këndonjë. Kjo mbledhje e përgjithçime një herë në mott do të xgjedhë një katundar [nahije mydiri a beledije reisí], një nënëkatundar a ndihmës katundari, tre mise të këshillës' së katundërisë, një krye, një nënëkrye edhe tre mise të gjyqëris' së paqesë (juges de paix). Emërat' e këtyre do t'i shkruhenë nënëqeverindarit, i cili atë çast do t'i dërgonjë në qeverindari, edhe ay do t'i vërtetonjë, e t'i kthenjë. Ruanjësit' e udhëvet e të pyjevet, copë mbledhësitë (tahsildarëtë), xandarëri' e katundërisë etj. do të jenë nënë urdhërit të katundarít. Dhënjet' e vëndeset do të mblidhenë prej katundërisë me anët të copëmbledhësit edhe me ndihmit të xandarërisë, kur të jetë nevojë, edhe do të dërgohenë gati në nënëqeverit. Gjithë gjyqet' e vogëla ndo për dhënje e marje ndo për faje do të vështohenë në gjykatet të paqes' së katundërisë e cila do të muntnjë të vështonjë edhe gjyqe mê të mbëdhenj, pô që të duanë të dy anëtë.

Kështu gjithë punët' e vëndit do të vështohenë prej katundërisë, edhe vëndesitë do të mos njohinë tjatrë qeveri përveç katundërisë q'është e xgjedhurë prej atyre vetë. Qeverija do të mos përzjehetë përveç se në punërat të mbëdha e të përgjithçime, në punëra, të cilatë katundërija,

me të mos mundurë t'i godinjë vetë, do t'ja dërgonjë nënëqeverisë.

Katundërija do të ketë dhënjet' e saj që do të mbledhë ndo nga shtëpit' e arat' e vreshtat' e pyjet etj., ndo nga treqet' e nga të shiturat' e të bleratë etj. Këto dhënje janë jashtë byxesë, edhe me këto do të kthehetë katundërija, të paguhenë ruanjësitë etj.

III / Ç'do të bëhetë Shqipëria?

Përmbledhje

Nga gjithë sa thamë merretë vesh fort mirë se qysh munt të qeverisetë Shqipëria e se sa vënt i bukurë do të bëhësh me një qeverí të këtillë! Sa do të vinte mbroth e të prokopsetë! Në pakë kohë do të bëhësh një nga mê të bukuritë vënde t'Evropësë e të gjithë dheut. Me këtë mëndyrë kombi shqipëtar në pakë kohë do të bëhësh një nga mê të xgjuarët' e nga mê të qytetuarëtë kombe të dheut, e Shqipëtarëtë, që kanë kaqë qínt vjet që po rojnë në robëri, në varfëri e në shtrëngim të math, do të bëhëshinë gjithë të pasur' e të lumturë e të roninë si njerës!

Ç'duhetë për të shpëtuarë ky i gjorë komp e ky i varfërë vënt nga kjo zi e madhe q'e ka mbuluarë, e nga gjithë këta rezike q'e kanë rethuarë, e për të luluzuarë ashtu si thamë? Fort pakë gjë: Vetëm dëshirë! Arrin të duamë; pô që të duamë, e kemi në dorë ta bëjmë Shqipërinë si thamë e ta shpëtojmë nga gjithë reziket' e nga gjithë myxyratë. Kur është në dorët tënë, të na Shqipëtarëvet, ta shpëtojmë a ta humbasimë

Shqipërinë, atëhere të mendohemi sa faj i math është të rrim' e të mos bëjmë gjë! Kjo është të vrarë mëmëdhenë tënë me dorë tënë. Kur e kemi në dorë ta shpëtojmë, e të mos ta shpëtojmë, do-me-thënë që e vrasimë me dorë tënë!

Pô ç'të bëjmë? - Ja se ç'duhetë të bëjmë:

Duhetë që ç'do Shqipëtar të ketë gjithënjë, nat' e ditë, ndër mënt e në zëmrë shpëtimn' e Shqipërisë e mbrodhësin' e kombit Shqipëtar. Kjo me se bëhetë? - Ç'do Shqipëtar që do këtë duhetë të dojë bashkimn' e Shqipëtarëvet; gjithë Shqipëtarëtë janë vëllezrë, kanë një gjak në rëmbat të tyre; s'ka turk e kaur, pô janë gjíthë Shqipëtarë! Ay q'është Shqipëtar i vërtetë duhetë t'i vështonjë si vëllezrë e t'í dojë nga zëmra Shqipëtarët' e vërtetë, pa le të mos jenë në besët të ti. Shqipëtari ka qënë Shqipëtar përpara se të bëhetë i kríshterë a mysliman.

P'andaj Shqipëtar' í vërtet' e i mírë edhe ay që do shpëtimn' e Shqipërisë vë gjithënjë e kurdo kombërinë përpara besësë; nukë ka vëllezrë ata që ka në besët të tî, pô ata që ka në kombërít të tî. Shqipëtarët' e vërtetë janë veçan vëllezrë në mest të tyre; vëllazëri e këtyre duhetë të jetë aq' e shtrënguarë sa gjë të mos ta ndanj' e ta çanjë dot, e gjë të mos hynjë dot në mest të tyre. Qysh janë Frankmasonët' e Bektashitë vëllezrë në mest të tyre, kështu duhetë të jenë edhe Shqipëtarët' e vërtetë.

Shqipëtar është ç'do njeri i pjellë prej Shqipëtarësh e që flet shqip, pô Shqipëtar i vërtetë ësht' ay që ka mëndjen' e zëmrënë shqipëtar. Këta Shqipëtarët' e vërtetë janë me të vërtet' e fjeshtë Shqipëtarë. Duanë gjuhën' e kombin' e tyre, edhe përpiqenë për mbrodhësit të mëmëdheut. Kur të

bëhenë gjithë Shqipëtarëtë a mê të shumët' e tyre kështu Shqipëtarë të vërtetë, Shqipëria atëhere ësht' e bërë e e shpëtuarë nga ç'do rezík. P'andaj ç'do Shqipëtar duhetë të parënë të jetë vetë a të bëhetë Shqipëtar i vërtetë, e pastaj të përpiqetë të bënjë edhe të tjerë shokë, që ca nga ca e njerí pas tjatërit të bëhenë të gjithë Shqipëtarë të vërtetë.

Sot shumë Shqipëtarë, nëntëdhetë për qint, munt të themi, s'janë Shqipëtarë as me mënt as me zëmrë; kombín' e tyre e gjuhënë s'e duanë as e nderojnë; s'duanë të këndojn' e të shkruajnë në gjuhët të tyre, edhe shumë kanë turp edhe të flasinë shqip! Pô në kan' ata turp të thonë që Shqipëria është mëma jonë, Shqipëria ka mê shumë turp e dhuní të duketë që ka të tíllë bij! Kombi Shqipëtar s'është komp për të pasurë turp prej ti; të qënët' e një njeriu nga një komp kaqë trím e kaq' i xgjuarë s'është turp, pô është nder i math. Në ka mbeturë pas kombi ynë, s'është faj' i tí, pô është faji ynë; në ka mbeturë gjuha shqip e pashkruarë, s'ka mbeturë se është gjuh' e ligë a e metë, pô vetëm se s'jemi kujdesurë na ta shkruajmë. S'na ka faj kombi, s'na ka faj gjuha, faji ësht' yni. Jemi m'i vjetri komp í Evropësë edhe m'i fisçimi e mê trimi; flasimë mê të vjetrënë e mê të mirënë gjuhë të farësë arjane.

Ata Shqipëtarë që s'dinë të çimojnë kombin' e gjuhën' e tyre, e s'i pëlqejnë, e s'kanë turp të duanë të quhenë Tyrq, Greq, Shqeh a të tjerë, ata janë tradhëtorë të çmëndur' e të paditurë. Qënj' e tyre është një turp i math për Shqipërín' e për kombinë Shqipëtar. Sa i math turp kur një Shqipëtar, në rëmbat të cílít leçin gjaku i Skënderbeut e i shokëvet të ti, të poshtonjë kombin' e ti e gjuhën' e mëmës' së ti, e të nderonjë një gjuhë të huaj, të cilënë përpiqetë ta vëndosnj' e ta përndanjë në vëndit t'asaj! Përpiqetë që djemt' e ti e nipritʼ e

stërnipritë të mos dinë shqip, e të mos quhenë Shqipëtarë! I math turp për Shqipërinë të ketë pjellë të këtillë djem! I math turp qënja e rojtj' e të këtillë njerësve mi faqe të dheut! Kush munt të jetë m'i lík e m'i pështirë se ay që s'do e s'nderon mëmën' e ti, pô e heth më një çiçip, e i vjen turp të thotë q'ësht' i bir' i saj?

Turp' i të këtillëve njerës është turp për mëmëdhenë tënë! Përveç dheut tënë nonjë vënt në botet s'ep të këtillë pemë të hidhurë! Kaqë të pasurë Shqipëtarë kanë prishurë gjithë gjën' e tyre për mbrodhësit të një kombërije q'është armiku i kombëris' së tyre; për të bërë djemt' e tyre e të të vëllezrëvet të harojnë shqipenë e të mos quhenë Shqipëtarë! Këta s'janë armikë, s'ka fjalë për të quajturë këta tradhëtorë të liq e të fëlliqurë! S'ka Shqipëtarë, thonë, Shqipëtarëtë s'janë komp më vetëhe, janë Greq thonë ca, Tyrq thonë të tjerëtë, Shqeh, thonë ca të tjerë. O! sa fjal' e rëndë për gojët të një Shqipëtari! O qysh ua nxë goja këtë fjalë faqe-zesvet!

Të këtillë njerës duhetë të mos jenë në Shqipëri, as mi faqet të dheut; dheut i rëndojnë teprë këta tradhëtorë; s'i mban dot; të çporenë! Ç'do Shqipëtar i vërtetë duhetë të përkujdesetë që të mos mbesë as një i këtillë Shqipëtar, se i sjellinë dëm e turp të math gjithë Shqipërisë e shqipëtarërisë. Ç'do Shqipëtar duhetë të parënë të bëhetë vetë Shqipëtar i vërtetë, pastaj të bënjë të tjerëtë, sa të muntnjë mê teprë. Të kujdesetë që të vejë mbarë e të përhapetë gjuha shqip, do-me-thënë të shkruarët' e të kënduarët' e gjuhës' sanë, e të shtohetë mësimi e diturija në gjuhët tënë. Me një fjalë, të përpiqetë që të jet' edhe kombi ynë një nga kombet' e qytetuarë e të ndrituarë. Pô të përpiqemi gjithë për këtë punë, kombi ynë, me të qënë në naturët i xgjuar' e trim, në

pakë kohë do të bëhetë një nga mê të ndrituarët' e nga mê të qytetuarëtë kombe t'Evropësë.

Një komp i vjetërë, m'i vjetër' i kombevet t'Evropësë, Pelasgët' e qëmoçim të mbajtur' e të qëndruarë që nga kaqë mijë vjet e tëhu sikundr' ishinë, një komp kaq' i vjet[ërë] e me gjithë këtë fort i ri që tani po zë të luluzonjë për së parë herë, një komp trim e i zoti me një kokë e me një ballë që s'i ka edhe tjatërë, me një gjuhë të gjer' e të plottë, të bukur' e të lehtë, q'e mëson që me sisë të s'ëmësë, një kombi të këtillë kush munt t'i dalë kundrejt, e kush munt t'i shkonjë përpara?

O burrani ô Shqipëtarë! se në dashçim' e në u përpjekçimë, do të jemi një nga mê të mirët' e nga mê të ndrituarët' e kombevet t'Evropësë, që të na kenë nakar gjithë bota. O burrani! të mos na mbulonjë gjum' i mefshtërisë e i paditurisë, se në ndënjçimë kështu, jemi të humburë. O! sa dëm i math e sa turp i rëndë të humbasë sot, në këtë kohë që edhe më të dobëtit' e kombevet po xgjuhen' e po luluzojnë, një komp si Shqipëtarëtë q'është mbajturë që kaqë mijë vjet e tëhu në kaqë kohëra t'egëra! Një komp kaq' i mënçim e me një gjuhë kaqë të bukurë të humbasë nga padija e nga të mos pasurë gjuhë të shkruarë! Një komp kaqë trim e që s'e kurcen gjaknë fare të humbasë duke copëtuarë prej kombeve të dobët' e të frikçimë! Mënt kemi, trimërí kemi, gjuhë të bukur' e të lehtë kemi, e të mos dimë a të mos duamë t'i përdorimë gjithë këto për të mirën' tënë, pô të rrimë me duar lidhurë a, ajo q'është m'e keqe, të punojmë për humbjet tënë, të nxjerrimë themelet' e kombit tënë me paditurit e me verbërit të vet!

A jemi Shqipëtarë? Besa, feja, puna, kujdesa, dëshira jonë, mendimi ynë të jenë për Shqipërinë e për shqipëtarërinë. Të shpjemë gjuhënë përpara, ta xgjerojm' e ta xbukurojmë me shkronja e me dituri; të hapimë shkolla, të mësojmë, të mos mbesë nonjë Shqipëtar i paditur' e që të mos dijë të këndonj' e të shkruanjë; të ngremë shkollat' e huaja nga Shqipëria e ta mbushimë mëmdhenë tënë me shkolla shqip; djemtë tanë në pakë kohë të mësojnë të këndojn' e të shkruajnë gjuhën' e tyre edhe dituritë q'u duhenë; me të qënë që gjuhënë e dinë vetiu, e mundinë ta mësojnë në pakë kohë, do të kenë voli të mësojnë mjaft dituri; edhe bariu edhe bujku edhe mjeshtr' i murevet do të mos jenë pa dituri.

Këto punëra janë nga të drejtatë tona; kush të mos na lerë të punojmë në këtë udhë të së drejtësë e të mirësisë, na ka rëmbyerë të drejtënë nga dora jonë; ësht' e drejta jonë të përpiqemi me fjalë, me punë, me gojë, me dorë, me pendë, me armë, që të çkëputimë të drejtënë tënë nga thonjt' e atyre që na e kanë rëmbyerë. Nukë duamë të rëmbejmë gjën' e tjatrit, pô s'duamë të lemë edhe gjënë tënë e të drejtën' e sheshit të na i rëmbejnë me pahir. Të përpiqemi për të drejtët tënë, për gjuhët tënë, për kombërit tënë, për të mirët të kombit tënë; kush të na qëndronjë përpara, e të na ndalonjë në këtë udhë të shënjtuarë, ta shtyjmë, ta rëzojmë, ta shkelim' e të shkojmë tutje! Të nxjerrimë zënë, të thëresimë, të na dëgjonjë bot' e qytetuarë, të na ndihin' edhe ata në të drejtët të bekuarë që duamë të mburojmë. Të mos trëmbemi nga gjëkafshë, të përpiqemi e të mos pushojmë gjer sa të fitojmë atë që kërkojmë, jemi në të drejtët, Perëndija është gjithënjë ndihmës' i të drejtëvet, Perëndija ësht' e drejta vetë!

O vëllezrë Shqipëtarë! Të mos na gjenjë si ata t'egërtit' e Avstralis' e t'Afrikësë, që ven' Evropjanët' e i gënjejnë me ca ruaza e me ca dragole të qelterta a pasqyra të pafillta, e u marrinë vëndet' e tyre nga dora. Të mos gënjehemi edhe na ashtu me ca copa pafillesh e qelqesh që s'vlejnë gjë fare, e të lemë të drejtat' e kombit e të mëmëdheut tënë në duar të të huajet e t'armikëvet tanë. Të thyejmë xgjedhënë [që] po na rëndon mi xverkut që kaqë qint vjet e tëh[u], të këputimë hekuratë që po na shtrëngojnë këmb[ëtë], të hedhimë së sipërmi hijen' e rëndë që po na shk[el] e na shtyp e s'na le të marrënë frymë! Të mos [rrimë] të mpit' e të ngrirë, të lëvizimë duar e këmbë, të tundemi e të lëkundemi, t'ecimë dlirë n'udhët të Perëndisë, n'udhët të së drejtësë:

PERËNDIJA, E DREJTA, KOMBI, GJUHA! SHQIPËRIA, SHQIPËTARËRIA!

Ja qëllimi ynë! Ja puna jon' e shënjtuarë! Ja besa jonë! Gjith' ata që kanë këtë qëllim janë vëllezëritë tanë! Në mest të Shqipëtarëvet të vërtetë s'ka nonjë ndarje, nonjë çarje, nonjë ndryshim! Janë të tërë vëllezrë, të gjithë një trup, një mëndje, një qëllím, një besë!

FUNT

Shënime për tekstin dhe burimet

Ky botim përmban të 36 nënkapitujt e transkriptimit të Fletoreve, të përditësuar më 25 shtator 2026. Teksti i autorit është dhënë i plotë sipas këtij burimi, me drejtshkrimin e tij historik. Është botim i ri leximi, jo skanim i botimit të parë dhe jo botim kritik. Nuk është krahasuar fjalë për fjalë me një kopje të plotë të shtypit të vitit 1899.

E1

Të gjitha pohimet historike, gjuhësore, racore, fetare dhe politike i përkasin autorit dhe kohës së tij. Riprodhimi i tyre nuk i vërteton ato dhe nuk përkrah gjuhën armiqësore të tekstit.

E2

Nuk përfshihen eseja e mëvonshme e Shaban Demirajt, fjalorthi dhe aparati redaktorial i botimit ALBANIANA 2015.

E3

Në PDF-në krahasuese të vitit 2015 mungon një pjesë teksti brenda faqes 79. Transkriptimi i Fletoreve përmban vazhdimin e III.4, nënkapitujt III.5-III.13 dhe fillimin e III.14. Nuk është përdorur përkthim i anasjelltë nga anglishtja e Robert Elsie-t ose nga gjermanishtja e vitit 1913.

E4

Teksti i III.11 thotë se do të ketë shtatë ministra, por rendit tetë fusha ministrish. Kjo mospërputhje është ruajtur si në burimin e zgjedhur, pa e ndryshuar numrin në heshtje.

E5

Burimi i zgjedhur jep shumën mujore të buxhetit 3 439 750, në përputhje me shumën vjetore 41 277 000 para shpenzimeve të kuvendit. PDF-ja krahasuese e vitit 2015, f.87, jep 8 439 750. Këtu ruhet leximi i Fletoreve; nuk pretendohet se është verifikuar në shtypin e vitit 1899.

E6

Shkronjat dhe fjalët brenda kllapave katrore, sidomos në III.18, gjenden që në transkriptimin e Fletoreve. Janë ruajtur pa ndryshim; kopja e shtypur dhe arsyetimi i këtyre plotësimeve nuk janë përcaktuar në burim.

E7

Në II.7 (2.07.005), pjesa që fillon me fjalët «edhe që me të lënë këtë gjuhë» nuk ka një pohim kryesor të përfunduar në transkriptimin e zgjedhur. I njëjti ndërtim i papërfunduar gjendet në faqen 54 të PDF-së krahasuese të vitit 2015. Nuk është shtuar ndonjë përfundim i hamendësuar; kjo pjesë kërkon krahasim me një dëshmi të hershme të shtypur.

E8

Në III.7 (3.07.001), transkriptimi i zgjedhur ka fjalën e paqartë «qepe» në listën që shoqëron një sundimtar mysliman të huaj. Fjala është ruajtur pa u zëvendësuar në heshtje. Një citim studimor i vitit 2025 jep «qerre», por ky krahasim nuk përcakton leximin e shtypit të vitit 1899. Fjala kërkon shqyrtim tekstologjik nga një specialist.

Burimi dhe përdorimi

Vepra e Sami Frashërit u botua për herë të parë në Bukuresht më 1899 dhe është në domenin publik. Transkriptimi shqip: Fletoret, versioni i 25 shtatorit 2026, CC BY 4.0. Ky botim ndryshon faqosjen, normalizon hapësirat dhe shton numra identifikimi për nënkapitujt e paragrafët. Burimi nuk përcakton saktësisht botimin e shtypur nga i cili është transkriptuar. Numrat e faqeve të këtij PDF-je janë të rinj dhe nuk janë numrat e botimit të vitit 1899.

Sami Frashëri, Shqipëria (1899). Albanian transcription: Fletoret, EPUB updated 25 September 2026, CC BY 4.0, https://fletoret.com/sami-frasheri/shqiperia/.

https://fletoret.com/sami-frasheri/shqiperia/

Creative Commons Attribution 4.0: https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/

Ilustrimet dhe burimet e tyre

P01 · Sami Frashëri në zyrën e tij, 1896

Unknown photographer; via TDV İslâm Ansiklopedisi / Wikimedia Commons. Public domain as marked by Commons (PD-old; original photograph dated 1896).

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Sami_Frash%C3%ABri_%281896%29.jpg

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

The photographer is unidentified. The date and identification follow the source record; this is a historical photograph, not a later painted portrait.

P02 · Mbishkrime të Dodonës, botimi i Carapanos-it, 1878

Constantin Carapanos; drawings by Alexis Housselin; University Library Heidelberg scan. Public-domain mechanical scan (PD-old-expired / PD-scan).

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Carapanos%2C_Dodone_et_ses_ruines_%281878%29%2C_pl._35.png

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

These are nineteenth-century drawings of ancient inscriptions, not surviving writing in an identified Pelasgian language. Do not assign one date to every object on this plate.

P03 · Përkrenare bronzi e tipit ilir

The Metropolitan Museum of Art, Gift of Martin E. Segal, 2006, accession 2006.221. CC0 1.0 Universal; museum Open Access image.

https://www.metmuseum.org/art/collection/search/257808

https://creativecommons.org/publicdomain/zero/1.0/

Do not turn the archaeological label “Illyrian type” into evidence that a named Illyrian or Albanian wore this particular helmet.

P04 · Faqe nga botimi i Attaleiatit, 1853

Michael Attaleiates; edition by Immanuel Bekker (Bonn: Weber, 1853); University of California / Google / Internet Archive digitization. Public-domain nineteenth-century edition of medieval text and mechanical scan.

https://archive.org/details/michaelisattali00bekkgoog/page/n314/mode/1up

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

The passage attests a medieval group name in a specific military context. It does not prove an unbroken ancient ethnic genealogy. The event date, author’s composition period and printed edition date are different.

P05 · Faqja e titullit të veprës së Barletit, rreth 1508

Marin Barleti; printer Bernardino dei Vitali; University of Illinois Urbana-Champaign / Internet Archive scan. Public-domain early-sixteenth-century print and mechanical scan.

https://archive.org/details/historiadeuitaet00barl/page/n2/mode/1up

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

“Epirotarum” documents early-sixteenth-century terminology; it does not establish an unbroken ancient ethnic genealogy.

P06 · Portret i Skënderbeut në veprën e Barletit

Anonymous woodcut illustrator in Marin Barleti’s book; University of Illinois / Internet Archive Book Images. Public-domain early-sixteenth-century illustration and mechanical scan.

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Historia_de_uita_et_gestis_Scanderbegi_Epirotarum_principis_%281508%29_%2814559502798%29.jpg

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

Do not label “Skanderbeg, 1460” or imply a verified lifetime likeness.

P07 · Faqe e Mesharit të Gjon Buzukut, 1555

Gjon Buzuku, 1555; scan by Dori from Historia e Popullit Shqiptar, vol. I (2000), p. 696. Public-domain mechanical scan of 1555 printed page (PD-old-100-expired / PD-scan).

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Buzuku_meshari.jpg

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

The page’s contents are not quoted here; its exact folio has not been independently established. Do not label it the book’s original cover. Small image: use at modest display size with a zoom option.

P08 · Faqja e titullit të katekizmit të Matrëngës, 1592

Lekë (Luca) Matranga; Rome: Guglielmo Facciotto, 1592; National Library of Albania digitization via Commons. Public-domain 1592 print and mechanical scan; preserve library watermark.

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Embsuame_e_Chr%C3%A6ster%C3%A6_%281592%29.djvu

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

An early-modern diaspora book, not a medieval manuscript. The image is a watermarked library facsimile; no watermark has been removed.

P09 · Fotografi grupi e lidhur me Lidhjen e Prizrenit

Attributed to Pietro (Pjetër) Marubi (1834-1903); identification via the Commons source record. Public domain as marked by Commons (PD-Albania; photographer died 1903).

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:The_delegation_of_Sanjak_of_Shkodra_in_the_League_of_Prizren.jpg

https://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

Use the qualified wording. Do not identify every sitter or assert that this shows the League’s founding meeting in Prizren. The caption reflects the cited record, not an archive catalogue number verified here.

Referenca e paragrafëve

Çdo shenjë identifikon të njëjtin bllok të burimit në botimet shoqëruese. Numri përballë është faqja ku fillon ai bllok në këtë PDF. Referencat mund të klikohen.

1.01.001	5	1.07.003	21	2.04.003	37	2.09.006	52
1.01.002	6	1.07.004	21	2.04.004	37	2.09.007	53
1.01.003	7	1.07.005	21	2.05.001	37	2.09.008	53
1.01.004	7	1.07.006	22	2.05.002	37	2.10.001	54
1.01.005	8	1.07.007	22	2.05.003	38	2.10.002	54
1.01.006	8	1.07.008	23	2.05.004	38	2.10.003	54
1.02.001	9	1.08.001	24	2.05.005	39	2.10.004	55
1.02.002	10	1.08.002	24	2.05.006	39	2.10.005	55
1.02.003	10	1.08.003	25	2.05.007	39	2.10.006	55
1.03.001	10	1.08.004	25	2.06.001	40	3.01.001	56
1.03.002	11	1.08.005	25	2.06.002	41	3.01.002	56
1.03.003	11	1.08.006	26	2.06.003	41	3.01.003	57
1.03.004	12	1.08.007	26	2.06.004	42	3.01.004	57
1.03.005	12	1.08.008	27	2.07.001	42	3.01.005	58
1.03.006	12	1.08.009	27	2.07.002	43	3.01.006	58
1.04.001	13	1.08.010	27	2.07.003	43	3.01.007	59
1.04.002	14	2.01.001	28	2.07.004	44	3.02.001	59
1.04.003	14	2.01.002	28	2.07.005	45	3.02.002	59
1.05.001	15	2.01.003	28	2.07.006	45	3.02.003	59
1.05.002	15	2.01.004	29	2.07.007	45	3.02.004	60
1.05.003	16	2.02.001	30	2.07.008	46	3.02.005	60
1.05.004	16	2.02.002	31	2.07.009	46	3.02.006	61
1.05.005	16	2.02.003	31	2.08.001	47	3.02.007	62
1.06.001	17	2.03.001	32	2.08.002	48	3.03.001	62
1.06.002	17	2.03.002	32	2.08.003	48	3.03.002	62
1.06.003	18	2.03.003	33	2.08.004	49	3.03.003	63
1.06.004	18	2.03.004	33	2.08.005	49	3.03.004	63
1.06.005	19	2.03.005	33	2.08.006	50	3.04.001	64
1.06.006	19	2.03.006	34	2.09.001	50	3.04.002	65
1.06.007	19	2.03.007	34	2.09.002	50	3.04.003	65
1.06.008	19	2.03.008	35	2.09.003	50	3.04.004	65
1.07.001	20	2.04.001	35	2.09.004	51	3.04.005	66
1.07.002	21	2.04.002	36	2.09.005	52	3.04.006	66

Referenca e paragrafëve vijim

3.05.001 67
3.05.002 67
3.05.003 67
3.05.004 67
3.05.005 68
3.06.001 68
3.06.002 68
3.06.003 68
3.06.004 68
3.06.005 69
3.06.006 69
3.06.007 70
3.06.008 70
3.06.009 71
3.07.001 71
3.07.002 71
3.07.003 72
3.08.001 73
3.08.002 73
3.09.001 74
3.09.002 74
3.09.003 75
3.09.004 75
3.09.005 75
3.09.006 75
3.09.007 76
3.10.001 77
3.10.002 77
3.10.003 77
3.11.001 78
3.11.002 78
3.11.003 78
3.12.001 79
3.12.002 79
3.12.003 79
3.12.004 80
3.12.005 80
3.13.001 81
3.13.002 81
3.13.003 81
3.13.004 82
3.13.005 82
3.13.006 83
3.14.001 83
3.14.002 83
3.14.003 84
3.14.004 84
3.14.005 85
3.14.006 85
3.14.007 85
3.14.008 85
3.15.001 87
3.15.002 87
3.15.003 88
3.15.004 88
3.15.005 88
3.16.001 89
3.16.002 89
3.16.003 89
3.16.004 89
3.16.005 90
3.16.006 90
3.16.007 90
3.16.008 91
3.16.009 92
3.16.010 93
3.17.001 93
3.17.002 94
3.17.003 94
3.17.004 94
3.17.005 95
3.18.001 95
3.18.002 95
3.18.003 96
3.18.004 96
3.18.005 96
3.18.006 96
3.18.007 97
3.18.008 97
3.18.009 98
3.18.010 98
3.18.011 99
3.18.012 99
3.18.013 100
3.18.014 100
3.18.015 101
3.18.016 101
3.18.017 101
3.18.018 101